



RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR PËR
PROJEKTIN “KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE”
NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI PËRPUTHSHMËRINË
E PROJEKTIT
“KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE”
NË
FONDIN SHQIPËTAR TË ZHVILLIMIT

Tiranë, 2021

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.	9
II. HYRJA	11
1. Objekti i auditimit.....	11
2. Qëllimi i auditimit	11
3. Identifikimi i çështjes:	11
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:	11
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	12
6. Kriteret e vlerësimit	12
7. Standardet e auditimit.....	13
8. Metodatat e auditimit.....	13
9. Dokumentimi i auditimit	13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM	14
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	17
2.1 Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit dhe raportimi i tyre.....	17
2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësin.	20
2.3 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimin e fondeve publike.....	28
2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.	54
2.5 Mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile.....	58
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	68
V. ANEKSE	74

Tiranë, më __.10.2021

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, zyrën e PMU, Projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 254/1, datë 25.02.2021, me afat auditimi nga data 01.03.2021 deri me datë 30.04.2021, për periudhën nga fillimi i Projektit deri më 31.12.2020. Konkretisht u audituan marrëveshjet financiare dhe ndryshimet e tyre, shkalla e arritjes së objektivave dhe komponentëve të Programit, menaxhimi financiar i Projektit, shkalla e realizimit të disbursimeve financiare kundrejt atyre të programuara dhe raportimi i tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe zbatimi i kontratave në drejtim të realizimit të punimeve. Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 9 akte të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 30.04.2021. Me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 254/3, datë 10.05.2021, nga subjekti janë paraqitur observacionet e akteve të mbajtura. Me shkesën nr. 254/4 datë 08.04.2021 është dërguar Projektraporti i Auditimit dhe me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 254/5 prot. datë 09.09.2021 subjekti i auditimit ka paraqitur observacione për Projektraportin, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjor, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për marrjen e masave në përmirësimin e punës. Për sa i takon Takimit Përmbyllës midis niveleve drejtuese të KLSH-së, grupit të auditimit dhe subjektit të audituar, pas njoftimit me e-mailin e datës 13.09.2021 është njoftuar zyra e Auditit i Brendshëm, dhe në vijim ky takim u zhvillua me datë 16.09.2021.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Në Marrëveshjen e Huas nr.8850-AI datë 05.06.2018, me vlerë 50 mil US\$, ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Qeverisë Shqiptare, në Skedulin 2 të saj, është përcaktuar se Personeli i Dedikuar për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” (RLRCP) përbën një organizim institucional në FSHZH. Në Manualin Operacional, datë 30.08.2018, pika 1, shkronja (d) FSHZH, është përcaktuar se në përbërje të Personelit të Dedikuar duhet të jenë përfshirë një Projekt Menaxher Inxhinier, një Specialist Menaxhimi Financiar, një Specialist Prokurimesh, një Specialist Mjedisi, një Specialist Social dhe inxhinierë të fushës. Përveç kësaj, FSHZH mund të punësojë konsulentë ose mbështesë me staf, të cilët do të punojnë sipas mënyrës on-call basis, në varësi nga nevojat specifike të aktiviteteve. Në Vendimin nr.186, datë 25.07.2019 të Këshillit Drejtues është vendosur për disa ndryshime në strukturën organizative dhe manualin e procedurave administrative të FSHZH, kapitulli “Njësitë e Menaxhimit të Projekt Programeve” shkronja (d) pika 78	Faqe 19-22	E LARTË	Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për identifikimin dhe emërimin e personelit të dedikuar projektit “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”, me qëllim koordinimin e aktiviteteve në përbërje të tij..

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	është vendosur se: “Në varësi të llojit, fazës dhe volumit të projekt/programeve, që përfshihen në një njësi menaxhimi, Drejtori Ekzekutiv mund të vendosë edhe përcaktimin e një menaxheri që do të ndjekë në mënyrë specifike një prej projekt/programeve që përfshihen brenda një njësie. Nga auditimi rezulton se është shpërndarë personeli, i cili rezulton të jetë përgjegjës për disa projekte të ndryshme, gjithashtu është shpërndarë edhe përgjegjësia që duhet të ketë Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, i cili në zbatim të Manualit Operacional (aneks 2) të projektit duhet të ketë në varësi direkt Njësitë e Menaxhimit të Projekt/Programeve si dhe nuk rezultojnë akte emërimi ose urdhra specifikisht për menaxhimin e projektit “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) P163239. Për sa më sipër është në kundërshtim me Marrëveshjen e Huas, Skeduli 2, Seksionin I A, pika 1, nr.8850 datë 05.06.2018, si edhe Manuali Operacional, pika 1, shkronja (e) dhe Aneksi 2 i saj.			
2.	Referuar niveleve të parashikuara sipas viteve në Marrëveshjet e Financimit dhe Manualin Operacional të nivelit të realizimit të objektivave të projektit dhe nivelet konkrete aktuale të arritura për çdo vit deri në përfundimin e periudhës objekt auditimi Dhjetor 2020 rezulton se objektivat që lidhen me komponentin e parë të projektit që është përmirësimi i aksesueshmërisë dhe me indikatorët e progresit fizik të tij si, kilometra rrugë të rehabilituara, numrin e qendrave të banuara të lidhura nëpërmjet rrugëve të rehabilituara apo koha e reduktuar e udhëtimit në rrugët e projektit, pavarësisht se kanë një përqindje realizimi ato nuk janë arritur sipas përcaktimeve fillestare. Objektivat që lidhen me komponentin e dytë dhe të tretë të projektit pra indikatorët e ndërmjetëm që kanë të bëjnë me kapacitete bashkiake të përmirësuara për menaxhimin e aseteve rrugore, apo mbështetje për menaxhimin e zbatimit me trajnime, përmirësime dhe politika, rezultojnë ende të pa realizuara.	Faqe 22-31	E LARTË	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të projektit, të marrë masa që kontraktori të rrisë kapacitetet në mënyrë që të arrihet realizimi i objektivave dhe përfundimi në kohë i projektit. Gjithashtu të koordinojë punën për realizimin e indikatorëve të ndërmjetëm.
3.	Në procedurën e prokurimit për kontratën “Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht” rezulton se mënyra e prokurimit ka qenë procedurë kombëtare me metodën e përcaktuar “Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentit (CQS)”. Zhvillimi i kësaj procedure referuar rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016,	Faqe 31-58	E LARTË	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia Prokurimit, të marrë masa që të analizojë metodologjitë e përzgjedhjes së mënyrave të prokurimit e ti argumentojë ato sipas kritereve për zgjedhjen e tyre.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	Seksioni VII, Metoda të Aprovuara të Përzgjedhjes së Shërbimeve të Konsulencës, pika 7.12 është e përshtatshme për detyra të vogla ose situata emergjente për të cilat nuk justifikohet vlerësimi i propozimeve konkurruese, gjithashtu referuar Manualit Operacional të Projekt, Pika 3, tabela 3.1 është përcaktuar kushti Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentin nën 300,000\$, në varësi të natyrës së detyrave. Për më tepër në Strategjinë për Zhvillimin e Prokurimeve të Projektit PPSD, pika IV-Objektivat e Prokurimeve, pika 2.2 specifikohet për (CQS) afati i përllogaritur është afërsisht 4-6 muaj përfshirë periudhën e nevojshme për përgatitjen dhe dakortësimin e termave të referencës. Mbështetur në Udhëzimet për Prokurime të Bankës Botërore, dokumenti “Strategjia për Zhvillim të Prokurimeve të Projektit, Udhëzues i Detajuar Format i Shkurtër, Korrik 2016”, rekomandohet argumentimi dhe logjik për Mënyrën e Prokurimit të zgjedhur. Konkretisht kjo procedure prokurimi ka zgjatur 9 muaj pra më shumë sesa periudha e përcaktuar si kriter për përzgjedhjen e saj, gjithashtu nuk është argumentuar përzgjedhja e kësaj metode për këto shërbime mbikëqyrje nga ana e Klientit duke mos marrë në konsideratë natyrën e detyrës për shërbimin e mbikëqyrjes.			
4.	Ndryshim i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës për “Shërbimet të Supervizionit për Rikonstruksionin e Rrugëve, afërsisht 45 km” RL.CP/1/1.6/2018Në datën 06.06.2019. Në Seksionin 7 Termat e Referencës, pika III “Kontrata e Shërbimit” janë përcaktuar 3 segmente rrugore në rikonstruksion, prej të cilave 2 segmente janë Fier-Seman dhe Qafë Thorë-Theth, ndërkohë segmenti i tretë i papërcaktuar. Në datën 12 Qershor 2019 është dakordësuar ndryshimi i termave të referencës mbi përbërjen e stafit të ekspertëve dhe kërkesat për ekspertët kryesor. Afati për dorëzimin e Kërkesës për Propozim për kontratën RL.CP/1/1.6/2018 është vendosur data 26.07.2019. Me Urdhrin Nr.07 datë 20.07.2019 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH, është ngritur komisioni i hartimit të fondit limit dhe termave të referencës për segmentin rrugor Gusmar-Kuç. Në zbatim të Marrëveshjes së Huasë me Bankën Botërore IBRD Nr.8850-AL datë	Faqe 31-58	E LARTË	Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve, pjesë e prokurimit të kontratave për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”. Gjithashtu, kompozimi i Komisioni të Vlerësimit për prokurimin e projekteve të huaja duhet të shërbejë forcimit të objektivitetit të vlerësimit, duke përfshirë punonjës të dedikuar me qëllim rritjen e llogaridhënies edhe gjatë procesit të prokurimeve.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	05.06.2018 janë nënshkruar marrëveshjet e investimit të FSHZH me bashkitë Tepelenë dhe Himarë në datat 11 Korrik 2019 dhe 18 Korrik 2019 lidhur me segmentet rrugore Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë. Në datën 03 Mars 2020, nga ana e FSHZH, është kërkuar negocimi për lidhjen e kontratës “Shërbimi i Supervizionit për rikonstruksionin e rrugëve (afërsisht 45 km)”, Ref.Nr. RL.CP/1/1.6/2018 me kandidatin potencial të radhës së dytë “Eptisa Servicios de Ingenieria” s.l. Në Minutat e Takimit, “Pjesa Teknike” pika 2, datë 06 Mars 2020, është vendosur për ndryshimin e segmenteve rrugore, në të cilin është hequr segmenti Qafë Thorë-Theth dhe në vend të tij është vendosur segmenti Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë. Referuar “Udhëzimit të Prokurimeve” të Bankës Botërore, Prill 2018, botimi i pare, seksioni IV, pika 6 “Lidhja e Kontratës”, nuk është parashikuar ndryshim i termave të referencës në këtë hap të procesit të prokurimit, por vetëm njoftimi i qëllimit të lidhjes, i cili përfshin periudhën e pauzës së procesit për ankimet e mundshme, përfundimi i kësaj periudhe dhe njoftimi për lidhjen e kontratës. Ndryshimi i qasjes teknike, apo ndryshimi i segmenteve rrugore në momentin e lidhjes së kontratës, ka shkaktuar deformim në procesin e prokurimit, për arsye se ndryshimi i termave të referencës, apo kushteve të kontratës kryhen përpara skadimit të afatit përfundimtar (deadline) të dorëzimit të Kërkesës për Propozim. Gjithashtu, pavarësisht nga ngjashmëria e kompleksitetit, segmentet ndryshojnë nga njëri tjetri dhe për pasojë ndryshon edhe kompozimi i stafit të ekspertëve, ditët e punës efektive të tyre, apo metodologjia e hartuar. Ndryshimi i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës ka shkaktuar si pasojë mungesën e njohjes me ndryshimet për të gjithë konsulentët potencial pjesëmarrës në tender. Sa sipër, në kundërshtim me pikën 13 “Sqarime dhe ndryshime të Kërkesës për Propozim, Seksioni 2 “Instruksionet për Konsulentët”, në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, si edhe në kundërshtim me Udhëzimin e Bankës IBRD “Rregullat e Prokurimit” 1 Korrik 2016, Seksioni V Sqarime të Dokumenteve të Prokurimit, Paragrafi 5.31 dhe 5.32.			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
5.	Ndryshimi i kushteve të pagesës së konsulentit jashtë kërkesave të termave të referencës për “Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore”, Kontrata RLRC/1/1.9/2018. Në raportin e vlerësimit datë 11 Shtator 2019, është rekomanduar lidhja e kontratës me konsulentin JV “Fred engineering” srl & “Infrakonsult” sh.p.k. me vlerën prej 187,680 USD përfshirë TVSH. Negociatat për lidhjen e kontratës me aplikantin potencial fitues të sipërcituar janë kryer në datat 12 dhe 18 Shtator 2019. Gjatë këtyre negociatave në datën 18.09.2019 është vendosur për ndryshimet si më poshtë: -Në pikën 6 të Minutave të Takimit, është hequr pagesa në avancë (paradhënie) e konsulentit dhe pagesat për konsulentin janë ndryshuar si më poshtë: -Fatura e dorëzuar pas përgatitjes të Raportit Fillestar dhe Raportet e Auditimit për tre segmentet e para të jetë 30 % e shumës totale të kontratës; -Fatura pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot të jetë 40 % e shumës totale të kontratës; -Fatura pas Raportit të Auditimit për segmentin e katërt rrugor të jetë 20 % e shumës totale të kontratës; -Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimi të Raportit përfundimtar. Por, në Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 “Termat e Referencës”, pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH) është përcaktuar se lidhur me pagesat për Konsulentin, ai duhet të dorëzojë faturat sipas programit si më poshtë: (i) Financimi paradhënie: Konsulenti ka të drejtë që me nënshkrimin e kontratës të paguhet me një paradhënie prej 20 % të çmimit total të vlerësuar përkundrejt një garancie bankare për shumën e marrë dhe e vlefshme deri në përfundimin e punës së kryer. (ii) Pagesa e faturës: Konsulenti do të lëshojë 3 fatura për shërbimet e kryera pas miratimit nga FSHZH deri në madhësinë prej 70 % të kontratës. Shuma prej 10 % e mbetur do të jetë paguar pas përfundimit dhe pranimi të Raportit Përfundimtar. (iii) Pagesa prej 10 %: Pas mbikëqyrjes të masave të implementuara dhe dorëzimit të Raportit Përfundimtar. Veprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë mospërputhje midis dispozitave të parashikuara gjatë procesit të prokurimit	Faqe 31-58	E LARTË	Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ardhmen në drejtim të menaxhimit me risk sa më të ulët të kontratave të konsulencës.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	dhe situatës së krijuar, si dhe ndryshimi i mënyrës së pagesës së Konsulentit ka sjellë si pasojë rritjen e riskut për përfundimin e detyrave të tij.			
6.	Në zbatimin e kontratës “Rikonstruksion i rrugës Gusmar-Kuç” konstatohet se referuar Vendimit Nr. 5 datë 28.02.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit i cili vendos miratimin me kusht të lejes së ndërtimit të infrastrukturës “Rikonstruksioni i segmentit të Rrugës Gusmar-Kuç” me vendndodhjen në Bashkinë Tepelenë dhe Himarë, me zhvillues Bashkinë Tepelenë dhe Bashkinë Himarë, subjekti nuk rezultoi të jetë pajisur me Dokumentin e Lejes së ndërtimit. Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” neni 27 dhe 28, dhe VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 ‘Për Miratimin E Rregullores së Zhvillimit të Territorit’ të ndryshuar, neni 25 pika 11 dhe 13.	Faqe 61-71	E LARTË	FSHZH dhe strukturat përkatëse, të marrin masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit, nga të gjitha palët e përfshira në projekt, për pajisjen me leje ndërtimore sipas legjislacionit në fuqi për shmangien e problematikave që mund të lindin gjatë zbatimit të punimeve.
7.	Për objektin <u>“Rikonstruksion i Rrugës Pogradec-Tushemisht”</u> , sipas kontratës të lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe BOE “...A...” shpk & “G” shpk me referencë RLRCP/1/1.2/2018 datë 27.05.2019, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë 314,490,318 lekë pa TVSH ose 377,388,382 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 8 muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve) rezultoi se; në librezat e masave dhe në situacionin përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera për dy zëra në shumë 373,975 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si dhe 10 zëra punimesh të dëmtuara që duhet të riparohen gjatë fazës së garancisë në shumën 472,447 lekë pa TVSH . Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit me objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht”, Nr. RLRCP/1/1.5/2018 datë 27.05.2019.	Faqe 61-71	E LARTË	FSHZH të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës 373,975 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE “...A...” SHPK & “G.” SHPK, si dhe kryerjen e punime të dëmtuara brenda afatit të garancisë së tyre në shumën 472,447 lekë pa TVSH , e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. RLRCP/1/1.2/2018 datë 27.05.2019 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Pogradec-Tushemisht”.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
8.	Për objektin “Rindërtimi i Rrugës Qafë Thorë-Theth”, sipas kontratës të lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe BOE "G. Com." shpk & "Gj." shpk me referencë RLRC/1/1.1/ 2018 datë 08.07.2019, në lidhje me zbatimin e punimeve civile, me vlerë 613,585,590 lekë pa TVSH ose 736,302,708 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 10 muaj, rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (IPC nr. 4) volume pune jo të pasqyruara në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe të pa shoqëruara me dokumentacionin plotësues. Këto diferenca rezultuan në 5 (pesë) zëra punimesh në shumën 15,137,872 Lekë pa TVSH të cilat janë reflektuar në situacionin pasardhës. Pavarësisht rregullimit, certifikimi i tyre pa dokumentacionin justifikues është në kundërshtim me Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit sipas amendamenteve Nr.1 datë 08.07.2019 dhe Nr. 2 date 02.04.2020 me objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht”, për supervizionimin e kontratës së zbatimit të rrugës Qafë Thorë-Theth.	Faqe 61-71	E LARTË	FSHZH të marrë masa që në të ardhmen të mos kryej pagesa situacionesh pa dokumentacion justifikues duke mos tejkaluar buxhetin e programuar kohor e shmagur kështu vendosjen në vështirësi të likuiditeteve të saj.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së projektit “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë¹

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e FSHZH sa i përket Projektit “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000²)

¹ Mbështetur mbi ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

² **ISSAI 4000** – Udhërrëfytyrë i Auditimit të Përputhshmërisë.

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e projektit rezultoi se:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë së tij që lidhen me menaxhimin e projektit. Problematikat e evidentuara i referohen mos përcaktimit të Personelit të Dedikuar për projektin siç është parashikuar në marrëveshjen e financimit me Bankën Botërore dhe mos vlerësim të objektivave të përcaktuara në marrëveshjet e financimit me qëllim vlerësimin e rezultateve të punës së deritanishme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka kërkuar shpjegime për tre procedura me oferta anomalisht të ulta të cilat mund të ndikojnë në realizimin e punimeve civile me cilësi në kohën e parashikuar. Gjithashtu në dy projekte, ku punimet janë në proces, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në pagesat e ndërmjetme janë certifikuar punime të pa kryera dhe pa dokumentacion justifikues, në vlerën totale 16,370,294 lekë pa TVSH.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 254/1 Prot. datë 25.02.2021, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.03.2021 deri me datë 30.04.2021, në subjektin *Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Projekti “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”*, për periudhën nga fillimi i Projektit (2016) deri më 31.12.2020, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë” nga:

Grupi i auditimit me përbërje:

1. S. H. , Përgjegjës Grupi
2. S. B. , Audituese
3. M. R. , Audituese
4. E. S. , Auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Objekti kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që PMU (*Program Management Unit – Njësia e Menaxhimit të Programit*) ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të Marrëveshjeve Financiare si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullshmërinë, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të zbatimit të Projektit.

2. Qëllimi i auditimit

Auditimi ka për qëllim **promovimin e transparencës** duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim **promovimin e përgjegjshmërisë** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. *Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

3. Identifikimi i çështjes:

PMU duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të shërbimit të ofruar nga Projekti duke pasur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Struktura brenda FSHZH^{së}, përgjegjëse për menaxhimin e Projektit objekt auditimi, janë si më poshtë:

- DEPARTAMENTIN I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE/PROGRAMEVE;
 - NJESITË E MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE/PROGRAMEVE;
- *Njësia e Menaxhimit të Projekteve/Programeve të Ndërhyrjeve të Infrastrukturës Rrugore që përfshin: Programet e Rrugëve Lidhëse Rajonale dhe Lokale, të financuara nga BERZH dhe Banka Botërore; Projektin e Rrugës së Lumit të Vlorës financiar nga Fondi Kuvajtian dhe Fondi Saudit si dhe çdo program/projekt të kësaj fushe, me zbatimin e të cilit do të ngarkohet FSHZH.*
 - DEPARTAMENTI I FINANCËS;
 - DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I PROKURIMIT;

Struktura jashtë FSHZH^{së}, përgjegjëse për menaxhimin e Projektit objekt auditimi, janë si më poshtë:

- Sipërmarrësi i punimeve për *Rehabilitimin e rrugës Pogradec – Tushemisht*, B. "...A..." shpk & "G..." shpk, me të cilin është lidhur kontrata RLRCP/1/1.2/2018 në datë 27.05.2019 mes këtij BOE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë 377,388,382 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 8 muaj si dhe me afat të garancisë së punimeve 18 muaj.

- Sipërmarrësi i punimeve për Rindërtimin e rrugës Qafë Thore-Theth, BOE "G...." shpk & "Gj..." shpk, me të cilin është lidhur kontrata RLRC/1/1.1/2018 në datë 08.07.2019 mes këtij BOE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë 736,302,708 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 10 muaj si dhe me afat të garancisë së punimeve 18 muaj.
- Sipërmarrësi i punimeve për Rehabilitimin e rrugës Bënç- Lekdush, OE "C. O. L. S", me të cilin është lidhur kontrata RLRC/1/1.10/2018 në datë 30.12.2019 mes këtij OE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë \$ 2,474,793 me TVSH (269,455,461 lekë me TVSH), me afat përfundimi të punimeve 12 muaj si dhe me afat të garancisë së punimeve 18 muaj.
- Sipërmarrësi i punimeve për Rehabilitimin e rrugës Kuç- Gusmar, OE "R. A. ", me të cilin është lidhur kontrata RLRC/1/1.4/2019 në datë 03.12.2019 mes këtij OE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë \$ 5,780,441 me TVSH (640,472,862 lekë me TVSH), me afat përfundimi të punimeve 12 muaj si dhe me afat të garancisë së punimeve 18 muaj.
- Kompania konsulente "E. S. D." SL me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit RLRC/1/1.6/2018 në datë 17.04.2020 mes këtij OE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë të kontratës \$ 816,024 me TVSH (94,446,618 lekë me TVSH) me afat të zbatimit të kontratës 22 muaj nga data e fillimit të shërbimit të konsulencës. Sipas kësaj kontrate konsulenti do të kryej shërbime mbikëqyrje të punimeve civile të rrugëve të projektit (afërsisht 45km).
- Kompania konsulente "T. H. Con. " shpk kompani shqiptare me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit RLRC/1/1.5/2019 në datë 27.05.2019 mes këtij OE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë të kontratës 21,360,000 Lekë me TVSH e cila është amenduar dy herë.
- Sipërmarrësi i punimeve për Rehabilitimin e rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll, OE "G..." shpk, me të cilin është lidhur kontrata DTM50123/W/2020/2 në datë 03.12.2020 mes këtij OE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë \$ 15,001,025.77 me TVSH (1,535,955,029 lekë me TVSH), me afat përfundimi të punimeve 12 muaj si dhe me afat të garancisë së punimeve 18 muaj.
- Sipërmarrësi i punimeve për Rehabilitimin e rrugës Vlorë-Orikum, OE A ..T.- SH me të cilin është lidhur kontrata DTM50123/W/2020/1 në datë 07.12.2020 mes këtij OE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë \$ 8,674,246.62 me TVSH (887,462,172 lekë me TVSH), me afat përfundimi të punimeve 12 muaj si dhe me afat të garancisë së punimeve 18 muaj.
- BOE Pan Arab Engineers (P.) & E G ltd'' kompani Kuvajtiane dhe Shqiptare me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit DTM50123/CS/2020/4 në datë 28.12.2020 mes këtij BOE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë të kontratës \$ 986,160 me TVSH (99,345,758 lekë me TVSH).

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji Nr. 54/2018 datë 23.07.2018 "*Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale*"; Ligji Nr. 44/2020 datë 23.04.2020 "*Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri*"; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Ligji nr.

43/2016 “Për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Manualin e Procedurave të Fondin Shqiptar të Zhvillimit; etj.

7. Standardet e auditimit

-Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- **ISSAI (100)** “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- **ISSAI (400)** “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë” që përcakton parime themelore **ISSAI (100)** dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- **ISSAI (4000)** “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe **ISSAI (4200)**;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve (IFAC);
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI⁴;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;

8. Metodat e auditimit

- Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyrë të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.
- Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.
- Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj. Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet

e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, Statusi juridik, FSHZH-ja është person juridik dhe gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse; gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike; ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me statutin, manualin e procedurave, si dhe me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e financimit dhe të zbatimit të projekteve si dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Fusha e veprimtarisë së FSHZH-së është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit me fokus rajonal, lokal dhe territorial, në interes të publikut. Objektivat e këtij institucioni janë:

a. përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore;

b. përmirësimi i shërbimeve publike vendore;

c. nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Kompetencat përshkruhen si më poshtë:

a. menaxhimi i projekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm që kanë si qëllim zhvillimin rajonal dhe vendor;

b. dhënia e mbështetjes financiare në të gjitha format: si grant, hua, garanci dhe forma të tjera për njësitë e pushtetit vendor, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;

c. dhënia e mbështetjes teknike për zbatimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e investimeve, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;

d. dhënia e asistencës teknike dhe kryerja e trajnimeve, për rritjen e kapaciteteve institucionale të pushtetit vendor;

e. kryerja e veprimtarive të ndryshme, në funksion të zbatimit të politikave e të instrumenteve të zhvillimit rajonal dhe vendor.

Projekti objekt auditimi “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” është një Projekt i cili parashikon ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin dhe financohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë financimi 100 milionë USD.

Në fazën e parë, të financuara nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) është finalizuar një listë financimi për vitin e parë të programit, për rreth 60 km rrugë, për të cilat, me dakordësinë e Bankës Botërore dhe fondet e buxhetit të shtetit, është kryer procesi i prokurimit dhe kontraktimit të projektimit. Bashkitë kanë identifikuar rrugët rurale potenciale për rehabilitim dhe më pas renditja dhe priorizimi i tyre është bërë mbi bazën e 4 kriterëve që janë rëndësia e turizmit, potenciali agro-kulturor, analiza kosto benefit dhe popullsia përfituese. Konkretisht kanë përfunduar variantet finale të projekt zbatimit për segmentet rrugore Qafë Thore-Theth, Pogradec-Tushemisht, Fier-Seman, Bënçë-Lekdush dhe Gusmar-Kuç, dhe janë në zbatim:

- Qafë Thore-Theth;

- Lekdush-Bënçë-Tepelenë, Lot II; Parashikohet që financimit të këtyre segmenteve rrugore t’u shtohen edhe segmente të tjera prioritare të cilat kanë peshën më të madhe të llogaritur referuar kriterëve të sipërpërmendura nga lista me 158 rrugë të identifikuar. Përfshirja e segmenteve të reja rrugore parashikohet të formalizohet në të ardhmen.

Më poshtë disa detaje mbi segmentet e para të cilat do të financohen:

□ Qafë Thore-Theth, 16.18 km; Segmenti përfundon lidhjen e fshatit dhe parkut kombëtar të Thethit, një rrugë shumë e dëmtuar dhe e rrezikshme në një zonë gjithnjë e më të frekuentuar në veçanti nga turistët e huaj. Për zbatimin e punimeve në këtë segment është lidhur kontrata e

punimeve civile me referencë RLRC/1/1.1/2018 datë 08.07. 2019 me BOE "G..." & "Gj.... shpk" me vlerë 7,272,125 \$ US me TVSH. Ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është përcaktuar operatori "T. H. shpk" sipas amendimit nr. 1 të kontratës me referencë RLRC/1/1.5/2018 datë 27.05. 2019 me vlerë

□ Pogradec-Tushemisht Lot I, 3.6 km; Është pjesë e rrugës kryesore që lidh Pogradecin me Tushemishtin dhe me pikën kufitare të Maqedonisë. Investimi në këtë rrugë që është në linjën e brendshme të liqenit krijon mundësinë e ri-konceptimit si hapësirë e madhe publike e vijës së bregut të liqenit nga Pogradeci në Drilon. Për zbatimin e punimeve në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve civile me referencë RLRC/1/1.2/2018 datë 27.05.2019 me BOE "...A..." shpk & "G..." shpk me vlerë 3,727,292 \$ US me TVSH. Ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është përcaktuar operatori "T. H. Con. THC" shpk sipas kontratës me referencë RLRC/1/1.5/2018 datë 27.05. 2019 me vlerë 21,360,000 lekë me TVSH.

□ Bëç-Lekdush-Tepelenë Lot II; Rruga shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Shqipërisë, në zonën e Kurveleshit. Ajo lidh njëra pas tjetrës fshatrat nga Bëç me Lekdush. Rruga e re parashikon ndërtimin e të gjitha strukturave të reja, zgjerimin e trupit të rrugës deri në 6.5 m, ndërtimin e shtresave rrugore përfshirë asfaltimin, instalimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale. Rruga e re do të rrisë sigurinë dhe shpejtësinë e udhëtimit dhe do të ulë kostot e transportit. Për zbatimin e punimeve në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve civile me referencë RLRC/1/1.10/2018 datë 30.12.2019 me OE "C. O. I. t. S. V. T. As Tur." me vlerë 2,474,793 \$ US me TVSH. Ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është përcaktuar operatori "EP. S. Ing." sipas kontratës me referencë RLRC/1/1.6/2018 datë 27.05. 2019 me vlerë, 816,024 \$ US me TVSH.

□ Gusmar-Kuç; Rruga lidh Tepelenën, Gjirokastrën dhe Përmetin me rrugën e Lumit të Vlorës dhe bregun e detit, duke krijuar një lidhje mes turizmit bregdetar me turizmin natyror, kulturor dhe historik. Për zbatimin e punimeve në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve civile me referencë RLRC/1/1.4/2018 datë 03.12.2019 me OE "R..... S. A." me vlerë 5,780,441 \$ US me TVSH. Ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është përcaktuar operatori "E. S." sipas kontratës me referencë RLRC/1/1.6/2018 datë 27.05.2019 me vlerë, 816,024 \$ US me TVSH.

Programit të financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim (BNRZH) do ti shtohen edhe dy rrugë të tjera:

1. Rruga Roskovec-Poshnjë;
2. Rruga "Zona turistike-Golem-Kavajë".

Në fazën e dytë, në kuadër të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim datë 10.02.2020, është finalizuar një listë financimi për segmentet rrugore Shëngjin Baks-Rrjoll, Ujë i Ftohtë-Orikum dhe ndërtimin e 2 by-pass-eve, dhe segmenti rrugor Zgosht-Ura e Çerenecit.

Pjesa e dyte e projektit përbëhet nga 4 pjesë konkretisht.

Pjesa A e cila financohet nga Transhi 1

Rehabilitimi dhe zgjerimi i segmentit rrugor me gjatësi 10.6 km duke përfshirë dy devijime të vogla midis qytetit të Vlorës dhe Orikumit përgjatë bregdetit jugor të Shqipërisë.

Pjesa B e cila financohet nga Transhi 1

Rehabilitimi i segmentit rrugor me gjatësi rreth 13km midis Shëngjinit dhe Baks-Rrjoll (Velipoje) në bregdetin verior të Shqipërisë.

Pjesa C e cila financohet nga Transhi 1

Mbikëqyrja e punimeve për pjesën A dhe pjesën B

Pjesa D e cila financohet nga Transhi 2

Përmirësimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor Zgosht-Ura e Çerenecit me gjatësi rreth 47.1 km dhe mbikëqyrja e punimeve përkatëse.

Ka përfunduar projektimi dhe është në proces prokurimi objekti "Sistemim asfaltimi i rrugës Zgosht-Ura e Çerenecit", ndërsa për dy objektet e para "Ndërtimi i Rrugës Shëngjin Baks-Rrjoll"

dhe “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë-Orikum dhe ndërtimi i 2 by-pass-eve” projekti i zbatimit ka përfunduar dhe janë lidhur kontratat e punimeve të ndërtimit.

□ Shëngjin Baks-Rrjoll. Ky segment rrugor do të jetë një aks i ri që lidh këto dy qendra të rëndësishme të turizmit dhe pritet t’i japë një zhvillim të ri gjithë rajonit. Për nga ana administrative ky segment rrugor parashikohet të shtrihet në dy Qarqe në atë të Shkodrës dhe në Qarkun e Lezhës. Rruga ka një gjatësi prej rreth 12.4 km, nga të cilat afro 6 km e para shtrihen në rrethin e Lezhës dhe në vijim në atë të Shkodrës. Për zbatimin e punimeve civile, në këtë segment, është lidhur kontrata e punimeve civile me referencë DTM50123/W/2020/2 datë 03.12.2020 me OE “G...” me vlerë 15,001,025.77 \$ US me TVSH. Ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me BOE “P. & E.” sipas kontratës me referencë DTM5..23/CS/2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 US \$ me TVSH.

□ Ujë i Ftohtë-Orikum + ndërtimi i 2 by-pass-eve. Projekti synon që të realizojë një ndërhyrje në përmirësimin e kushteve të lëvizjes në segmentin ekzistues rrugor nga Dalja e Tunelit tek Uji i Ftohtë deri tek Marina Orikum, si dhe ndërtimi i dy by-pass-eve përpara dhe pas fshatit Radhimë. Kjo rrugë u shërben jo vetëm banorëve të zonës midis Ujit të Ftohtë deri në Orikum, por edhe të gjithë turistëve vendas dhe të huaj të cilët frekuentojnë zonën bregdetare jugore të Shqipërisë. Projekti fillon në dalje të Tunelit tek Uji i Ftohtë, Vlorë dhe përfundon tek Marina në Orikum, me një gjatësi totale prej 10.75 km. Projekti parashikon ndërhyrje rikonstruksioni për rrugën ekzistuese nacionale Vlorë-Orikum dhe ndërtimin e dy by-pass-eve përpara dhe pas fshatit Radhimë. Për zbatimin e punimeve civile, në këtë segment, është lidhur kontrata e punimeve civile me referencë DTM5..23/W/2020/1 datë 07.12.2020 me OE “A...-M.” me vlerë 8,674,246.62 US\$ me TVSH. Ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me BOE “P. & E.-G” sipas kontratës me referencë DTM5..23/W/2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 US \$ me TVSH.

□ Zgosht-Ura e Çerenecit me gjatësi 47,166 km, është vazhdim i rrugës Librazhd-Qafë Studë-Ura e Çerenecit me gjatësi totale 56,9 km. Segmenti rrugor fillon nga fshati Zgosht (Njësia administrative Lunik), bashkia Librazhd dhe përfundon në fshatin Çerenec i Poshtëm (Njësia Administrative Gjoricë), bashkia Bulqizë Njësitë administrative përfituese janë: Gjoricë, Ostren, Trebisht të Bashkisë Bulqizë dhe Stebleve, Lunik dhe Qendër të Bashkisë Librazhd. Rruga Librazhd-Qafë Studë-Ura e Çerenecit është zbatuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARrSh) deri në shtresën e stabilizantit në të tërë gjatësinë e saj, ndërsa 9,6 km e para me fillim rrugë nga Librazhdi janë përfunduar dhe me shtresat asfaltike dhe sinjalistikë (të përfunduara nga FSHZH). Traseja e këtij segmenti rrugor është ndërtuar shumë vite më parë por pa u përfunduar plotësisht me të gjitha shtresat. Mos përfundimi i rrugës në kohën e duhur si dhe terrenin malor me dimër të gjatë (ngrica e dëborë), ka pësuar dëmtime në shtresat e saj.

Më poshtë kontratat e lidhura dhe statusi i tyre deri në fund të periudhës së audituar:

<u>Nr.</u>	<u>Objekti i Kontratës</u>	<u>OE/BOE</u>	<u>Vlera e Kontratës (\$ US me TVSH)</u>	<u>Data e lidhjes së Kontratës</u>	<u>Afati</u>	<u>Statusi</u>
BERZH/EBRD						
1	<i>Ndërtim i Rrugës Shëngjin Velipojë</i>	G.	15,001,025.77	03.12.2020	12 muaj	Nuk ka nisur
2	<i>Sistemim Asfaltim i Rrugës Vlore-Orikum</i>	A.....	8,674,246.62	07.12.2020	12	Nuk ka nisur
3	<i>Supervizionimi i BERZH</i>	P. & E.	986,160.00	28.12.2020		Nuk ka nisur
IBRD						
1	<i>Rikonstruksion i Rrugës Lekdush-Bënç- Tepelenë Loti 2</i>	C. O.	2,474,793.00	30.12.2019	12 muaj	Në proces
2	<i>Rikonstruksion i rrugës Gusmar-Kuç</i>	R.-A. C. EST	5,780,441.00	03.12.2019	12 muaj	Në proces

3	Shërbime të supervizionit për rikonstruksionin e rrugëve, afërsisht 45 km	E.S.DE.ING.SL	816,024.00	17.04.2020		Në proces
4	Rikonstruksion i rrugës Qafe Thore -Theth", Shkodër"	BO. "G....." & "GJ...."	7,272,125.51	06.05.2019	10 muaj	Punimet janë pezulluar deri më 15.05.2020(do fillojnë përsëri)
5	Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht""	BO. "...A.." & G.."	3,727,292.66	06.02.2019	8 muaj	Punimet janë në periudhën e garancisë
6	Shërbime konsulence për objektin Qafe Thore–Theth, Bashkia Shkodër	T.....	390,992.59	08.07.2019		Në proces
7	Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore	BO. "F...." & "I...."	187,680.00	29.10.2019		Përfunduar
Shuma Totale			45,310,781.15			

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit dhe raportimi i tyre.

Projekti i “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) me Nr. P163239 është financuar nga 2 marrëveshje huaje në vlerën e 100 mil US \$ si më poshtë:

-Marrëveshja 50 mil US \$ Nr. 8850-AL, datë 05.06.2018, me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), e cila është ratifikuar me Ligjin Nr. 54/2018 datë 23.07.2018.

-Marrëveshja e Huas Nr. 50123, në shumën 50 mil US \$, me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim EBRD, datë 10.02.2020, e cila është ratifikuar me Ligjin Nr. 44/2020, datë 23.04.2020.

Në Projektin e mësipërm janë përfshirë 3 komponentë bazë si më poshtë:

-Punime rehabilitimi të qëndrueshme ndaj kushteve klimaterike si edhe shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin.

-Zhvillimi i kapaciteteve të Njërive të Qeverisjes Vendore për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor në pronësi të tyre, si edhe maksimizimi i efekteve potenciale nga futja e përmirësuar e konkurrencës bujqësore dhe potenciale turistike.

-Mbështetja menaxhuese për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, si Njësi e Zbatimit të Projektit, duke ofruar kosto operacionale shtesë për zhvillime trajnimesh, si edhe mirëmbajtjen e Sistemit Informatik Gjeografik (GIS), etj.

Në Marrëveshjen e Huasë Nr.8850-AL datë 05.06.2018, 50 mil US\$, ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Qeverisë Shqiptare, në Skedulën 2 të saj, është përcaktuar se Personeli i Dedikuar për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” (RLRCP) përbën një organizim institucional në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Në marrëveshjen e sipërcituar, personeli i dedikuar duhet të kryejë mbikëqyrjen dhe koordinimin e projektit me kontributet teknike të bashkive të përzgjedhura. Gjithashtu, personeli i dedikuar është ngarkuar me zbatimin e projektit, duke u përfshirë në tre drejtime kryesore atë të prokurimit, të menaxhimit financiar dhe menaxhimit të kontratave në të gjitha aktivitetet e projektit.

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, në datën 30 Gusht 2018 me dakordësinë e Bankës është hartuar dhe miratuar Manuali Operacional nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si një instrument për zbatimin e projektit.

Në Manualin Operacional pika 1, shkronja (d) *Fondi Shqiptar i Zhvillimit*, është përcaktuar se në përbërje të Personelit të Dedikuar duhet të jenë përfshirë një Projekt Menaxher Inxhinier, një Specialist Menaxhimi Financiar, një Specialist Prokurimesh, një Specialist Mjedisi, një Specialist

Social dhe inxhinierë të fushës. Përveç kësaj, FSHZH mund të punësojë konsulentë ose mbështesë me staf, të cilët do të punojnë sipas mënyrës on-call basis, në varësi nga nevojat specifike të aktiviteteve. Këto mund të përfshijnë specialistë bujqësor dhe turizmi.

Gjithashtu, në Aneksin 2 të Manualit Operacional është prezantuar struktura organizative e FSHZH, e cila tregon se çdo Njësi Menaxhimit të Projekteve/Programeve është në varësi direkt nga Drejtori Ekzekutiv, i cili është edhe përfaqësuesi zyrtar që nënshkruan kontratat e financuara nga marrëveshjet e huave të mësipërme.

Në Vendimin Nr. 186, datë 25.07.2019 të Këshillit Drejtues është vendosur për disa ndryshime në strukturën organizative dhe manualin e procedurave administrative të FSHZH.

Në seksionin II. 1 të vendimit të sipërcituar është vendosur se Njësitë e Menaxhimit të Projekteve do të kenë varësi nga Drejtori i Departamentit të Menaxhimit të Projekt/Programeve. Përgjegjësi i Njesisë Menaxhimit të Projektit është edhe Menaxheri i Projekt/Programit që zbaton njësia përkatëse. Gjithashtu, ngritja e njësive të menaxhimit të projekteve të reja bëhet me vendim të Drejtorit Ekzekutiv.

Gjithashtu, në seksionin II. 5, të po këtij vendimi, nënkapitulli 2.7.3 në manualin e procedurave administrative, kapitulli “Njësitë e Menaxhimit të Projekt/Programeve” pika 77 shkronja (d), është vendosur si më poshtë:

Njësia e Menaxhimit të Projekt/Programeve të Ndërhyrjeve të Infrastrukturës Rrugore, përfshin programet e rrugëve lidhëse rajonale, të financuara nga BERZH dhe Banka Botërore, Projektin e Rrugës së Lumit të Vlorës, financiar nga Fondi Kuvajtian dhe Fondi Saudit, si edhe çdo program të kësaj fushe me zbatimin e të cilit do të ngarkohet FSHZH.

Gjithashtu, nga vendimi i sipërcituar është përcaktuar se në varësi të llojit, fazës dhe volumit të projekt/programeve, që përfshihen në një njësi menaxhimi, Drejtori Ekzekutiv mund të vendosë edhe përcaktimin e një menaxheri që do të ndjekë në mënyrë specifike një prej projekt/programeve që përfshihen brenda një njësie.

Nga auditimi rezulton se është ndryshuar struktura e FSHZH, duke “shpërndarë” jo- vetëm personelin, që rezulton të jetë përgjegjës për disa projekte të ndryshme, por edhe duke shpërndarë edhe përgjegjësinë që duhet të ketë Drejtori Ekzekutiv i FSHZH (shih organi-gramën aneks 2 në Manualin Operacional).

Në Vendimin Nr. 50 datë 01.08.2019 “Për Komandim në Pozicion Pune”, është komanduar Drejtori i Departamentit të Menaxhimit të Projekteve/Programeve z. E. O., ndërkohë që sipas kontratës së punës deri në këtë moment përgjegjësia e tij ishte Përgjegjës Njësie Menaxhimi Projekti i papërcaktuar.

Në fakt z. E. O., përveç detyrave të tjera, mbulonte edhe menaxhimin e projektit “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) P163239, por për këtë nuk rezulton vendim emërimi i dedikuar, apo urdhër nga Drejtori Ekzekutiv.

Në Vendimin Nr. 19, datë 18.03.2019 “Për Emërim në Pozicion të Ri Pune”, z. D. M. A. është emëruar në pozicionin e Përgjegjës të Njesisë të Menaxhimit të Projektit të Lumit të Vlorës. Gjithashtu, në Vendimin Nr. 53, datë 01.08.2019 “Për Krijimin e Njesisë së Menaxhimit të Projekteve/Programeve të Ndërhyrjeve të Infrastrukturës Rrugore”, është krijuar Njësia e Menaxhimit të Projekteve/Programeve të Ndërhyrjeve të Infrastrukturës Rrugore, si edhe është emëruar z. D. M. A. në pozicionin përgjegjës i kësaj njësie.

Në fakt, kjo njësi menaxhimi kishte përfshirë programet e rrugëve lidhëse rajonale, të financuara nga BERZH dhe Banka Botërore, Projektin e Lumit të Vlorës, financiar nga Fondi Kuvajtian dhe Fondi Saudit, si edhe çdo program të kësaj fushe me zbatimin e të cilit do të ngarkohet FSHZH.

Gjatë auditimit nuk rezultojnë akte emërimi ose urdhra specifikisht për menaxhimin e projektit “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) P163239. Gjithashtu, edhe për punonjësit e tjerë që janë në fakt të angazhuar në këtë projekt, nuk janë konstatuar akte emërimi të dedikuara për projektin.

Sa sipër, është në kundërshtim me kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Skedulin 2 seksioni I gërma (A) të Marrëveshjes të Huasë Nr. 8850-AL datë 05.06.2018.

Veprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë vështirësi në komunikimin administrativ dhe koordinimin e aktiviteteve të këtij projekti.

Megjithëse janë realizuar raportet periodike të progresit të aktiviteteve të këtij projekti, është konstatuar se ka parregullsi gjatë monitorimit të tij. Në të pesta raportet 3 mujore, që FSHZH kishte prezantuar për Bankën deri në datën 31 Dhjetor 2020, është konstatuar se nga ana e FSHZH është raportuar se: Rikonstruksioni i rrugës Fier-Seman është në proces prokurimi dhe i papërfunduar. Në të njëjtën kohë nga plani i përmirësuar i prokurimit të aktiviteteve të projektit “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) P163239 datë 16 Qershor 2020, është deklaruar anulimi i këtij prokurimi.

Gjithashtu, në vendimin Nr. 203 datë 06.04.2020 të Këshillit Drejtues është theksuar angazhimi i fondeve prej 25 mil US\$, që vinin nga heqja e segmentit rrugor Fier-Seman, në dy segmente të tjera rrugore prioritare.

Në procesin e implementimit të projektit “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) P163239, nuk është respektuar kushti i përgjithshëm i marrëveshjes së huas me Bankën Botërore për krijimin e personelit të dedikuar specifikisht për projektin e mësipërm.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit nuk ka zbatuar kërkesat që rrjedhin nga Marrëveshja e Huas, Skeduli 2, Seksionin I A, pika 1, Nr. 8850 datë 05.06.2018, si e edhe nga Manuali Operacional, pika 1, shkronja (e) dhe Aneksi 2 i saj.

Veprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë mungesa në komunikimin administrativ (mungesa e akteve për anulimin e prokurimit të segmentit Fier-Seman) dhe koordinimin e aktiviteteve të këtij projekti.

2.1.1 Titulli i gjetjes: Mungesa e strukturës dhe personelit të dedikuar për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) P163239.

Situata: Në Marrëveshjen e Huas nr.8850-AL datë 05.06.2018, me vlerë 50 mil US\$, ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Qeverisë Shqiptare, në Skedulin 2 të saj, është përcaktuar se Personeli i Dedikuar për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” (RLRCP), përbën një organizim institucional në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Në Manualin Operacional, datë 30.08.2018, pika 1, shkronja (d) Fondi Shqiptar i Zhvillimit, është përcaktuar se në përbërje të Personelit të Dedikuar duhet të jenë përfshirë një Projekt Menaxher Inxhinier, një Specialist Menaxhimi Financiar, një Specialist Prokurimesh, një Specialist Mjedisi, një Specialist Social dhe inxhinierë të fushës. Përveç kësaj, FSHZH mund të punësojë konsulentë ose mbështesë me staf, të cilët do të punojnë sipas mënyrës on-call basis, në varësi nga nevojat specifike të aktiviteteve. Në Vendimin nr.186, datë 25.07.2019 të Këshillit Drejtues është vendosur për disa ndryshime në strukturën organizative dhe manualin e procedurave administrative të FSHZH, kapitulli “Njësitë e Menaxhimit të Projekt/Programeve” shkronja (d) pika 78 është vendosur se: “Në varësi të llojit, fazës dhe volumit të projekt/programeve, që përfshihen në një njësi menaxhimi, Drejtori Ekzekutiv mund të vendosë edhe përcaktimin e një menaxheri që do të ndjekë në mënyrë specifike një prej projekt/programeve që përfshihen brenda një njësie. Nga auditimi rezulton se është shpërndarë personeli, i cili rezulton të jetë përgjegjës për disa projekte të ndryshme, gjithashtu është shpërndarë edhe përgjegjësia që duhet të ketë Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, i cili në zbatim të Manualit Operacional (aneksi 2) të projektit duhet të ketë në varësi direkt Njësitë e Menaxhimit të Projekt/Programeve si dhe nuk rezultojnë akte emërimi ose urdhra specifikisht për menaxhimin e projektit “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) P163239.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit nuk ka zbatuar kërkesat që rrjedhin nga Marrëveshja e Huas, Skeduli 2, Seksionin I A, pika 1, nr.8850 datë 05.06.2018, si edhe nga Manuali Operacional, pika 1, shkronja (e) dhe Aneksi 2 i saj.

Kjo ka sjellë mungesën e koordinimit për zhvillimin e prokurimeve të kontratave gjatë implementimit të projektit.

Kriteri: Marrëveshja së Huas nr. 8850-AI datë 05.06.2018, Seksioni I germa (A), ku përcaktohet që: *Organizimi institucional i Zbatuesit të Projektit përbëhet nga:*

1. Personeli i Dedikuar

Huamarrësi mundëson që Njësia e Zbatimit të Projektit të plotësojë kërkesat si më poshtë:

a) të ketë gjatë gjithë zbatimit të projektit, personel të dedikuar me kualifikime, eksperiencë dhe terma reference të kënaqshme për Bankën;

b) të sigurojë që personeli i dedikuar të kryejë mbikëqyrjen dhe koordinimin e projektit lidhur me kontributet teknike të bashkive të përzgjedhura;

c) të kryejë zbatimin e projektit, duke përfshirë menaxhimin financiar, prokurimin, dhe menaxhimin e kontratave.

Manuali Operacional datë 30.08.2018, pika 1, shkronja (d), Seksioni Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ku përcaktohet që: *“Në përbërje të Personelit të Dedikuar duhet të jenë përfshirë një Projekt Menaxher inxhinier, një Specialist Menaxhimi Financiar, një Specialist Prokurimesh, një Specialist Mjedisi, një Specialist Social dhe inxhinierë të fushës”.*

Vendimi nr. 186, datë 25.07.2019 të Këshillit Drejtues të FSHZH Seksionin II. 5 pika 78, ku përcaktohet që: *“Në varësi të llojit, fazës dhe volumit të projekt/programave, që përfshihen në një njësi menaxhimi, Drejtori Ekzekutiv mund të vendosë edhe përcaktimin e një menaxheri që do të ndjekë në mënyrë specifike një prej projekt/programave që përfshihen brenda një njësie. Në varësi të llojit të projekteve dhe fazës së zbatimit të tyre, në një NJMP mund të alokohen më shumë se një projekt”.*

Ndikimi/Efekti: Mungesa e koordinimit të aktiviteteve brenda projektit.

Shkaku: Nuk zbatohen kushtet e përgjithshme të marrëveshjes së huas.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për identifikimin dhe emërimin e personelit të dedikuar për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”, me qëllim koordinimin e aktiviteteve në përbërje të tij.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. D. A. me detyrë Drejtor Ekzekutiv i FSHZH dhe në cilësinë e menaxherit më të lartë përfaqësues në implementimin e projektit.

2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësin.

Projekti “Konektiviteti i rrugëve, rajonale dhe lokale në Shqipëri” rregullohet me ligjin nr. 54/2018, datë 23.07.2018, “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, dhe Ligjin nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim” për financimin e projektit.

Në Marrëveshjet e Projektit, është përcaktuar qëllimi i përgjithshëm i tij, *i cili është të ndihmojë Huamarrësin për rehabilitimin dhe përmirësimin e segmenteve rrugore në rrjetin e vet rrugor rajonal dhe vendor me synim të përmirësojë konektivitetin midis rajoneve të Shqipërisë dhe të jap kontribut për zhvillimin ekonomik veçanërisht në sektorët e bujqësisë dhe turizmit si dhe të forcojë kapacitetet e bashkive të përzgjedhura për të menaxhuar asetet e tyre rrugore.*

Për pjesën e parë të projektit e cila i referohet Marrëveshjes së parë datë 23.07.2018, në fazën fillestare është finalizuar një listë financimi, për të cilat me dakordësinë e Bankës Botërore dhe fondet e buxhetit të shtetit, u krye procesi i prokurimit dhe kontraktimit të projektit.

Variantet finale të projekt zbatimit për segmentet rrugore ishin Qafë Thore-Theth, Pogradec-Tushemisht, Fier-Seman, Bënçë-Lekdush dhe Gusmar-Kuç.

Procesi i prioritizimit dhe vlerësimit të varianteve të projekteve është koordinuar dhe menaxhuar nga FSHZH duke u mbështetur në objektivat e programit dhe me kriteret e vendosura nga qeveria dhe BNRZH dhe BERZH.

61 Bashkive i është dërguar një shkresë zyrtare nëpërmjet të cilës janë informuar mbi programin dhe ju është kërkuar të përgatisin një listë me rrugë rurale potenciale për ndërtim/rehabilitim që plotësojnë kriteret për tu financuar nga ky program. Korniza ligjore mbi bazën e të cilës përzgjedhja dhe prioritizimi i projekteve të investimeve që kërkohet të plotësohet nga bashkitë është sipas:

- *Planit Kombëtar të Territorit ,*
- *Strategjisë Kombëtare për Turizmin,*
- *Planeve të Përgjithshme Lokale,*
- *Planeve Strategjike,*
- *Planeve Operacionale*

Më të dhënat e mbledhura, FSHZH ka krijuar data-bazën me listën e prioriteteve të dërguara nga Bashkitë. Kjo fazë ka pasur afat datën 30 Maj të 2017 dhe mbyllet me raportin e parë i cili i është dërguar BB duke e informuar mbi rezultatet e kësaj faze.

Faza e dytë lidhet me procesin e vlerësimit dhe prioritizimit të projekteve bazuar në kriteret e mëposhtme përcaktuar në metodologjinë;

-Rëndësia e Turizmit (30%)

-Potenciali Agro-kulturor (20 %)

-Analiza Kosto-Benefit (25%)

-Popullsia përfutuese (25%)

Raporti i dytë dhe final për procesin e prioritizimit do të dorëzohej me 30 Qershor 2017.

Konstatim: Nga e gjithë procedura për procesin e përzgjedhjes së rrugëve grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion vetëm data-baza me të gjithë projektet e propozuara nga bashkitë dhe vlerësimi i tyre sipas kriterëve por jo raportet mbyllëse të fazës së parë dhe të dytë që duhet ti dërgohen Bankës dhe as ndonjë aprovim i saj apo i Këshillit Drejtues mbi rrugët e përzgjedhura.

Pjesa e parë e projekti në vetvete është e ndarë në tre komponentë si më poshtë:

Komponenti 1. Përmirësimi i aksesueshmërisë.

Nën komponenti 1.1 Rehabilitimi për t'i rezistuar ndikimeve klimatike.(Kosto Totale 45.68 milion \$)

Ky nën komponent ka të bëjë me mbështetjen për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale në Bashkitë e përzgjedhura, duke përfshirë trotuare për këmbësorët, korsi për biçikleta, përmirësimet e sigurisë, sinjalistikën e orientimit dhe aspekte estetike, kur rrugët u shërbejnë zonave turistike ose kalojnë nëpër zona urbane. Gjithashtu ky komponent do të ofrojë mbështetje për zhvillimin e projekteve rrugore dhe mbikëqyrjen e punimeve inxhinierike, duke përfshirë edhe kryerjen e auditimeve teknike dhe të sigurisë rrugore.

Mbi shkallën e realizimit të nën komponentit 1.1

Shkalla e realizimit të këtij nën komponenti lidhet me nivelin e progresit të kontratave të lidhura për kryerjen e punimeve në segmentet rrugorë të sipërpërmendur.

Rehabilitimi i rrugës Pogradec – Tushemisht.

Procedura e prokurimit për këtë segment ka përfunduar me njoftimin e kontratës më 09.05 2019. Kontrata me kontraktorin e punimeve civile J. "A....." shpk & "Gard. L." shpk është firmosur më 27.05.2019. Vlera e kontratës Rehabilitimi i rrugës Pogradec-Tushemisht RFB Nr. RLRCP/1/1.2/2018, është 377,388,382 Leke, me TVSH. Leja e Infrastrukturës Nr. 5134 Prot. është lëshuar në 10.07.2019. Punimet kanë filluar me 7.10.2019 dhe afati i përfundimit është përcaktuar 8 muaj. Data e përfundimit referuar kontratës ishte 10.06.2020 por FSHZH ka pranuar kërkesën për shtyrjen e afatit të përfundimit në 5.08.2020 pa kosto shtesë bazuar në situatën me shpronësimet për të cilën Institucionet përkatëse Shqiptare janë në proces.

Deri në Dhjetor të 2020, afati i periudhës së auditimit, projekti është ende në implementim. Inxhinieri ka njoftuar Klientin për Përfundimin e punimeve me 05.08.2020, por procesi i

shpronësimeve nuk ka përfunduar akoma dhe kjo ka bërë që deri në Dhjetor të 2020 punimet për trotualet të mos kishin filluar ende. Në këtë mënyrë marrja në dorëzim e punimeve ka qenë e pjesshme. Inxhinieri ka parashikuar një afat 2 javë - 1 muaj për përfundimin e punimeve për trotualet pas përfundimit të procesit të shpronësimeve.

Rehabilitimi i rrugës Qafë Thore – Theth

Procedura e prokurimit ka përfunduar me njoftimin e kontratës më 07.06.2019. Kontrata me kontraktorin e punëve civile J. "G....." shpk & "Gj...." shpk është nënshkruar më 08.07.2019. Vlera e Kontratës për "" Rindërtimin të rrugës "Qafë Thore- Theth", Shkodër ", Nr. RFB: RLRC/1/1.1/2018, është 736,302,708 lekë (me TVSH). Leja e Ndërtimit për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni Nr. 11 është lëshuar në 22.08.2019 nga Bashkia Malësi e Madhe dhe Leje Infrastruktura Nr. 382 datë 28.08.2019 lëshuar nga Bashkia Shkodër. Punimet kanë filluar më 04.09.2019 dhe afati i përfundimit ka qenë 10 muaj. Punimet në terren u pezulluan nga Inxhinieri në 16.12. 2019 pasi kushtet atmosferike u përkeqësuan dhe rifilluan më 06.05 2020. Referuar letrës përkatëse nga Inxhinieri, theksohet se ky pezullim i punimeve është pa kosto shtesë për Klientin. Projekti është ende në zbatim, deri në fund të muajit Dhjetor 2020 kanë përfunduar pothuajse të gjitha tombinot, dy tunele panoramike, muret mbajtëse, shtresa e nën bazës etj. Inxhinieri ka ndërprerë punimet për asfaltin në nëntor për të rifilluar përsëri në pranverë pasi kushtet e motit nuk kanë qenë të favorshme.

Rehabilitimi i rrugës Fier – Seman

Procedura e prokurimit për këtë segment është anuluar për arsye se Qeveria Shqiptare ka prioritarizuar projekte të tjera infrastrukturore. Në vendimin e Këshillit Drejtues nr. 203 datë 06.04.2020 mbi përdorimin e fondeve të paangazhuara të projektit të konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale, në funksion të realizimit të objekteve prioritare për zhvillimin turistik dhe bujqësor, vendoset që fondet e paangazhuara të kursyera nga anulimi i projektit për rehabilitimin e rrugës Fier-Seman të kalojnë për financimin e projektet Përmirësimi i rrugës Fier-Berat (Segmenti i mbetur Roskovec-Ura e Poshnjës) dhe Përmirësimi i rrjetit rrugor dhe infrastrukturës urbane në zonën turistike Golem-Kavajë.

Rehabilitimi i rrugës Bëç- Lekdush

Procedura e prokurimit ka përfunduar me njoftimin e kontratës më 13.12.2019. Kontrata me kontraktorin e punëve civile "C.. AS" u nënshkrua në 30.12.2019. Vlera e Kontratës për "Rindërtimin e rrugës Lekdush-Bëç-Tepelene, Lot 2", RFB Nr. RLRC/1/1.10/2019, është 2,474,793 US \$ me TVSH. Punimet kanë filluar në 30.04.2020, ndërsa koha për përfundimin është 12 muaj, data e përfundimit është 29.04.2021. Leja e Ndërtimit në infrastrukture nr. BT-LI130220 është lëshuar në 05.03.2020 nga bashkia Tepelenë. Deri më tani, nën-projekti është në zbatim, me një rënie të progresit fizik prej 29.30 % në fund të muajit Dhjetor 2020.

Rehabilitimi i rrugës Kuç - Gusmar

Procedura e prokurimit ka përfunduar me njoftimin e kontratës më 14.11.2019. Kontrata me kontraktorin e punëve civile "R..... Est" u nënshkrua në 3.12.2019. Vlera e Kontratës për rrugën "Gusmar- Kuç", RFB Jo: RLRC/1/1.4/2019, është 5,780,441 US \$ me TVSH. Punimet kanë filluar në 30.04.2020, ndërsa koha për përfundimin është 12 muaj, Data e Përfundimit është 29.04.2021. Leja e Ndërtimit është lëshuar nga KKT me kusht në 28.02.2020. Deri në fund të muajit Dhjetor 2020, nën-projekti është në zbatim, me një rënie të progresit fizik prej 15.38 %.

Shërbime mbikëqyrje e punimeve civile të rrugëve të projektit (afërsisht 45 km)

Procedura e prokurimit ka përfunduar me njoftimin e kontratës në 07.04 2020. Kontrata me konsulentin "E.SER. DE IN." SL është firmosur më 17.04.2020. Vlera e kontratës Ref No: RLRC/1/1.6/2018, është 816,024\$, me TVSH. Afati i kontratës është 22 muaj dhe 24 muaj periudha e njoftimit të defekteve.

Shërbime mbikëqyrje për rrugën "Pogradec-Tushemisht"

Procedura e prokurimit ka përfunduar me njoftimin e kontratës në 20.05.2019. Kontrata me konsulentin "T..." shpk është firmosur më 27.05.2019. Në mënyrë që të mbulohej mbikëqyrja e

punimeve për Rindërtimin e Rrugës Qafë Thore - Theth kontrata në fjalë u amendua për herë të parë më 7.08.2019. Gjithashtu, në mënyrë që të mbulohej me mbikëqyrje e gjithë periudha e punimeve për Rindërtimin e rrugës Qafë Thore-Theth kontrata në fjalë u amendua për herë të dytë me 02.04.2020. Vlera e Kontratës Kryesore, Ref.No: RLRCP/1/1.5/2018, është 21,360,000 Lekë me TVSH. Afati kohor 8 muaj dhe 18 muaj të tjerë të periudhës së njoftimit të defekteve. Vlera e Amendamentit nr. 1 është 1,788,000 lekë, përfshirë TVSH-në. Vlera e Amendamentit nr. 2 është 16,440,000 lekë, përfshirë TVSH-në.

Nën komponenti 1.2. Nismat për sigurinë rrugore (Kosto totale 1.2 milion \$)

Ky nën-komponent ka të bëjë me mbështetje për identifikimin e ndërhyrjeve të mundshme në sigurinë rrugore, në rrugë të ndryshme nga ato të përmendura në pjesën më sipër dhe zbatimi i ndërhyrjeve të tilla, realizimi i hartës së rrezikut rrugor dhe inspektimi i sigurisë rrugore në seksionet rrugore të lidhura me rrugët e përcaktuara për të trajtuar pikat më problematike për aksidentet.

Mbi shkallën e realizimit të nën-komponentit 1.2

Procedura e prokurimit ka përfunduar me njoftimin e kontratës më 02.10.2019. Kontrata me konsulentin JV “Fr. Eng.” & “I...” shpk nënshkruhet më 29.10.2019. Vlera e kontratës për ekzekutimin e "Shërbimeve të Konsulencës për identifikim dhe mbikëqyrje të ndërhyrjeve të mundshme dhe inspektimeve të sigurisë rrugore ", Ref No: RLHCP / 1/1 .912018, është prej 187,680 \$, me TVSH. Afati ka qenë 10 muaj.

Qëllimi i punimeve është ndryshuar. Qëllimit të punimeve iu shtuan dy rrugë të tjera: ‘Roskovec - Poshnjë’ që do të financohen nga IBRD dhe “Zona Turistike Golem-Kavaje” të cilat do të jenë subjekt i financimit nga EBRD brenda të njëjtit program (RLRCP). Kjo kontratë ka përfunduar sipas përcaktimeve.

Komponenti 2. Ngritja e kapaciteteve për bashkitë.

Nën komponenti 2.1. Ngritja e kapaciteteve bashkiake për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore (Kosto Totale 0.5 milion\$)

Ky nën-komponent ka të bëjë me mbështetjen e bashkive të përzgjedhura për të zhvilluar sisteme bashkiake për mirëmbajtjen e rrugëve dhe planifikimin e rrugëve, duke përfshirë:

- i. ofrimin e këshillimit për të përmirësuar sistemet ekzistuese të menaxhimit të aseteve për të përmirësuar planifikimin dhe priorizimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe të rehabilitimit;
- ii. zhvillimin e një marrëveshjeje për nivelin standard të shërbimit për të përmirësuar efikasitetin e ekzekutimit të mirëmbajtjes;
- iii. ofrimin e këshillimit për të zhvilluar një kuadër për financimin e qëndrueshëm të mirëmbajtjes;
- iv. kryerjen e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për bashkitë e përzgjedhura për të zbatuar në mënyrë efektive programet e mirëmbajtjes së rrugëve.

Mbi shkallën e realizimit të nën-komponentit 2.1

Në lidhje me këtë nën-komponent nuk është kryer ende asnjë aktivitet.

Nën komponenti 2.2 Ndërtimi i ekonomive të reja (Kosto Totale 0.5 milion \$)

Mbështetja e bashkive të përzgjedhura për zbatimin e programeve të zhvillimit rural, duke përfshirë “Programin e 100 Fshatrave” dhe programe të ngjashme, nëpërmjet ofrimit të këshillimit për:

- i. vlerësimin e potencialit të tregut në nivel fshati për të përcaktuar se cilat aktivitete prodhuese sigurojnë fitimin më të lartë;
- ii. përgatitjen e propozimeve për investime për të përdorur fondet e grantit të disponueshme për të trajtuar kërkesat e tregut; dhe
- iii. zbatimin e aktiviteteve të përmendura në pikën “i” dhe “ii”.

Mbi shkallën e realizimit të nën-komponentit 2.1

Në lidhje me këtë nën-komponent nuk është kryer ende asnjë aktivitet.

Komponenti 3. Mbështetja për menaxhimin e zbatimit

Mbështetja e Njësisë së Zbatimit të Projektit për të realizuar zbatimin e Projektit, duke përfshirë nëpërmjet ofrimit të Kostove Operacionale shtesë dhe Trajnimit, zhvillimit dhe mirëmbajtjes së Sistemit

Informativ Gjeografik (GIS), përdorimit të bazës së të dhënave për përcaktimin e përparësisë së rrugëve rajonale dhe lokale.

Mbi shkallën e realizimit të komponentit 3

Në lidhje me këtë komponent nuk është kryer ende asnjë aktivitet.

Indikatorët kryesore të Nivelit të Realizimit të Objektive të Projektit (PDO) janë përcaktuar si më poshtë:

Indikatori 1- Numri i qendrave bujqësore dhe turistike të lidhura nga përmirësimet e rrugëve nga projekti

Indikatori 2- Koha e reduktuar e udhëtimit në rrugët e projektit

Indikatori 3- Kapacitete bashkiake të përmirësuara për menaxhimin e aseteve rrugore të paraqitura nëpërmjet adoptimit të një Plani Bashkiak për rehabilitim dhe mirëmbajtje rrugore.

Në fillim të projektit janë përcaktuar dhe 14 indikatorë të ndërmjetëm për nivelin e realizimit të objektivave të cilët listohen më poshtë të cilët plotësojnë indikatorët kryesore të sipërpërmendur.

Indikatori i Ndërmjetëm 1-Rrugë të rehabilituara

Indikatori i Ndërmjetëm 2-Rrugë të rehabilituara rurale

Indikatori i Ndërmjetëm 3-Përmirësimi i mjeteve gjeo-hapsinore për të treguar kushtet e rrugës dhe aksesin në qendrat bujqësore dhe turistike.

Indikatori i Ndërmjetëm 4-Audite të kaluara në fazën e projektimit të sigurisë rrugore

Indikatori i Ndërmjetëm 5-Auditime teknike të kaluara në fazën e projektimit përfshirë aspektet e rezistencës klimatike

Indikatori i Ndërmjetëm 6-Përgatitja e kontratës të marrëveshjes së nivelit standard të shërbimit dhe ofrimi i trajnimit.

Indikatori i Ndërmjetëm 7-Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të aseteve të bashkive nëpërmjet përfshirjes së data-bazës së priorizimit

Indikatori i Ndërmjetëm 8-Trajnime për ngritjen e kapaciteteve të bashkive për mënyrën si të rekrutojnë dhe mbajnë femra në sektorin e rrugëve.

Indikatori i Ndërmjetëm 9-Politika dhe praktika në lidhje me punësimet dhe mbajtjen e femrave në ndërtimin e rrugëve.

Indikatori i Ndërmjetëm 10-Përqindja e femrave të punësuara në punë me aftësi të larta në forcën punëtore të kontraktorëve dhe departamenteve të rrugëve të bashkive pjesëmarrëse në projekt.

Indikatori i Ndërmjetëm 11-Zhvillimi i rekomandimeve për lidhjen e prodhuesve bujqësor me kërkesën lokale.

Indikatori i Ndërmjetëm 12-Zhvillimi i një plani konceptual për zhvillimin e turizmit

Indikatori i Ndërmjetëm 13-Përqindja e konsultimeve me komunitetin në zonat e përcaktuara që influencojnë vendim-marrjen mbi projektimin e rehabilitimit të rrugëve

Indikatori i Ndërmjetëm 14-Ankesat që janë adresuar në lidhje me projektin brenda kushteve të kërkuara, të ndara sipas gjinisë.

Konstatim

Referuar të dhënave ku jepen në mënyre të përmbledhur nivelet e parashikuar sipas viteve të nivelit të realizimit të objektivave të projektit dhe nivelet konkrete aktuale të arritura për çdo vit deri në përfundimin e periudhës objekt auditimi Dhjetor 2020, rezulton se objektivat që lidhen me progresin fizik të projektit kanë një përqindje realizimi por objektivat nuk janë arritur sipas përcaktimeve, ndërsa objektivat që lidhen me indikatorët e ndërmjetëm mbeten larg realizimeve. Mosrealizimi i ketyre indikatorëve tregohet në tablen mëposhtë:

Tabela 1 Niveli i realizimit te objektivave kryesore dhe të ndërmjetme të projektit

Indikatorët e Nivelit të Rezultateve	Njësia		Baza 2018	Vlerat Kumulative te Objektivave						
				V 1	V 2	V 3	Aktual	V4	V5	Objektivi
				Pr-18	Pr-19	Pr-20	Dhj-20	Pr-21	Dhj-22	Dhj-22
1.Numri i qendrave bujqësore e turistike te lidhura nga përmirësimet rrugore te projektit	Numër	Objektivi	0	0	3	9	9	9	9	9
		Realizimi		0	4	4	4			
2.Koha e reduktuar e udhëtimit ne rrugët e projektit	Përqindje	Objektivi	0	0	0	0	0	0	35	35
		Realizimi		0	0	0	0			
3.Kapacitete bashkiake te përmirësuara për menaxhimin e aseteve rrugore.	Po/jo	Objektivi	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Po
		Realizimi		Jo	Jo	Jo	Jo			
Indikatorët e Rezultateve te ndërmjetme	Njësia		Baza	Vlerat Kumulative te Objektivave						
				V 1	V 2	V 3	Aktual	V4	V5	Objektivi
				Pr-18	Pr-19	Pr-20	Dhj-20	Pr-21	Dhj-22	Dhj-22
1. Rruge te rehabilituara	Kilometër	Objektivi	0	0	42	55	55	55	55	55
		Realizimi			3.40	3.40	3.40			
2. Rruge te rehabilituara rurale	Kilometër	Objektivi	0	0	42	55	55	55	55	55
		Realizimi			3.40	3.40	3.40			
3 Përmirësimi i mjeteve gjeo-hapsinore per te treguar kushtet e rrugës dhe aksesin ne qendrat bujqësore dhe turistike	Po/Jo	Objektivi	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Po
		Realizimi		Jo	Jo	Jo	Jo			
4 Audite te kaluara ne fazën e projektimit te sigurisë rrugore	Përqindje	Objektivi	0	0	100	100	100	100	100	100
		Realizimi		0	100	100	100			
5 Auditime teknike te kaluara ne fazën e projektimit përfshire aspektet e rezistencës klimatike	Përqindje	Objektivi	0	0	100	100	100	100	100	100
		Realizimi		0	100	100	100			
6 Përgatitja e kontratës se marrëveshjes se nivelit standard të shërbimit dhe ofruari i trajnimit	Po/Jo	Objektivi	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Po	Po	Po
		Realizimi		Jo	Jo	Jo	Jo			
7 Përmirësimi i sistemit te menaxhimit te aseteve te bashkive nëpërmjet përfshirjes se data bazës se prioritizimit	Po/Jo	Objektivi	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Po	Po	Po
		Realizimi		Jo	Jo	Jo	Jo			

8 Trajnime per ngritjen e kapaciteteve te bashkive per menyren si te rekrutojne dhe mbajne fermra ne sektorin e rrugeve	Numër	Objektivi	0	0	1	1	1	2	2	2
		Realizimi		0	0	0	0			
9 Politika dhe praktika ne lidhje me punesimet dhe mbajtjen e femrave ne ndertimin e rrugeve.	Po/Jo	Objektivi	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Po
		Realizimi		Jo	Jo	Jo	Jo			
10 Përqindja e femrave te punesuara ne pune me aftesi te larta ne forcen punetore te kontraktoreve dhe departamenteve te rrugeve te bashkive pjesemarrrese ne projekt.	Përqindje	Objektivi	5	5	5	8	8	10	15	15
		Realizimi		5	6.5	6.5	6.5			
11 Zhvillimi i rekomandimeve per lidhjen e prodhuesve bujqesor me kerkesen lokale	Numer	Objektivi	0	0	0	1	1	2	2	2
		Realizimi		0	0	0	0			
12 Zhvillimi i planeve konceptual per zhvillimin e turizmit	Numer	Objektivi	0	0	0	1	1	2	2	2
		Realizimi		0	0	0	0			
13 Përqindja e konsultimeve me komunitetin ne zonat e percaktuara qe influencojne venimmarrjen mbi projektimin e rehabilitimit te rrugëve	Përqindje	Objektivi	0	0	50	50	50	50	50	50
		Realizimi		-	-	-	-			
14 Ankesat qe janë adresuar në lidhje me projektin brenda kushteve të kërkuara, të ndara sipas gjinisë	Përqindje	Objektivi	0	100	100	100	100	100	100	100
		Realizimi		100	100	100	100			

Burimi i të dhënave FSHZ

Pjesa e dytë e projektit i referohet Marrëveshjes së Huas datë 10 Shkurt 2020. Qëllimi i këtij projekti është të ndihmojë huamarrësin për rehabilitimin dhe përmirësimin e tre segmenteve rrugore në rrjetin e vet duke synuar të përmirësojë lidhjen midis rajoneve të Shqipërisë dhe të japë kontribut për zhvillimin ekonomik dhe qasjen në shërbimet shoqërore. Ky projekt synon të përmirësojë infrastrukturën rrugore dhe shërbimeve përgjatë zonave bregdetare në Shëngjin Velipojë, Vlorë dhe në zonën lindore Librazhd-Bulqizë, që të forcojë zhvillimin e turizmit dhe të lehtësojë me tej qarkullimin e mallrave dhe turistëve. Projekti në fjalë përbëhet nga 4 pjesë:

Pjesa A e cila financohet nga Transhi 1-Rehabilitimi dhe zgjerimi i segmentit rrugor me gjatësi 10.6 km duke përfshirë dy devijime të vogla midis qytetit të Vlorës dhe Orikumit përgjatë bregdetit jugor të Shqipërisë.

Pjesa B e cila financohet nga Transhi 1-Rehabilitimi i segmenti rrugor me gjatësi rreth 13 km midis Shëngjinit dhe Baks-Rrjoll (Velipojë) në bregdetin verior të Shqipërisë.

Pjesa C e cila financohet nga Transhi 1-Mbikëqyrja e punimeve për pjesën A dhe pjesën B

Pjesa D e cila financohet nga Transhi 2-Përmirësimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor Zgosht-Ura e Çerenecit me gjatësi rreth 47.1 km dhe mbikëqyrja e punimeve përkatëse.

Referuar planit të Prokurimeve të përditësuar më 7 Shkurt 2020 dhe të aprovuar nga Banka, Kontratat e punimeve për të tre segmentet duhet të ishin lidhur respektivisht Rehabilitimi i rrugës Vlorë Orikum në Korrik 2020, rehabilitimi i rrugës midis Shëngjinit dhe Baks-Rrjoll në Korrik 2020 dhe përmirësimi i segmentit rrugor Zgosht-Ura e Çerenecit në Tetor 2020. Deri në Dhjetor të 2020 janë kryer procedurat e prokurimit dhe janë lidhur kontratat për Rehabilitimin dhe zgjerimin e segmentit rrugor me gjatësi 10.6 km duke përfshirë dy devijime të vogla midis qytetit të Vlorës dhe Orikumit përgjatë bregdetit jugor të Shqipërisë dhe Rehabilitimin e segmentit rrugor me gjatësi rreth 13 km midis Shëngjinit dhe Baks-Rrjoll (Velipojë) në bregdetin verior të Shqipërisë, si dhe mbikëqyrja e punimeve përkatëse.

Observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit të kryer në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin Konektiviteti i rrugëve Rajonale dhe Lokale Nr.675/15 datë 08.09.2021 dhe administruar në KLSH nr. 254/5 datë 09.09.2021, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit mbi realizimin e objektivave

Sqarojmë se objektivi kryesor i Programit është realizimi i infrastrukturës rrugore për objektet e miratuara. Për Bankën Botërore objektivi është realizimi i 45 km rrugë të asfaltuara dhe për EBRD është realizimi i 3 objekteve të miratuara. Ne fazën që flasim jemi në vitin e tretë të programit për Bankën Botërore dhe të dytin për EBRD dhe deri tani janë në përfundim 45 km rrugë si dhe pritet prokurimi për dy objektet të tjera të cilat e çojnë numrin e km në mbi 60 km (Rrugët paralele Golem për të cilën priten ofertat ekonomike). Për EBRD 2 objektet janë në ndërtim dhe një në prokurim dhe në saj të uljes së ofertave do të realizohen më shumë rrugë se objektivi. Pra, nga të dy financuesit, në momentin kur jemi në mesin e zbatimit janë tejkaluar objektivat e Programit. Konsulencat që lidhen me supervizionin dhe përgatitjen e projekteve janë po ashtu në zbatim ose të realizuara. (komponenti 2 i BB apo supervizioni i EBRD).

Lidhur me komentin tuaj për realizimin, komponenti i cili nuk është prokuruar akoma është ngritja e kapaciteteve për Bashkitë. Kjo si pasojë e pandemisë shkaktuar nga COVID-19 dhe kufizimeve të organizimeve dhe lëvizje të ushtruara në shumë shtete. Për më tepër BB nuk ka miratuar ende termat e referencës për këto komponent. Departamenti i Menaxhimit së bashku me atë të Zhvillimit janë në komunikim për miratimin e këtyre termave. Theksojmë se ky komponent nuk ka afat të zhvillimit të tij dhe duke qenë se asistencë e bashkive do të kryhet për pak muaj, mendojmë se jemi në kohë për zbatimin e tij dhe dorëzimi i një produkti sa më të përdorshëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në trajtimin e pikës mbi shkallën e realizimit grupi i auditimit ka përshkruar me detaje nivelin e realizimit për secilin komponent si për ato të caktuara në marrëveshjen me BB ashtu dhe ato të përcaktuara në marrëveshjen me EBRD. Projekti ka një realizueshmëri të mirë të disa komponentëve dhe një realizueshmëri të ulët për disa komponentë të tjerë për një sërë arsyesh të shpjeguara nga grupi i auditimit po ashtu dhe nga ju. Projekti është ende në implementim dhe ka mundësinë për arritjen e objektivave me marrjen e masave të duhura siç përcaktohen në rekomandim.

Për sa më sipër sqarimi juaj merret në konsideratë por gjetja nga grupi i auditimit qëndron.

2.1.1 Titulli i gjetjes: Mbi shkallën e arritjes së objektivave.

Situata: Referuar niveleve të parashikuara sipas viteve të nivelit të realizimit të objektivave të projektit dhe nivelet konkrete aktuale të arritura për çdo vit deri në përfundimin e periudhës objekt auditimi Dhjetor 2020 rezultoi se objektivat që lidhen me komponentin e parë të projektit që është përmirësimi i aksesueshmërisë dhe me indikatorët e progresit fizik të projektit si, kilometra rrugë të rehabilituara, numrin e qendrave të banuara të lidhura nëpërmjet rrugëve të rehabilituara apo koha e reduktuar e udhëtimit në rrugët e projektit, pavarësisht se kanë një përqindje realizimi ato nuk janë arritur sipas përcaktimeve fillestare. Objektivat që lidhen me komponentin e dytë dhe të tretë të projektit pra indikatorët e ndërmjetëm që kanë të bëjnë me kapacitete bashkiake të përmirësuara për menaxhimin e aseteve rrugore, apo mbështetje për menaxhimin e zbatimit me trajnime, pëmirsim dhe politika, nuk janë realizuar.

Kriteri: Ligji nr. 54/2018, datë 23.07.2018, "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim" Skeduli 1 dhe Skeduli 2. Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim" Skeduli 1 dhe Skeduli 3. Manuali Operacional i Projektit Pika A.1, 2.

Ndikimi/Efekti: Nga analiza e përqindjes së kohës së kaluar në raport me përqindjen e punimeve të kryera, realizimi në kohë i punimeve të mbetura për atë kohë sa trendi i progresit mbetet i njëjtë është i vështirë. Kjo situatë mund të sjellë vonesa të mundshme të përfundimit të projektit.

Shkaku: Vonesa në shpronësime, vonesa për shkak të kushteve të vështira klimaterike, vonesa të shkaktuara nga progres i dobët i punimeve.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të projektit, të marrë masa që kontraktori të rrisë kapacitetet në mënyrë që të arrijë përfundimi në kohë i projektit. Gjithashtu të koordinojë punën për realizimin e indikatorëve të ndërmjetëm.

2.3 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimin e fondeve publike.

Për periudhën objekt auditimi janë realizuar në total 10 procedura prokurimi ku të gjitha këto praktika të zhvilluara janë audituar. Nga këto procedura 6 janë për realizimin e punimeve civile, 3 për mbikëqyrje/konsulencë dhe 1 për shërbime konsulence. Për praktikën e audituar u shqyrtuan dosjet e prokurimit, dokumentacioni i subjekteve të shpallura fituese, korrespondenca midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit me Bankën Botërore për secilën procedurë deri në lidhjen e kontratës. Nga financimi i Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BB) janë realizuar 7 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit US \$ 28,749,500 me TVSH dhe vlerë totale të ofertave fituese US \$ 20,694,349, nga këto 1,153,239,090 lekë me TVSH dhe US \$ 9,258,938 me TVSH. Nga financimi i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) janë realizuar 3 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit US \$ 44,361,756 me TVSH dhe vlerë totale të ofertave fituese US \$ 24,661,432 me TVSH. Nga auditimi i procedurave rezultoi si më poshtë:

2.3.1 Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt **“Rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll ” (13km)** u dokumentacioni si më poshtë:

- Dosja e prokurimit me objekt “Rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll ” (13km);
- Dokumentacioni i subjektit fitues;
- Korrespondenca zyrtare me Bankën Botërore;

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e konkurrimit për kontratën “Rehabilitimit të rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll” ka qenë tender i hapur me para kualifikim.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 2 datë 05.02.2020 per krijimin e komisionit të fondit limit, specifikime. Nr. 2/1 datë 25.02.2020 për prokurimin	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit A.N. Xh.H. B.H.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Sipas Urdhrit, 2/1 datë 25.02.2020 1. E.O. (Kryetar) 2. D.M. A. (Anëtar) 3. E. K. (Anëtar)
2. Procedura e Prokurimit Procedure e hapur me parakualifikim sipas rregullores se Prokurimit te Bankës Europiane er Rindertim dhe Zhvillim, 1.11. 2017		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 24,270,681 \$	6.Oferta fituese (pa tvsh) 12,500,854.81\$	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 11,769,826.2 \$
8. Data e hapjes së tenderit: 03.04.2020 Afati për dorezimin e aplikimit për Parakualifikim 20.08.2020 shtyrë me 08.10. 2020 Afati për dorezimin e tenderit	9.Burimi Financimit Banka Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim EBRD	10.Operatorët Ekonomikë a) Aplikime ne fazën e Parakualifikimit 21 Operatorë b) Te parakualifikuar 10 Operatore c) Pjesëmarrës ne fazën e dyte 8 Operatore d) Kualifikuar 7 Operatore e) Skualifikuar 1 Operator
b. Zbatimi i Kontratës		
11.Lidhja e kontratës G..... shpk, Nr.3043 date 03.12.2020	12.Vlera e kontratës (me tvsh) 15,001,024.60 \$	13.Likuiduar deri datë 31.12.2020 - 0 lekë

Faza e parakualifikimit në tender pasohet nga procedura e tenderi të hapur me një fazë, bazuar në kontratat me lloje punimesh. Ftesa për tender është publikuar në website-in e Bankës më 18 Gusht 2020. Afati për dorëzimin e aplikimeve të parakualifikuara ishte 10 Tetor 2020. Pas njoftimit për Ftesë pjesëmarrjeje në tender 10 operatorëve të parakualifikuar, nga të cilat, nëpërmjet sistemit on-line të Bankës u paraqiten vetëm 8 aplikime.

Ofertuesit e mëposhtëm i përgjigjen të gjitha kërkesave dhe janë kualifikuar:

Nr.	OE/BOE	Shteti	Vlera e Ofertes pa TVSH me zbritje
1	G. sh.p.k	Shqiperi	12,500,854.81 \$
2	Co.gr. Con.Com. K.s.C	Kuvait	14,983,259.43 \$
3	Ra. Al-To. Con. Est.	Arabi Sudite	15,145,106.16 \$
4	Gr. L. Ge.Tr.and Con.	Kuvait	16,689,985.83 \$
5	JV S. ltd and A. STAR ltd	Shqipëri	18,330,665.95 \$
6	JV I.2000 EO. and A.....k ltd	Bullgari Shqipëri	21,356,279.65 \$

7	S. Cor.Limited	Kine	23,098,768.00 \$
---	----------------	------	------------------

Ofertuesi i tetë, “L.Y. T. O.J. S. C.” Azerbaxhan nuk ka dorëzuar kërkesën për sigurimin e ofertës sipas formularit ITP17 nëpërmjet sistemit on-line as në format hard copy siç specifikohet në dokumentat standard të tenderit, instruksione për pjesëmarrësit ITP 17 dhe rrjedhimisht nuk është vlerësuar. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka rekomanduar lidhjen e kontratës me ofertuesin me të leverdishëm ekonomik “G.. ltd” me çmim të vlerësuar pa TVSH 12,500,854.81 duke përfshirë 36.98 % zbritje. Kontrata “Rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km)” Nr. 3043 datë 03.12.2020 është lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Operatorit G... shpk me një afat 12 muaj. Oferta e dhënë nga OE “G... ltd” është **12,500,854.81 \$** pa tvsh me një diferencë 11,769,826.2 \$ me fondin limit (pa tvsh) ose 48.4% me e ulët.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion dhe analizimi i propozimeve financiare në gjykimin e grupi të auditimit oferta e OE “G.... ltd” është anomalisht e ulët në krahasim me koston e planifikuar dhe me ofertat e ofertuesve të kualifikuar. Referuar dokumenteve standard të tenderit, seksioni III Metodologjia e Vlerësimit, paragrafi 9 Ofertë Anomalisht e Ulët ose jo e balancuar specifikohet:

Nëse sipas opinionit të Klientit, Oferta që rezulton më e favorshme ekonomikisht, është seriozisht e pa balancuar e ose anomalisht e ulët, Klienti mund ti kërkojë pjesëmarrësit të dorëzojë analizë të detajuar të çmimeve për ndonjë ose të gjitha zërat të tabelës së çmimeve, dhe evidencë plotësuese, për të dëshmuar qëndrueshmërinë e atyre çmimeve me informacionin e paraqitur në ofertën e tij.

Pas vlerësimit të analizës së çmimeve, dhe duke mbajtur në konsideratë cash-flow e parashikuar të kontratës, në rastin kur Klienti vazhdon të konsiderojë ofertën të pa balancuar, ai do të sqarojë dyshimet e tij me pjesëmarrësin me shkrim.

Në rastin kur Pjesëmarrësi nuk është në gjendje të justifikojë kapacitetin e tij për të përmbushur kontratën me çmimin e ofruar, oferta do të refuzohet.

Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka bërë një analizë të kësaj oferte për ta vlerësuar dhe nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues apo analizë të detajuar për të mbështetur ofertën e OE, përpara se të merrte vendim për kualifikimin e tij.

2.3.1 Titulli i gjetjes: Ofertë anomalish e Ulët.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për procedurën e prokurimit “Rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll” rezulton se oferta e dhënë nga OE fitues “G... ltd” me vlerë **15,001,025.77 US\$** me tvsh është 14,123,79 US\$ me tvsh, më e ulët se vlera e fondit limit ose 48.4% më e ulët. Në gjykimin e grupit të auditimit oferta vlerësohet si anomalish e ulët në krahasim me koston e planifikuar dhe me ofertat e ofertuesve të kualifikuar si dhe krahasimet e çmimeve të dhëna me manualët e miratuar. Gjithashtu, Rregullat e Prokurimit të BERZH-it nuk parashikojnë një formulë për përcaktimin e vlerës së ofertës anomalisht të ulët dhe nga KVO nuk kemi asnjë sqarim apo dokumentim për mënyrën e gjykitimit dhe të kualifikimit të ofertave në këto raste. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të kësaj procedure nuk ka bërë një analize dhe nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues apo analizë të detajuar për të mbështetur ofertën e OE, përpara se të merrte vendim për kualifikimin e tij duke ju referur metodologjisë së vlerësimit.

Kriteri: Dokumentet Standard të Tenderit, seksioni III Metodologjia e Vlerësimit, paragrafi 9 Ofertë Anomalisht e Ulët ose jo e balancuar. “Nëse sipas opinionit të Klientit, Oferta që rezulton më e favorshme ekonomikisht, është seriozisht e pa balancuar e fryre ose anomalisht e ulët, Klienti mund ti kërkojë pjesëmarrësit të dorëzojë analize të detajuar të çmimeve për ndonjë ose të gjitha

zërat te tabelës se çmimeve, dhe evidence plotësuese, për te dëshmuar qëndrueshmërinë e atyre çmimeve me informacionin e paraqitur ne ofertën e tij. Pas vlerësimit të analizës së çmimeve, dhe duke mbajtur në konsideratë cash-flow e parashikuar të kontratës, në rastin kur Klienti vazhdon të konsiderojë ofertën të pa balancuar, ai do të sqarojë dyshimet e tij me pjesëmarrësin me shkrim. Në rastin kur Pjesëmarrësi nuk është në gjendje të justifikojë kapacitetin e tij për te përmbushur kontratën me çmimin e ofruar, oferta do të refuzohet”.

Ndikimi/Efekti: Risk për përfundimin në kohe dhe në cilësi e projektit.

Shkaku: Mos analizimi i ofertës fituese.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa që të analizojë ofertat e OE, dhe në rastet kur ato janë anomalish të ulta të kërkojë dokumentacion justifikues shtesë dhe analizë të detajuar të çmimeve, përpara se të marrë vendim për kualifikimin.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi

- 1) Z. E. O. në cilësinë e Kryetarit të KVO
- 2) Z. D. M. A. në cilësinë e Anëtarit të KVO
- 3) Z. E. K. në cilësinë e Anëtarit të KVO

2.3.2 Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt **“Rikonstruksion i rrugës Lekdush-Bënçë-Tepelenë, Loti 2”** u dokumentacioni si më poshtë:

- Dosja e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Lekdush-Bënçë-Tepelenë, Loti 2”
- Dokumentacioni i subjektit fituese
- Korrespondenca zyrtare me Bankën Botërore

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e konkurrimit për kontratën e rikonstruksionit të rrugës Lekdush-Bënçë-Tepelenë ka qenë tender i hapur ndërkombëtar duke përdorur Kërkesën për Tenderim (RFB) (Punime të Vogla, Proces Tenderimi me dy Zarfa) për të cilin kanë shprehur interes 14 OE duke paguar tarifën e blerjes se dokumentacionin për procedurën e prokurimit e cila ka pasur një vlerë 200 Euro të parimbursueshme.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i rrugës Lekdush-Bënçë-Tepelenë Ref. RLRC/1/1.10/2018		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 8 datë 14.08.2019 per krijimin e komisionit te fondit limit, specifikime. Nr.8/1 datë 11.09.2019 per prokurimin	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit P. M. E. Z. R.P. - Njësia e Prokurimit Njësia Juridike dhe Prokurimit të FSHZH.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Sipas Urdhrit, 8/1 datë 11.09.2019 1. E.O.(Kryetar) 2. D. M. (Anëtar) 3. D. M. A. (Anëtar)
2. Procedura e Prokurimit Procedure e hapur sipas rregullores se Prokurimit te Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016		
5.Fondi Limit (me tvsh) 4,715,700 \$	6.Oferta fituese (me tvsh) 2,474,793 \$	7. Diferenca me fondin limit (me tvsh) 2,240,907 \$
8. Data e hapjes së tenderit: 30 Tetor 2019 ora 11:00 per zarfin e parë Pjesa Teknike 21 Tetor 2019 ora 11:00 per zarfin e dyte Propozimi Financiar	9.Burimi Financimit Banka Nderkomberate per Rindertim dhe Zhvillim IBRD	10.Operatoret Ekonomike a)Shprehje Interesi dhe blere dokumentat 24 OE b)Pjesëmarrës në tender 14 OE dhe BOE c)S’kualifikuar 5 d) Kualifikuar 9
b. Zbatimi i Kontratës		

11.Lidhja e kontratës C.. O... I.. S.. AS Nr.1969 date 30.12.2019	12.Vlera e kontratës (me tvsh) \$ 2,474,793	13.Likuiduar deri datë 31.12.2020 \$ 926,830.60 me TVSH
---	--	---

Në mënyrë kronologjike hapat e procedurës janë sa vijon:

Nr.	Datat	Aktiviteti i kryer
1	14.08.2019	Urdhër për Hartimi i dokumenteve të tenderit
2	11.09.2019	Urdhër Prokurimi
3	12.09.2019	Aprovimi Bankës
4	12.09.2019	Publikimi në faqen e FSHZH
5	12.09.2019	Publikimi në Gazeta
6	30.10.2019	Cek-lista e Hapjes se tenderit
7	15.11.2019	Raporti i Vlerësimi Teknik
8	18.11.2019	Hapja e zarfit me Propozimin financiar
9	13.12.2019	Njoftimi i kontratës- letter of acceptance
10	15.01.2020	Publikimi i kontratës
11	30.12.2019	Lidhja e kontratës

Subjektet të cilat kanë dorëzuar ofertat sipas afateve, si më poshtë:

NR.	EMRI	Statusi
1.	“A-S” shpk	Kualifikuar
2.	M. . Ve T. AS	S’kualifikuar
3.	B. “G.” shpk & “K. A. & B. C.” shpk	Kualifikuar
4.	GJ.....sha	Kualifikuar
5.	“Eu. H.” shpk	S’kualifikuar
6.	G...	Skualifikuar
7.	R.AL – T. Con. Es	Kualifikuar
8.	C. O. In.S. Ve T. AS	Kualifikuar
9.	S. shpk	Kualifikuar
10.	G..... Company shpk	Kualifikuar
11.	“A.B.” shpk	S’kualifikuar
12.	PVK” shpk	Kualifikuar
13.	B. “A.” & “V” shpk	S’kualifikuar
14.	“S.” srl	S’kualifikuar

- Operatori ekonomik “M. Ve T. AS ” është s’kualifikuar se nuk ka plotësuar:

1). Propozimin teknik i cili nuk është i detajuar dhe jo i plotë.

2) Vlerën e xhirove vjetore të cilat janë vetem me numra por pa dokumentacionin justifikues.

- Operatori ekonomik “E. H.” shpk është s’kualifikuar se nuk ka plotësuar: 1).Letër ofertën me pjesët përbërese të saj.

2). Eksperiencën e punimeve të ngjashme.

- Operatori ekonomik “A.Bu.” shpk është s’kualifikuar se nuk ka plotësuar:

1). Eksperiencën në punime të ngjashme në vlerë kontratash dhe në volum punimesh të kërkuara.

- Bashkimi i operatorëve ekonomik “A.-I.” & “V...” shpk është s’kualifikuar se nuk ka plotësuar:

1). Garancinë e ofertës.

- Operatori ekonomik “SP.” srl është s’kualifikuar se nuk ka plotësuar:

1). Garancinë e ofertës.

Pas hapjes se zarfit të dytë me Propozimin Financiar, vlerat e ofertave te operatorëve te kualifikuar janë si më poshtë:

Nr.	EMRI	Vlera e Ofertës \$ (pa TVSH)	Vlera e Ofertës \$ (me TVSH)
1.	C.O. I. AS	2,062,327	2,474,793
2.	Gj. Kon.sha	2,153,889	2,584,667
3.	G. C. shpk	2,242,478	2,690,974
4.	“A-S” shpk	2,308,823	2,770,587
5.	R. AL – T. Con.Es	2,362,500	2,835,000
6.	S.shpk	2,473,040	2,967,648
7.	G...	2,505,988	3,007,185
8.	PE” shpk	3,470,738	4,164,885
9.	B. “G.” shpk & “K. A. & B. C.” shpk	3,753,587	4,504,304

KVO sipas proces verbalit datë 18.11.2019 ka renditur të parin në listën e fituesve me vlerën më të ulët operatorin ekonomik “C. O. I. S. Ve T. AS” me vlerë të ofertës **2,062,327 \$ pa TVSH** dhe **2,474,793 \$ me TVSH**. Njoftimi i OE fitues “C.O. I. S. Ve T. AS”, nga FSHZH, është bërë me letrën Nr. 1854 Prot. datë 13.12.2019 dhe kontrata për zbatimin e punimeve civile Nr. 1969 Prot. datë 30.12.2019 me vlerë **2,062,327 \$ pa TVSH** dhe **2,474,793 \$ me TVSH**. Afati i përfundimit të punimeve civile 12 muaj nga data e fillimit dhe me periudhë garancie të tyre 18 muaj nga data e Certifikatës së Përfundimit. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit për procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Lekdush-Bençë-Tepelenë, Loti 2”*, konstatohet se diferenca midis fondit limit \$ 4,715,700 me TVSH dhe ofertës fituese \$ 2,474,793 me TVSH është 47.5%. Referuar manualit të prokurimeve të BB për huamarrësit e EFP1 datë 01.07.2016 konkretisht, “Oferta anomalisht e ulët” nuk përcaktohet në mënyrë të detajuar si llogaritet oferta anomalisht e ulët, por në pikën 5.66 dhe 5.77 përcakton se kur Huamarrësi identifikon oferta anomalisht të ulta duhet të kërkojë sqarime me shkrim duke përfshirë analize çmimeve të detajuar etj. Nga krahasimi i çmimeve me manualin e miratuar dhe llogaritjet e kryera rezulton se, oferta e OE fitues në vlerë 2,474,793 US\$ me TVSH është 47.5% më e ulët se fondi limit dhe në gjykimin e grupit të auditimit duhet konsideruar anomalisht e ulët. Për sa më sipër nga ana e KVO nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues ose analiza çmimeve për ofertën e dhënë nga OE “C. O. I. S. Ve T. AS” përpara shpalljes së tij fitues.

2.3.2 Titulli i gjetjes: Ofertë anomalisht e Ulët.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për procedurën e prokurimit *“Rikonstruksion i rrugës Lekdush-Bençë-Tepelenë, Loti 2”* rezulton se oferta e dhënë nga OE fitues “C. O. I. S. Ve T. AS” me vlerë **2,474,793 US\$ me TVSH** është 2,240,907 US\$ më e ulët se vlera e fondit limit ose 47.5% më e ulët. Në gjykimin e grupit të auditimit oferta vlerësohet si anomalisht e ulët në krahasim me koston e planifikuar dhe me ofertat e ofertuesve të kualifikuar si dhe krahasimet e çmimeve të dhëna me manualin e miratuar. Gjithashtu, Rregullat e Prokurimit të BERZH-it nuk parashikojnë një formulë për përcaktimin e vlerës së ofertës anomalisht të ulët dhe nga KVO nuk kemi asnjë sqarim apo dokumentim për mënyrën e gjykimit dhe të kualifikimit të ofertave në këto raste. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të kësaj procedure nuk ka bërë një analizë dhe nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues apo analizë të detajuar për të mbështetur ofertën e OE, përpara se të merrte vendim për kualifikimin e tij duke ju referuar metodologjisë së vlerësimit.

Kriteri: Dokumentet Standard të Tenderit, seksioni III Metodologjia e Vlerësimit, paragrafi 9 Ofertë Anomalisht e Ulët ose jo e balancuar. *“Nëse sipas opinionit të Klientit, Oferta që rezulton me e favorshme ekonomikisht, është seriozisht e pa balancuar e fryrë ose anomalisht e ulët, Klienti mund ti kërkojë pjesëmarrësit të dorëzojë analize të detajuar të çmimeve për ndonjë ose të gjitha*

zërat te tabelës se çmimeve, dhe evidence plotësuese, për te dëshmuar qëndrueshmërinë e atyre çmimeve me informacionin e paraqitur ne ofertën e tij. Pas vlerësimit të analizës së çmimeve, dhe duke mbajtur në konsideratë cash-flow e parashikuar të kontratës, në rastin kur Klienti vazhdon të konsiderojë ofertën të pa balancuar, ai do të sqarojë dyshimet e tij me pjesëmarrësin me shkrim. Në rastin kur Pjesëmarrësi nuk është në gjendje të justifikojë kapacitetin e tij për te përmbushur kontratën me çmimin e ofruar, oferta do të refuzohet”.

Ndikimi/Efekti: Risk për përfundimin në kohe dhe në cilësi e projektit.

Shkak: Mos analizimi i ofertës fituese.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa që të analizojë ofertat e OE, dhe në rastet kur ato janë anomalish të ulta të kërkojë dokumentacion justifikues shtesë dhe analizë të detajuar të çmimeve, përpara se të marrë vendim për kualifikimin.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. E. O. në cilësinë e Kryetarit të KVO
- 2) Z. D.M. në cilësinë e Anëtarit të KVO
- 3) Z. D. M. A. në cilësinë e Anëtarit të KVO

Observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit të kryer në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin Konektiviteti i rrugëve Rajonale dhe Lokale Nr.675/15 datë 08.09.2021 dhe administruar në KLSH nr. 254/5 datë 09.09.2021,ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Lidhur me ofertën anomalisht të ulët, rikujtojmë se procedura është sipas standarteve të bankës dhe nuk ka vend formula sipas LPP. Përpara lidhjes së kontratës, ofertat janë kontrolluar dhe nga stafi i Bankës të cilët kane vlerësuar se nuk ka risk dhe mund të vazhdohet me lidhjen e kontratës duke dhënë NO përkatës.

Për të gjitha ofertat e marra është bërë llogaritja me formulën e miratuar sipas standartit të donatorit dhe në rastet kur oferta ka qënë anomalisht e ulët është kërkuar konfirmim ose shpjegim i ofertës. Për të rastet ku pretendohet se ofertuesit janë anomalisht te ulët është bërë llogaritja e vlerave sipas procedurës së miratuar nga Banka Botërore në Korrik 2016 për oferta të cilat janë potencialisht anormalisht të ulëta. Sipas këtij udhëzimi llogaritja matematikore e ofertave anomalisht të ulëta kryhet në mënyra të ndryshme në varësi të pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi. Në rastet kur kemi më pak se 5 ofertues, anomalisht të ulët do të quhen ata të cilët kanë një devijancë më të madhe se 20% në vlerë krahasuar me vlerën e preventivuar. Në rastet kur kemi më shumë se 5 ofertues (gjë e cila ka ndodhur në të gjitha prokurimet tona) llogaritja e ofertave anomalisht të ulëta kryhet me anë të një formulë me komplekse matematikore e cila ka në përbërje mesataren e ofertave, devijim standart në raport me pjesëmarrësit. Me konkretisht në rastin tonë: Objekti “Rikonstruksioni i rrugës Benç – Lekdush” ka pasur dhjetë oferta me vlera konkretisht:

1) 2,770,587 \$, 2) 4,504,304 \$, 3) 2,584,667 \$, 4) 3,007,185 \$, 5) 2,835,000 \$, 6) 2,474,793 \$, 7) 2,967,648 \$, 8) 2,690,974 \$, 9) 4,164,885 \$.

Vlera e përcaktuar nga formula nën të cilën do të cilësohet si anomalisht i ulët është 2,433,410.49 \$, ndërkohë që vlera me e ulët është 2,474,793 \$.

Objekti “Rikonstruksioni i rrugës Gusmar – Kuç” ka pasur shtatë oferta me vlera si më poshtë:

1) 6,205,341 \$, 2) 7,193,399 \$, 3) 5,766,824 \$, 4) 6,413,137 \$, 5) 6,023,204 \$, 6) 5,813,685 \$, 7) 5,784,038 \$

Vlera e përcaktuar nga formula nën të cilën do të cilësohet si anomalisht i ulët është 5,660,212.73 \$, ndërkohë që vlera më e ulët është 5,766,824 \$.

Objekti “Rikonstruksioni i rrugës Qafë Thorë – Theth” ka pasur gjashtë oferta si më poshtë:

1) 626,155,260 \$, 2) 826,474,000 \$, 3) 905,803,121 \$, 4) 690,491,990 \$, 5) 613,585,590 \$, 6) 686,341,790 \$

Vlera e përcaktuar nga formula nën të cilën do të cilësohet si anomalisht i ulët është 608,313,788.52 \$, ndërkohë që vlera më e ulët është 613,585,590 \$.

Siç shihet nga llogaritjet e mësipërme, në asnjë nga rastet nuk është evidentuar ofertë anomalisht e ulët dhe si rrjedhojë nuk i është kërkuar sqarim operatorit të renditur i pari.

Oëndrimi i grupit të auditimit

Subjekti i audituar thotë llogaritja e ofertave anomalisht të ulëta kryhet me anë të një formulë me komplekse matematikore e cila ka në përbërje mesataren e ofertave, devijim standard në raport me pjesëmarrësit por nuk e ka paraqitur këtë formulë dhe nuk vene ne dispozicion asnjë dokument zyrtar ku përcaktohet formula e miratuar sipas standardit të donatorit.

Për sa me sipër argument i dhënë nuk merret në konsideratë .

2.3.3 Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt **“Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht”** u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dosja e prokurimit me objekt “Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht”;
- Dokumentacioni i subjektit fitues;
- Korrespondenca zyrtare me Bankën Botërore;

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e konkurrimit për kontratën Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht ka qenë procedurë kombëtare me metodën e përcaktuar “Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentin (CQS)”.

Sipas rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016, Seksioni VII, Metoda të Aprovuara të Përzgjedhjes së Shërbimeve të Konsulencës, përzgjedhja në bazë të Kualifikimeve të Konsulentit CQS referuar pikës 7.12.

CQS është metodë e përshtatshme për detyra të vogla ose situata emergjente për të cilat nuk justifikohet vlerësimi i propozimeve konkurruese.

Në Manualin Operacional të Projekt, në pikën 3 Prokurime, tabela 3.1 është përcaktuar kushti:

- a. CQS below US\$300,000 depending on the nature of assignment.- Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentin nën 300,000\$, në **varësi të natyrës së detyrave**.

Në Strategjinë për Zhvillimin e Prokurimeve të Projektit PPSD, pika IV- Objektivat e Prokurimeve, pika 2.2 specifikohet:

Për Përzgjedhjen në bazë të Kualifikimeve të Konsulentit (CQS) afati i përllogaritur është afërsisht 4-6 muaj përfshirë periudhën e nevojshme për përgatitjen dhe dakortësimin e termave të referencës.

Mbështetur në Udhëzimet për Prokurime të Bankës Botërore, dokumenti Strategjia për Zhvillim të Prokurimeve të Projektit, Udhëzues i Detajuar Format i Shkurtër, Korrik 2016, në Aneksin I, pika 5, në tabelën e seksionit Qasja e rekomanduar e Prokurimeve të projektit ‘Recommended Procurement Approach for the Project’ duhet plotësuar kolona argumentimi, përmbledhja logjika ‘Justification Summary/Logic’ për Mënyrën e Prokurimit të zgjedhur.

Konstatim: Procedura e prokurimit në fjalë ka zgjatur 7 muaj nga data e dorëzimit dhe hapjes së shprehjeve të interesit deri në datën e lidhjes së kontratës dhe afërsisht 9 muaj nga periudha e përgatitjes së termave të referencës. Gjithashtu referuar sa më sipër nuk është argumentuar përzgjedhja e kësaj metode për këto shërbime mbikëqyrje nga ana e Klientit duke mos marrë në konsideratë natyrën e detyrës për shërbimin e mbikëqyrjes.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht.		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 1 datë 06.09.2018 për krijimin e komisionit të fondit limit, termave të referencës. Nr.1/1 datë 25.09.2018 për prokurimin	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit A. L. E.Xh. M. Xh.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër, 1/1 datë 25.09.2018 1. E. O. (Kryetar) 2. D.M. (Anëtar) 3. A. P. (Anëtar)
2. Procedura e Prokurimit Shërbim Konsulence me përzgjedhje në bazë të kualifikimeve sipas rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016		Urdhër, 1/2 datë 28.01.2019 për ndryshimin e KVO 1. E. O. (Kryetar) 2. D. M. (Anëtar) 3. L. M. (Anëtar)
5.Fondi Limit (me tvsh) 21,864,000 Leke	6.Oferta fituese (me tvsh) 21,360,000 Leke	7. Diferenca me fondin limit (me tvsh) 504,000 Leke
8. Data e hapjes së tenderit: 10.10.2018- data e dorëzimit dhe hapjes së shprehjeve të interesit 07.02.2019- afati i dorëzimit dhe hapjes së propozimeve 18.04.2019-afati i hapjes së propozimeve financiare	9.Burimi Financimit Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim IBRD	10.Operatorët Ekonomike a)I është dërguar Kërkesa për Shprehje Interesi 5 Operatoreve b)Kanë Shprehur Interesin 4 Operatore c)Janë shortlistuar 3 Operatore të cilëve ju është dërguar kërkesa për Propozim d) kane dërguar Propozime 2 Operatore
b. Zbatimi i Kontratës		
11.Lidhja e kontratës T ... H.. Co.... date 27.05.2019 Amendamenti Nr.1 datë 08.07.2019 Amendamenti Nr.2 datë 02.04.2020	12.Vlera e kontratës (me tvsh) 21,360,000 Lekë Kontrata Baze 1,788,000 Lekë Amendamenti 1 16,440,000 Lekë Amendamenti 2	13.Likuiduar deri datë 30.12.2020 29,475,000 Leke

Subjektet të cilëve iu është dërguar kërkesa për të shprehur interesin për Shërbime Konsulence janë si më poshtë.

NR.	OE/BOE
1.	T. H. Con. shpk
2.	Inf. shpk
3.	Ta.shpk
4.	Inf.Ko. shpk
5.	D&C partners shpk

Nuk është argumentuar apo dokumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për Shprehje Interesi.

Më datën e përcaktuar kanë dërguar Shprehjen e Interesit 4 subjekte si më poshtë:

NR.	OE/BOE	Statusi	
1.	T. H. Con. shpk	Kualifikuar	
2.	Ta. shpk	Kualifikuar	
3.	Inf.Kon. shpk	Kualifikuar	
4.	D&C partners shpk	S'kualifikuar	

Konsulenti “D&C Partners” shpk nuk është futur në listën paraprake sepse kompania ka fokus kryesor studime-projektme dhe jo supervizimi dhe disa nga punimet e mbikëqyrjes që ka paraqitur kanë të bëjnë me ndërtesa dhe jo me punime rrugore.

Konsulentëve të listës së shkurtër iu është dërguar kërkesa për propozim dhe në datën 07.02.2019 vetëm T.H. Con.shpk dhe Ta.shpk kanë dërguar propozimet.

Vlerësimi teknik për dy konsulentët është kryer referuar kritereve të cituara në Kërkesën për Propozim. Format i kërkesës për Propozim Teknik ka qenë i formës Propozim i thjeshtuar Teknik. Kriteret, nën-kriteret dhe Sistemi i pikëve kanë qenë si më poshtë:

Nr.	Kriteri	Piket
(i)	Saktësia dhe cilësia e metodologjisë së propozuar, dhe plani i punës në përputhje me Termat e Referencës	30
(ii)	Kualifikimet dhe kompetencat e Ekspertëve Kryesore për kryerjen e detyrës së përcaktuar:	
	a) Inxhinieri Kryesor	25
	b) Inxhinieri i mbikëqyrjes në terren	15
	c) Specialist mjedisor dhe social	10
	d) Inxhinieri /topograf volumesh	10
	e) Inxhinier për kontrollin e cilësisë	10
	Piket totale për kriterin (ii)	70
	Piket totale për dy kriteret:	100

Pikët minimale teknike për të kaluar fazën kanë qenë 75.

Secili anëtar i KVO ka bërë vlerësimin individual të konsulentëve dhe vlerësimi final është mesatare e tyre. Rezultatet e vlerësimit teknik janë si më poshtë:

OE	Pikët totale	Renditja
T. H. Con. shpk	95.33	1
Ta. shpk	90.50	2

Më 18.04.2019 është kryer hapja e propozimeve financiare dhe ofertat e konsulentëve kanë rezultuar si më poshtë:

OE	Oferta Financiare në Lekë
T. H. Con. shpk	17,800,000 lekë pa TVSH
Ta. shpk	18,740,000 lekë pa TVSH

Kontrata me Konsulentin fitues Tr. H. Con. shpk është lidhur më 27.05.2019. Kjo kontratë është shtuar dy herë.

Amendamenti Nr. 1 datë 08.07.2019 është lidhur me qëllim mbikëqyrjen e punimeve të rrugës Qafë Thore-Theth me vlerë 1,788,000 lekë me TVSH. Shërbimet e mbikëqyrjes për këtë segment rrugor nëpërmjet Amendamentin i jepen provizorisht operatorit THC shpk deri në lidhjen e një kontrate tjetër mbikëqyrjeje me një operator tjetër i cili ka për qëllim të supervizoje 45 km rrugë që përfshijnë këtë segment. Për amendamentin e parë të kontratës, referuar pikës 16.2 Modifikime dhe Variacione të seksionit II Kushte të përgjithshme të kontratës, thuhet:

16.2 Në rast të modifikimeve dhe variacioneve thelbësore, aprovimi paraprak me shkrim i bankës është i domosdoshëm.

Amendamenti nr.1 përfaqëson një modifikim thelbësor të kontratës sepse ky amendim ndryshon qëllimin e sajë. Në dosjen e prokurimit të kësaj kontrate mungon aprovimi i Bankës për këtë ndryshim. Por Banka ka dhënë aprovimin paraprak për ndryshimin e termave të referencës të konsulentit tjetër që do të zgjidhej për mbikëqyrjen e rindërtimit të 45 km rrugë përfshirë segmentin Qafë-Thore-Theth duke e hequr provizorisht shërbimin për këtë segment deri në lidhjen e kontratës.

Amendamenti Nr. 2 datë 02.04.2020 ka për qëllim supervizimi e rrugës Qafe Thore-Theth me vlerë 16,440,000 lekë me TVSH. Shërbimi i mbikëqyrjes për rrugën Qafe Thore-Theth është hequr nga kontratat e konsulentit tjetër dhe me anë të këtij amendamenti i shtohet këtij konsulent.

Gjatë negociimit të kontratës me konsulentin fitues për kontratën e mbikëqyrjes së rindërtimit të 45 km rruge ku përfshihej fillimisht dhe segmenti rrugor Qafe Thore-Theth, në minutat e takimeve janë ripërcaktuar segmentet rrugore që do mbikëqyren duke bërë zëvendësimet si më poshtë; Paragrafët 1. Rruga Qafë Thore- Theth, 2. Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugës Fier-Seman dhe, 3. Rehabilitimi i segmentit të tretë, janë zëvendësuar si vijon;

1. Rindërtimi i rrugës Gusmar-Kuç
2. Rindërtimi i rrugës Lekdush-Bënç-Tepelene, lot 2
3. Rehabilitimi i rrugës Fier –Seman

Banka ka dhënë aprovimin e sajë për sa më sipër.

Gjithashtu banka ka dhënë aprovimin paraprak me 30.03.2020 duke shprehur se nuk ka komente mbi amendament 2 të kontratës së superizionimit.

*Observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit të kryer në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin Konektiviteti i rrugëve Rajonale dhe Lokale Nr.675/15 datë 08.09.2021 dhe administruar në KLSH nr. 254/5 datë 09.09.2021, ku janë shprehur observacionet si më poshtë: **Pretendimet e subjektit mbi mos argumentimin e përzgjedhjes së metodës së prokurimit duke mos marrë në konsideratë natyrën e detyrës për shërbimin e mbikëqyrjes.***

Fillimisht sqarojmë se ashtu si përshkruhet në Projekt Raport, CQS është e përshtatshme për detyra të vogla ose situata emergjente në të cilat përgatitja dhe vlerësimi i Propozimeve Konkurruese nuk është i justifikuar. Vlera e parashikuar për këtë shërbim është 200,000 \$, çka përbën një detyrë të vogël (Vlera e parashikuar për supervizionin e rindërtimit të rrugëve (af. 45 km) është 1,200,000 \$). Shpjegimi i Tabelës 3.1

Për asnjë nga kontratat e konsulencës, përfshirë edhe CQS, nuk ka një limit monetar të mirë përcaktuar nga WB për këtë procedurë, pasi kjo vlerësohet rast pas rasti dhe për këtë arsye në kolonën Vlera e kontratës (Contract value) është shënuar n.a. – not applicable. Kjo pasi vetëm vlera e kontratës nuk është përcaktuese për llojin e prokurimit.

Përfundimisht nëpërmjet footnote, për CQS përcaktohet se limiti maksimal është 300,000 \$. Duke pasur parasysh se vlera e parashikuar për këtë shërbim është 200,000 \$, përzgjedhja e formës së prokurimit është bërë në respektim të këtij kushti.

Note: a. CQS below US\$300,000 depending on the nature of assignment

Në lidhje me PPSD, sqarojmë se tabela të cilës i referoheni V. Recommended Procurement Approach for the Project, është një tabelë udhëzuese. Tabela e përfshirë në PPSD e FSHZH, miratuar nga WB, është në fakt plani i prokurimit.

Sqarojmë se të gjitha dokumentat që përmbajnë përcaktimet fillestare të këtij projekti (Operation Manual, PPSD, etj.) janë miratuar nga WB, pra WB ka miratuar formën e prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Përzgjedhja e formës së prokurimit fillimisht është bërë në respektim të kushtin e limitit maksimal prej 300,000 \$ por kushti për përzgjedhje të kësaj metode specifikon dhe -depending on the nature of assignment-pra ne varesi të natyrës së punimeve. Shërbimet e supervizionit nuk janë detyra të vogla dhe as emergjente.

Në lidhje me tabelën në V. Recommended Procurement Approach for the Project për të cilën sqaron se është udhëzuese, dhe grupi i auditimit sqaron se do të ishte mirë ta merrnit për bazë këtë udhëzim për të shpjeguar dhe justifikuar përzgjedhjen e kësaj metode për shërbimin e mbikëqyrjes. Kjo kontratë është prokuruar me një procedurë të thjeshtuar për vlerën 21,360,000 lekë, për shërbimin e mbikëqyrjes dhe nëpërmjet dy amendamenteve Vlera e kësaj kontrate ka shkuar në 39,588,000 lekë, duke kaluar dhe kushtin fillestar të pragut të përzgjedhjes së kësaj metode.

Për sa me sipër argument i dhënë nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë .

2.3.3 Titulli i gjetjes: Mos justifikim i përzgjedhjes së metodës së prokurimit.

Situata: Në procedurën e prokurimit për kontratën “*Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht*” rezultoi se mënyra e prokurimit ka qenë procedurë kombëtare me metodën e përcaktuar “Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentit (CQS)”. Zhvillimi i kësaj procedure referuar rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016, Seksioni VII, Metoda të Aprovuara të Përzgjedhjes së Shërbimeve të Konsulencës, pika 7.12 *është e përshtatshme për detyra të vogla ose situata emergjente për të cilat nuk justifikohet vlerësimi i propozimeve konkurruese*, gjithashtu referuar Manualit Operacional të Projekt, Pika 3, tabela 3.1 është përcaktuar kushti *Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentin nën 300,000\$, në varësi të natyrës së detyrës*. Për më tepër në Strategjinë për Zhvillimin e Prokurimeve të Projektit PPSD, pika IV- Objektivat e Prokurimeve, pika 2.2 specifikohet për (CQS) *afati i përlllogaritur është afërsisht 4-6 muaj përfshirë periudhën e nevojshme për përgatitjen dhe dakortësimin e termave të referencës*. Mbështetur në Udhëzimet për Prokurime të Bankës Botërore, dokumenti “Strategjia për Zhvillim të Prokurimeve të Projektit, Udhëzues i Detajuar Format i Shkurtër, Korrik 2016”, rekomandohet argumentimi dhe logjik për Mënyrën e Prokurimit të zgjedhur. Konkretisht kjo procedure prokurimi ka zgjatur 9 muaj pra më shumë sesa periudha e përcaktuar si kriter për përzgjedhjen e saj, gjithashtu nuk është argumentuar përzgjedhja e kësaj metode për këto shërbime mbikëqyrje nga ana e Klientit duke mos marrë në konsideratë natyrën e detyrës për shërbimin e mbikëqyrjes

Ndikimi/Efekti: Pjesëmarrje e vogël në tender.

Shkak: Përzgjedhje e paargumentuar e metodës së prokurimit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia Prokurimit, të marrë masa që të analizojë metodologjitë e përzgjedhjes së mënyrave të prokurimit e ti argumentojë ato sipas kriterëve për zgjedhjen e tyre.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Zj. M. Dh. me detyrë, Specialiste e Prokurimeve.

2.3.4 Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt **“Rindërtimi i rrugës Gusmar-Kuç”** u dokumentacioni si më poshtë:

- *Dosjet e prokurimit me objekt “Rindërtimi i rrugës Gusmar-Kuç”.*
- *Dokumentacioni i subjektit fitues.*
- *Korrespondenca zyrtare me Bankën Botërore.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e konkurrimit për kontratën e rindërtimit të rrugës Gusmar-Kuç ka qenë tender i hapur ndërkombëtar duke përdorur Kërkesën për Tenderim (RFB) (Punime të Vogla, Proces Tenderimi me dy Zarfa) për të cilin kanë shprehur interes 26 shoqëri duke paguar tarifën e blerjes së dokumentacionit për procedurën e prokurimit e cila ka pasur një vlerë 200 Euro të parimbursueshme.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rindërtimi i rrugës Gusmar-Kuç		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 7 datë 20.07.2019 për krijimin e komisionit të fondit limit, specifikime. Nr.7/1 datë 02.08.2019 për prokurimin	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit P. M. E. Z. R. P.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Sipas Urdhrit, 7/1 datë 02.08.2019 1. E. O. (Kryetar) 2. D. M. (Anëtar) 3. D. M. A. (Anëtar)

2. Procedura e Prokurimit Procedura e hapur sipas rregullores se Prokurimit te Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016		
5.Fondi Limit (me tvsh) 9,628,800 \$	6.Oferta fituese (me tvsh) 5,780,441 \$	7. Diferenca me fondin limit (me tvsh) 3,848,359 \$
8. Data e hapjes së tenderit: 20 Shtator 2019 ora 11:00 data e hapjes se zarfitte pare Pjesa Teknike 21 Tetor 2019 ora 11:00 data e hapjes se zarfit te dyte Propozimi Financiar	9.Burimi Financimit Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim IBRD	10.Operatoret Ekonomike a)Shprehje Interesi dhe blere dokumentet 26 Operatore b)Pjesëmarrës në tender 10 operatore dhe bashkime operatorësh c)S’kualifikuar 3
b. Zbatimi i Kontratës		
11.Lidhja e kontratës R. AL – T. Con. Est. Nr.1752 date 03.12.2019	12.Vlera e kontratës (me tvsh) 5,780,441 \$	13.Likuiduar deri datë 30.12.2020 2,163,563.38 \$

Në mënyrë kronologjike hapat e procedurës janë sa vijon:

Nr.	Datat	Aktiviteti i kryer
1	20.07.2019	Urdhër për Hartimi i dokumenteve të tenderit
2	02.08.2019	Urdhër Prokurimi
3	05.08.2019	Aprovimi Bankës
4	05.08.2019	Publikimi në faqen e FSHZH
5	06.08.2019	Publikimi në Gazeta
6	20.09.2019	Cek-lista e Hapjes se tenderit
7	17.10.2019	Raporti i Vlerësimi Teknik
8	21.10.2019	Hapja e zarfit me Propozimin financiar
9	14.11.2019	Njoftimi i kontratës- letter of acceptance
10	06.12.2019	Publikimi i kontratës
11	03.12.2019	Lidhja e kontratës

Subjektet të cilat kanë dorëzuar ofertat sipas afateve ishin:

Nr.	OE/BOE	Statusi
1.	Sal. shpk	Kualifikuar
2.	Ra. AL – T. Con. Es	Kualifikuar
3.	Av.-T.M. JCS-Shu.	Kualifikuar
4.	AL-St. shpk	Kualifikuar
5.	Gj. Kon.sha	Kualifikuar
6.	JV Vell. H. SHPK & Ric. Con. Sr.	Skualifikuar
7.	IN. Sp.	Kualifikuar
8.	G. 2	Kualifikuar
9.	T. T. A. T. L. S.	Skualifikuar
10.	G.M.C. Con. Sr.	Skualifikuar

BOE “V. H. SHPK & R. C. Sr.” nuk i plotëson kërkesat e dokumentave të tenderit. Ofertuesi nuk ka dorëzuar dokumentin sigurimin e tenderit për këtë arsye është S’kualifikuar.

Operatoret Tekar Teknik Arastrima Ticaret Limited Sirketi dhe GI.MA.CO. Con. Sr. nuk i plotëson kërkesat e dokumentave të tenderit sepse dokumentet e dorëzuar nuk janë të noterizuara/legalizuara/me vule apostile për këtë arsye janë S’kualifikuar këta dy operatorë.

Pas hapjes se zarfit të dytë me Propozimin Financiar, vlerat e ofertave të operatoreve të kualifikuar janë si më poshtë:

Nr.	OE/BOE	Vlera e Ofertës pa TVSH US\$	Vlera e Ofertës me TVSH US\$	Vlera e Ofertës me TVSH pas korrigjimit US\$
1.	R. AL – T. Con. Es	4,805,687	5,766,824	5,780,441
2.	G..... sh.p.k	4,820,032	5,784,038	5,784,496
3.	IN. Sp.	4,844,738	5,813,685	5,813,685
4.	Gj. Kon.sha	5,019,336	6,023,204	6,023,204
5.	S. shpk	5,171,117	6,205,341	6,205,341
6.	Al.-St. shpk	5,344,281	6,413,137	6,414,559
7.	Av.-T. M. JC.-Shu.	5,994,499	7,193,399	7,193,400

Gjatë vlerësimit të propozimeve financiare KVO ka gjetur gabime aritmetike në ofertat e 3 operatoreve, ka kryer korrigjimet përkatëse dhe i janë dërguar operatoreve për pranim. Edhe pas korrigjimeve oferta me vlerë me të ulët mbetet ajo e operatorit “R. AL-T. Con. Es”.

2.3.5 Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Supervizimi i rehabilitimit të segmenteve të 3 rrugëve kombëtare: rruga Vlorë-Orikum (10.6km), rruga Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km) dhe rruga Zgosht-Ura e Çerenit (47.1km)” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Dosja e prokurimit me objekt Supervizimi i rehabilitimit të segmenteve të 3 rrugëve kombëtare: rruga Vlorë-Orikum (10.6km), rruga Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km) dhe rruga Zgosht-Ura e Çerenit (47.1km).*
- *Dokumentacioni i subjektit fitues*
- *Korrespondenca zyrtare me Bankën Botërore*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e konkurrit për kontratën Supervizimi i rehabilitimit të segmenteve të 3 rrugëve kombëtare: rruga Vlorë-Orikum (10.6km), rruga Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km) dhe rruga Zgosht-Ura e Çerenit (47.1km), ka qenë tender i hapur me para-kualifikim.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Supervizimi i rehabilitimit të segmenteve të 3 rrugëve kombëtare: rruga Vlorë-Orikum (10.6km), rruga Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km) dhe rruga Zgosht-Ura e Çerenit (47.1km)		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 3 datë 02.03.2020 për krijimin e komisionit te fondit limit, specifikime. Nr. 3/1 datë 12.03.2020 për prokurimin	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit A. N. Xh. H. B. H.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Sipas Urdhrit, 3/1 datë 12.03.2020 1. E. O. (Kryetar) 2. D. M. A. (Anëtar) 3. E. K. (Anëtar)
2. Procedura e Prokurimit Procedure e hapur me para kualifikim sipas rregullores se Prokurimit te Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 1.11. 2017		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,500,000 \$	6.Oferta fituese (pa tvsh) 821,800 \$	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 678,200 \$

8. Data e hapjes së tenderit: 12.03.2020 Afati për dorëzimin e aplikimit për Prækualifikim 14.10.2020 Afati për dorëzimin e propozimeve	9. Burimi Financimit Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim EBRD	10. Operatorët Ekonomike a) Aplikime në fazën e Parakualifikimit 30 Operatorë b) Te para kualifikuar 6 Operatorë c) Pjesëmarrës në fazën e dytë 6 Operatore d) Kualifikuar 6 Operatore
b. Zbatimi i Kontratës		
11. Lidhja e kontratës Nr. 3451 date 28.12.2020 JV Pan Arab Engineers (PACE) & Erald G Ltd	12. Vlera e kontratës (me tvsh) 986,160 \$	13. Likuiduar deri datë 31.12.2020 - 0 leke

Ftesa për të dërguar Shprehje Interesi është publikuar më 12.03.2020 me afat për mbyllje në datën 14.04.2020 ora 10:00. Brenda afatit të përcaktuar janë marrë 30 aplikime. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kontrolluar, vlerësuar dhe renditur aplikimet e marra në bazë të kriterëve dhe metodologjisë së përcaktuar për vlerësimin. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka rekomanduar një listë të shkurtër me 6 operatorë që të ftohen për të dërguar propozime.

Nr.	OE/BOE	Shteti	Operatori Kryesor
1	3T. P. It.-Ing. Int. S.p.A	Itali	
2	D.Eng. Inc. C.	Turqi	
3	I. Eng. S.r.	Itali	
4	J. H. Int.N.V & S. Con. Eng. Center	Holandë Jordani	H. Int. N.V
5	J. P. A. Con. Eng. (P.) & E. –G lt.	Kuvajt Shqipëri	P.A.Con.Eng.
6	J. R. SA & Il. Con. Eng.	Zvicër Shqipëri	Re. S.

Kërkesa për propozim është dërguar më 24.08.2020, dhe data e hapjes së Propozimeve Teknike ka qenë data 14.10.2020 ora 10:00AM. Gjashtë operatorët e listës së shkurtër kanë dërguar propozimet brenda afatit dhe janë kualifikuar për vlerësim të detajuar teknik. Vlerësimi teknik është kryer në bazë të tre kriterëve, eksperiencia profesionale relevante e konsulentit, cilësia e metodologjisë së propozuar për detyrën dhe kualifikimet e eksperteve kyç. Vlerësimi teknik mban 70 % të peshës së vlerësimit total. Secili anëtar i KVO ka kryer vlerësimin individual dhe pikët teknike mesatare për secilin konsulent rezultuan si më poshtë:

OE/BOE	Pikët teknike mesatare	Renditja teknike	Pikët teknike të ponderuara 70%
3T. P. I.-Ing. Int. S.p.	82.31	6	57.60
D. Eng. In. Co	84.26	5	58.98
I. Eng. S.r.	84.28	4	59.00
J.H Int. N.V & S. Con. Eng. C.	91.71	2	64.20
J. P.A. Con. Eng. (P.) & E. –G l.	89.34	3	62.54
J. R. S & I. Con. Eng.	92.30	1	64.61

Hapi tjetër ka qenë shqyrtimi i detajuar i propozimeve financiare, vlerësimi i të cilit mban 30 % të peshës së vlerësimit total. Propozimet financiare të konsulentëve dhe vlerësimi i tyre paraqiten si më poshtë:

OE/BOE	Propozimi financiar, euro	Piket financiare 30%	Pikët totale
3T. P. It. Ing. Int. S.p.	860,087.31	24.14	81.75
D. Eng. In. Co	1,034,585.63	20.07	79.05

IR. Eng. S.r.	1,010,502.00	20.54	79.54
J.H. Int. N.V & S. Con. Eng. C.	964,643.40	21.52	85.72
J. P. A.Con.Eng (P.A.) & E. –G lt.	692,025.45	15.32	92.54
J. R. S. & Il. Con.Eng.	1,355,114.34	30.00	79.93

Referuar këtij vlerësimi konsulenti fitues është shpallur J. P. Ar.Con. Eng. (P.) & E. –G ltd me të cilin është lidhur kontrata nr. 3451 datë 28.12.2020.

2.3.6 - Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore”

Prokurimi “Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore”, Kontrata RL.CP/1/1.9/2018, është planifikuar si pjesë përbërëse e planit të “Projektit Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RL.CP) Nr. P163239, i cili është dakordësuar nga Banka në datën 12 Mars 2019.

Kontrata e shërbimit të konsulencës RLRCP/1/1.9/2018 përfshin auditimin e sigurisë rrugore për përmirësimin e saj në dy drejtime, në projektim dhe zbatim, në segmentet rrugore Fier-Seman, Pogradec-Tushemisht dhe Qafë Thorë-Theth (gjithsej 37.6 km) dhe një segment i katërt i papërcaktuar. Gjithashtu, përfshin studimin dhe projektimin e një zone të afërt pilot (me kushte sigurie të ulët), në përputhje me standardet e sigurisë dhe rregullat teknike të projektimit të rrugëve dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. Metoda e zgjedhjes në prokurimin për shërbimin e kësaj konsulence është caktuar ajo e Cilësisë së Konsulentit dhe e Kostos Bazë (QCBS). Kontrata (Lump-Sum) Nr.1579 Prot., date 29.10.2019 është lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe J. “F. ENG. SR. & Inf. SH.P.K. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me të dhëna të përgjithshme të prokurimit është dhënë në tabelën si më poshtë:

“Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore” RLRCP/1/1.9/2018		
1.Urdhër : -Nr. 5 datë 12.03.2019 për krijimin e komisionit të fondit limit, hartimin e termave të referencës dhe kriterëve të kualifikimit. -Nr.5/1, date 19.03.2019 për prokurimin.	3.Komisioni për caktimin e fondit limit 1.Z. M. 2.M. Xh. 3.A. L.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave 1. E. O. (Kryetar) 2. D. M. (Anëtar) 3. L. M. (Anëtar)
2.Procedura prokurimit Procedure e hapur kombëtare.		
5.Fondi Limit (me tvsh) (21,556,000 lekë) 200,000 US\$	6.Oferta fituese (me tvsh) 187,680 USD	7. Diferenca me fondin limit (me tvsh) 12,320 USD
8. Data e hapjes së tenderit: -25 Korrik 2019, ora 11:00. -27 Gusht 2019, ora 11:00 data e hapjes publike të zarfit të dytë Propozimi Financiar.	9.Burimi Financimit Huaja Nr. 8850-AL Banka Botërore. IBRD “Projekti i Konektivitetit të Rrugëve Lokale dhe Rajonale” P163239.	10.Operatorët Ekonomike a) Kanë shprehur interesin 12 konsulentë.. b) Pjesëmarrës në tender 7 konsulentë.
b. Zbatimi i Kontratës		

11.Lidhja e kontratës J. “F. Eng.” Sr.& “Inf.” shpk -Nënshkrimi i kontratës 29.10.2019. -Shtesa Nr. 1 e kontratës 13 Korrik 2020.	12.Vlera e kontratës (me tvsh) 187,680 US\$ Shtesa 12,300 US\$	13.Likuiduar deri datë 31 Dhjetor 2020 93,840.00 US\$
---	--	---

Për më tepër shih Aneks 3.1 të këtij Raportit Përfundimtar.

Në raportin e vlerësimit datë 11 Shtator 2019, është rekomanduar lidhja e kontratës me konsulentin J. “F. Eng.” Sr. & “Inf.” sh.p.k. në vlerën prej 187,680 USD me TVSH. Negociatat për lidhjen e kontratës me aplikantin potencial fitues të sipërcituar janë kryer në datat 12 dhe 18 Shtator 2019. Gjatë këtyre negociatave në datën 18.09.2019 është vendosur për ndryshimet si më poshtë:

-Në pikën 2 të Minutave të Takimit, segmenti i katërt i papërcaktuar në TOR, pjesë e Kërkesës për Propozim, është përcaktuar segmenti rrugor Gusmar-Kuç dhe Lekëdush-Tepelenë.;

-Në pikën 6 të Minutave të Takimit, është hequr pagesa në avancë (paradhënie) e konsulentit dhe pagesat për konsulentin janë ndryshuar si më poshtë:

- (i) Fatura e dorëzuar pas përgatitjes të Raportit Fillestar dhe Raportet e Auditimit për tre segmentet e para të jetë 30 % e shumës totale të kontratës;
- (ii) Fatura pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot të jetë 40 % e shumës totale të kontratës;
- (iii) Fatura pas Raportit të Auditimit për segmentin e katërt rrugor të jetë 20 % e shumës totale të kontratës;
- (iv) Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimi të Raportit përfundimtar.

Konsulentit fitues J. “F. Eng.” Sr. & “Inf.” sh.p.k, me faturat nr. 01 datë 03.06.2020 dhe nr. 02 datë 02.07.2020 është paguar me shumat përkatësisht 56,304 US\$ dhe 37,536 US\$ për raportet e prezantuara. Nga kartela e klientit nuk rezulton të jetë kryer pagesa në avancë. Por, në Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 “Termat e Referencës”, pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH) është përcaktuar se për pagesat Konsulenti do të dorëzojë faturat sipas programit si më poshtë:

- (i) Financimi paradhënie: Konsulenti ka të drejtë që me nënshkrimin e kontratës të paguhet me një paradhënie prej 20 % të çmimit total të vlerësuar përkundrejt një garancie bankare për shumën e marrë dhe e vlefshme deri në përfundimin e punës së kryer.
- (ii) Pagesa e faturës: Konsulenti do të lëshojë 3 fatura për shërbimet e kryera pas miratimit nga FSHZH deri në madhësinë prej 70 % të kontratës. Shuma prej 10 % e mbetur do të jetë paguar pas përfundimit dhe pranimi të Raportit Përfundimtar.
- (iii) Pagesa prej 10 %: Pas mbikëqyrjes të masave të implementuara dhe dorëzimit të Raportit Përfundimtar.

Gjithashtu, në termat e referencës është parashikuar se pagesat mund të ndjekin hapat e mëposhtëm:

-Pagesa paradhënie 20 %;

-Fatura 25 % e shumës totale, pas përgatitjes së Raportit Fillestar dhe Raportëve të Auditimit për tre segmentet e para (duke zbritur vlerën e pagesës paradhënie);

-Fatura 30 % e shumës totale, pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot (duke zbritur vlerën e pagesës për paradhënien);

-Fatura 15 % e shumës totale, pas dorëzimit të raportit të auditimit për segmentin e katërt (ripagimi total i paradhënies);

-Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimit të Raportit Përfundimtar. Pagesat duhet të jenë bërë bazuar me faturat e dorëzuara në përputhje me numërin e ditëve të punuara të aprovuara dhe të verifikuara si edhe në dokumentet mbështetëse për rimbursimin e transportit, hotelit etj. Nga auditimi rezultoi se kjo praktikë nuk mbahej.

Sa sipër, kjo mënyrë pagese e përcaktuar në ToR do të ishte ulje e riskut për kryerjen e detyrave të konsulentit. Me Urdhrin Nr.07 datë 20.07.2019 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH segmenti Gusmar-Kuç është vendosur si prioritet përpara skadimit të afatit të Kërkesës për Propozim (25 Korrik 2019) për kontratën RLRCP/1/1.9/2018.

Sa sipër, është në kundërshtim me Kërkesën për Propozim, Seksionin 2 Instruksionet për Konsulentët, pika D, shkronjat (b), paragrafi 28.5, si edhe me Seksionin 7, pika 3 dhe 6, si edhe në kundërshtim me Udhëzimin e Bankës IBRD “Rregullat e Prokurimit” 1 Korrik 2016, Ndryshimi i sipërpërmendur i termave të references në momentin e lidhjes së kontratës përbën devijim nga kushtet e kërkuara në kërkesën për propozim, si edhe rrit rrezikun për zbatimin dhe përfundimin e detyrave të konsulentit.

2.3.4 Titulli i gjetjes: Ndryshimi i kushteve të pagesës së konsulentit jashtë kërkesave të termave të referencës.

Situata: Në raportin e vlerësimit datë 11 Shtator 2019, është rekomanduar lidhja e kontratës me konsulentin J. “F. Eng.” Sr. & “Inf.” sh.p.k. në vlerën prej 187,680 USD me TVSH. Negociatat për lidhjen e kontratës me aplikantin potencial fitues të sipërcituar janë kryer në datat 12 dhe 18 Shtator 2019. Gjatë këtyre negociatave në datën 18.09.2019 është vendosur për ndryshimet si më poshtë:

-Në pikën 6 të Minutave të Takimit, është hequr pagesa në avancë (paradhënie) e konsulentit dhe pagesat për konsulentin janë ndryshuar si më poshtë:

- (i) Fatura e dorëzuar pas përgatitjes të Raportit Fillestar dhe Raportet e Auditimit për tre segmentet e para të jetë 30 % e shumës totale të kontratës;
- (ii) Fatura pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot të jetë 40 % e shumës totale të kontratës;
- (iii) Fatura pas Raportit të Auditimit për segmentin e katërt rrugor të jetë 20 % e shumës totale të kontratës;
- (iv) Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimit të Raportit përfundimtar.

Por, në Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 “Termat e Referencës”, pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH) është përcaktuar se për pagesat Konsulenti do të dorëzojë faturat sipas programit si më poshtë:

- (i) Financimi paradhënie: Konsulenti ka të drejtë që me nënshkrimin e kontratës të paguhet me një paradhënie prej 20 % të çmimit total të vlerësuar përkundërt një garancie bankare për shumën e marrë dhe e vlefshme deri në përfundimin e punës së kryer.
- (ii) Pagesa e faturës: Konsulenti do të lëshojë 3 fatura për shërbimet e kryera pas miratimit nga FSHZH deri në madhësinë prej 70 % të kontratës. Shuma prej 10 % e mbetur do të jetë paguar pas përfundimit dhe pranimit të Raportit Përfundimtar.
- (iii) Pagesa prej 10 %: Pas mbikëqyrjes të masave të implementuara dhe dorëzimit të Raportit Përfundimtar.

Gjithashtu, në termat e referencës është parashikuar se pagesat mund të ndjekin hapat e mëposhtëm:

-Pagesa paradhënie 20 %;

-Fatura 25 % e shumës totale, pas përgatitjes së Raportit Fillestar dhe Raporteve të Auditimit për tre segmentet e para (duke zbritur vlerën e pagesës paradhënie);

-Fatura 30 % e shumës totale, pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot (duke zbritur vlerën e pagesës për paradhënien);

-Fatura 15 % e shumës totale, pas dorëzimit të raportit të auditimit për segmentin e katërt (ripagimi total i paradhënies);

-Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimi të Raportit Përfundimtar.

Pagesat duhet të jenë bërë bazuar me faturat e dorëzuara në përputhje me numrin e ditëve të punuara të aprovuara dhe të verifikuara si edhe në dokumentet mbështetëse për rimbursimin e transportit, hotelit etj. Nga auditimi rezultoi se kjo praktikë nuk mbahej.

Sa sipër, kjo mënyrë pagese e ndryshuar në momentin e lidhjes së kontratës janë në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, gjithashtu, në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 “Termat e Referencës”, pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH). Ndryshimet e mësipërme rrisin rrezikun e përfundimit të detyrave të konsulentit gjatë zbatimit të kontratës.

Kriteri: Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 “Termat e Referencës”, pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH) ku përcaktohet që:

(i) *Financimi paradhënie: Konsulenti ka të drejtë që me nënshkrimin e kontratës të paguhet me një paradhënie prej 20 % të çmimit total të vlerësuar përkundrejt një garancie bankare për shumën e marrë dhe e vlefshme deri në përfundimin e punës së kryer.*

(ii) *Pagesa e faturës: Konsulenti do të lëshojë 3 fatura për shërbimet e kryera pas miratimit nga FSHZH deri në madhësinë prej 70 % të kontratës. Shuma prej 10 % e mbetur do të jetë paguar pas përfundimit dhe pranimi të Raportit Përfundimtar.*

(iii) *Pagesa prej 10 %: Pas mbikëqyrjes të masave të implementuara dhe dorëzimit të Raportit Përfundimtar.*

-Pagesa paradhënie 20 %;

-Fatura 25 % e shumës totale, pas përgatitjes së Raportit Fillestar dhe Raporteve të Auditimit për tre segmentet e para (duke zbritur vlerën e pagesës paradhënie);

-Fatura 30 % e shumës totale, pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot (duke zbritur vlerën e pagesës për paradhënien);

-Fatura 15 % e shumës totale, pas dorëzimit të raportit të auditimit për segmentin e katërt (ripagimi total i paradhënies);

-Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimi të Raportit Përfundimtar.

Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, ku përcaktohet që:

Negociatat përfshijnë diskutimet për TOR, metodologjinë e propozuar, të dhënat e klientit, kushtet e veçanta të kontratës, dhe finalizimit të “Përshkrimeve të Shërbimeve” pjesë e kontratës. Këto diskutime nuk duhet të ndryshojnë në thelb fushëveprimin në origjinë të shërbimeve sipas TOR ose kushtet e kontratës, cilësinë e produktit final, çmimin e saj, ose të jetë prekur rëndësia e vlerësimit fillestar.

Ndikimi/Efekti: Menaxhimi me risk të lartë i kontratave të Konsulencës

Shkaku: Nuk është zbatuar kuadri rregullator dhe ligjor

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ardhmen në drejtim të menaxhimit me risk sa më të ulët të kontratave të Konsulencës. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z.E. O. me detyrë Drejtor i Departamentit të Projekteve në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit.

2.3.7- Për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime të supervizionit për rikonstruksionin e rrugëve, afërsisht 45 km”.

Në zbatim të Marrëveshjes së Huas Nr. 8850 datë 05.06.2018 ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Qeverisë Shqiptare, në datën 27 Shtator 2018 është miratuar plani i prokurimit të aktiviteteve të “Projekt Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLRCP) Nr.P163239, pjesë e të cilit është edhe kontrata RL.CP/1/1.6/2018. Prokurimi është përfunduar me Njoftimin për Lidhjen e Kontratës në datën 07 Prill 2020. Kontrata me Konsulentin "Ep. Ser. de Ing." s.l. është nënshkruar në datën 17 Prill 2020. Madhësia në vlerë e Kontratës, Ref. Nr:RL.CP/1/1.6/2018, është 816,024 USD me TVSH. Periudha kohore 22 muaj + 24 muaj për periudhën e garancisë. Metoda e zgjedhjes në prokurimin për kontratën e mësipërme është caktuar ajo e Kualifikimit të Cilësisë dhe e Kostos Bazë (QCBS). Termat e Referencës për prokurimin e mësipërm janë dakortësuar pa kundërshti (no-objection) nga Banka në datën 13.12.2018.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit të kontratës RLRCP/1/1.6/2018 janë dhënë si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbime supervizionimi për rindërtimin të disa rrugëve (afërsisht 45 km)” RLRCP/1/1.6/2018		
1.Urdhër : -Nr.3 datë 16.11.2018 për krijimin e komisionit të fondit limit, hartimin e termave të referencës dhe kriterëve të kualifikimit. -Nr.3/1, për prokurimin date 14.12.2018	3.Komisioni për caktimin e fondit limit 1.E. K. 2. Z. B. 3. A. L.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave 1. E. O. (Kryetar) 2. D. M. (Anëtar) 3. L. M. (Anëtar)
2. Modeli tregut -Procedure e hapur ndërkombëtare.		
5.Fondi Limit (me tvsh) 129,336,000lekë 1,200,000 US\$	6.Oferta fituese (me tvsh) 816,024 USD	7. Diferenca me fondin limit (me tvsh) 383,976 USD
8. Data, ora e hapjes së tenderit: -26 Korrik 2019, ora 11:00 -Njoftimi i shprehjes së interesit: datë 14.12.2018. -Afati i dorëzimit me shkrim i dokumenteve kualifikimi paraprak, datë 07.01.2019. -Hapja e tenderit: datë 26 Korrik 2019, ora 11:00 -Data e hapjes publike të zarfit të dytë Propozimi Financiar.22 Tetor 2019 ora 12:30.	9.Burimi Financimit Banka Ndërkombëtare Per Rindërtim dhe Zhvillim IBRD. Marrëveshja Huasë Nr. 8850-AL, datë 05.06.2018	10.Operatorët Ekonomike a)Shprehën interesin 21 konsulentë b) S’kualifikuar nga krijimi i short-list 13 konsulentë. c).Pjesëmarrës në tender 8 konsulentë.
b. Zbatimi i Kontratës		
11.Lidhja e kontratës “Ep. Ser. de Ing.” sl. 17 Prill 2020	12.Vlera e kontratës (me tvsh) 816,024 USD	13.Likuiduar deri datë 31 Dhjetor 2020 186,248,07 USD

Për më tepër shih Aneks 3.2 të këtij Projekt-raporti.

Në datën 06.06.2019 nga ana e FSHZH është kërkuar ndryshimi i termave të referencës mbi kompozimin e stafit të ekspertëve dhe është dakordësuar nga Banka në datën 12.06.2019.

Përbërja e stafit të ekspertëve kryesor është përfshirë në “Kërkesë për Propozim në Shërbimet e Konsulencës” Seksionin 7 Termat e Referencës, V.2, datë 12.06.2019 si më poshtë:

Ekipi i Ekspertëve	Të dhënat minimale të ditëve të punës (MM)
Ekspertët Kryesor	
Krye/ Inxhinier rezident (1)	24
Inxhinier Mbikëqyrës në terren (3)	49
Specialist Social dhe Ambienti (1)	23
Inxhinier/Topograf (2)	39
Inxhinier Kontrolli i Cilësisë (1)	24
Si kërkesë minimale 8 (persona)	159 (MM)

Detyrat kryesore të Konsulentit për këtë kontratë shërbimi të konsulencës janë përcaktuar si më poshtë:

1. Rishikimi i vizatimeve dhe modifikimet e mundshme me kushtet e terrenit (koha 1 muaj);
2. Realizimi i aktivitetit kryesor, si mbikëqyrja e përditshme, aprovimi i materialeve, kontrolli i kostos, kontrolli i kohës, raportimi etj.(koha 12 muaj).
3. Periudha e përgjegjësisë ndaj defekteve, ku konsulenti inspekton dhe vlerëson performancën dhe punët e përfunduara nga kontraktori (koha 24 muaj) etj.

Kërkesa për Propozim përfshin vlerësimin teknik dhe vlerësimin financiar. Ndërmjet propozimeve që janë përgjigjur dhe janë kualifikuar teknikisht, propozimi më i lartë i kombinuar (kosto dhe cilësia teknike), që rezulton nga vlerësimi, është konsideruar propozimi me më shumë avantazhe. Në Kërkesën për Propozim (të dhënat Data sheet) është përcaktuar një sistem vlerësimi teknik me pikë si për mjaftueshmërinë dhe cilësinë e metodologjisë së propozuar, ashtu edhe për kualifikimet e ekspertëve dhe kompetencën e tyre. Në Seksionin 7 Termat e Referencës, pika III “Kontrata e Shërbimit” janë përcaktuar 3 segmente rrugore në rikonstrukcion, prej të cilave 2 segmente janë Fier-Seman dhe Qafë Thorë-Theth, ndërkohë segmenti i tretë i papërcaktuar. Nga auditimi ka rezultuar se, me Urdhrin Nr. 07 datë 20.07.2019 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH, është ngritur komisioni i hartimit të fondit limit dhe termave të referencës për segmentin rrugor Gusmar-Kuç. Gjithashtu, në zbatim të marrëveshjes së huas janë nënshkruar marrëveshjet e investimit të FSHZH me bashkitë Tepelenë dhe Himarë në datat 11 Korrik 2019 dhe 18 Korrik 2019 lidhur me segmentet rrugore Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë. Por, ndryshimi i segmenteve rrugore, pjesë përbërëse e Termave të Referencës, ka ndodhur në procesin e lidhjes së kontratës. Gjithashtu, në momentin e nënshkrimit të kontratës ndërmjet FSHZH dhe “Eptisa Servicios de Ingenieria” s.l. datë 17.04.2020 është përcaktuar “Rindërtimi i 3 segmenteve rrugore, nga ku 2 prej tyre Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Bëç janë të vendosura në territorin e bashkive Vlorë dhe Tepelenë, dhe një segment i tretë i papërcaktuar”.

Në datën 03 Mars 2020, nga ana e FSHZH, është kërkuar negociimi për lidhjen e kontratës “Shërbimi i Supervizionit për rikonstrukcionin e rrugëve (afërsisht 45 km)”, Ref.Nr. RL.CP/1/1.6/2018 me kandidatin potencial të radhës së dytë “E. Ser. de Ing.” s.l. Në Minutat e Takimit, “Pjesa Teknike” pika 2, datë 06 Mars 2020, është vendosur për ndryshimin e segmenteve rrugore, në të cilin është hequr segmenti Qafë Thorë-Theth dhe në vend të tij është vendosur segmenti Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë. Por, në Udhëzimin e Prokurimeve të Bankës Botërore, Prill 2018, botimi i pare, Seksioni IV, pika 6 Lidhja e Kontratës, nuk është parashikuar ndryshim i termave të referencës në këtë hap të procesit të prokurimit, por vetëm njoftimi i qëllimit

të lidhjes, i cili përfshin periudhën e pauzës së procesit për ankimet e mundshme, përfundimin e kësaj periudhe dhe njoftimin për lidhjen e kontratës.

Sa sipër, janë ndryshuar termat e referencës në kundërshtim me pikën 13 “Sqarime dhe ndryshime të Kërkesës për Propozim, Seksioni 2 “Instruksionet për Konsulentët”, në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, si edhe në kundërshtim me Udhëzimin e Bankës IBRD “Rregullat e Prokurimit” 1 Korrik 2016, Seksioni V Sqarime të Dokumenteve të Prokurimit, Paragrafi 5.31 dhe 5.32.

Në Seksionin 7 “Termet e Referencës”, pika 8 Kriteret dhe Procedurat e Vlerësimit, është përcaktuar se propozimet do të duhet të përfshijnë informacionin si më poshtë:

(i) Metodologjinë dhe panoramën e teknikave në të cilën detyrat do të jenë implementuar;

(ii) Propozimi financiar, në formën e normave ditore fikse;

(iii) Kompozimi i stafit, të cilët do të kryejnë detyrat dhe Jetëshkrimi i tyre.

Sa sipër, segmenti rrugor me të cilin lidhet shërbimi i konsulencës është konkret dhe nuk mund të përgjithësohet.

Në Kërkesën për Propozim, Instruksionet për Konsulentët, tek të dhënat (Data Sheet), pika C, është kërkuar që metodologjia e propozuar nga konsulentët dhe plani i punës duhet të jenë në përgjigje të termave të referencës.

Në Seksionin 3 Propozimi Teknik, Form TECH-4, është përcaktuar struktura e propozimit teknik, e cila përbëhet nga Qasja Teknike dhe Metodologjia, Plani i Punës, Organizimi dhe Stafi.

Për sa më sipër, ndryshimi i qasjes teknike, apo ndryshimi i segmenteve rrugore në momentin e lidhjes së kontratës, ka shkaktuar deformim në procesin e prokurimit, për arsye se ndryshimi i termave të referencës, apo kushteve të kontratës kryhen përpara skadimit të afatit përfundimtar (deadline) të dorëzimit të Kërkesës për Propozim. Gjithashtu, pavarësisht nga ngjashmëria e kompleksitetit, segmentet ndryshojnë nga njëri tjetri dhe për pasojë ndryshon edhe kompozimi i stafit të ekspertëve, ditët e punës efektive të tyre, apo metodologjia e hartuar.

Ndryshimi i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës ka shkaktuar si pasojë mungesën e njohjes me ndryshimet për të gjithë konsulentët potencial pjesëmarrës në tender.

2.3.5 Titulli i gjetjes: Ndryshim i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës.

Situata: Kontrata “Shërbimet të Supervizionit për Rikonstruksionin e Rrugëve, afërsisht 45 km” RL.CP/1/1.6/2018 është pjesë e Planit të Prokurimit të Projektit “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” P163239 datë 27.09. 2018.

Në datën 06.06.2019, për kontratën RLRC/1/1.6/2018, është kërkuar ndryshimi i termave të referencës mbi përbërjen e stafit të ekspertëve dhe kërkesat për ekspertët kryesor, ndryshime të cilat janë dakortësuar nga Banka në datën 12 Qershor 2019.

Në Seksionin 7 Termet e Referencës, pika III “Kontrata e Shërbimit” janë përcaktuar 3 segmente rrugore në rikonstruksion, prej të cilave 2 segmente janë Fier-Seman dhe Qafë Thorë-Theth, ndërkohë segmenti i tretë i papërcaktuar.

Afati për dorëzimin e Kërkesës për Propozim për kontratën RLRC/1/1.6/2018 është vendosur data 26.07.2019.

Me Urdhrin Nr.07 datë 20.07.2019 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH, është ngritur komisioni i hartimit të fondit limit dhe termave të referencës për segmentin rrugor Gusmar-Kuç.

Në zbatim të Marrëveshjes së Huas me Bankën Botërore IBRD Nr.8850-AL datë 05.06.2018 janë nënshkruar marrëveshjet e investimit të FSHZH me bashkitë Tepelenë dhe Himarë në datat 11 Korrik 2019 dhe 18 Korrik 2019 lidhur me segmentet rrugore Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë. Por, ndryshimi i segmenteve rrugore, pjesë përbërëse e Termave të Referencës, ka ndodhur në procesin e lidhjes së kontratës. Gjithashtu, në momentin e nënshkrimit të kontratës ndërmjet

FSHZH dhe “Ep. Ser. de Ing.” s.l. datë 17.04.2020 është përcaktuar “Rindërtimi i 3 segmenteve rrugore, nga ku 2 prej tyre Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Bënc janë të vendosura në territorin e bashkive Vlorë dhe Tepelenë, dhe një segment i tretë i papërcaktuar”.

Në datën 03 Mars 2020, nga ana e FSHZH, është kërkuar negocimi për lidhjen e kontratës “Shërbimi i Supervizionit për rikonstrukcionin e rrugëve (afërsisht 45 km)”, Ref.Nr. RLRCP/1/1.6/2018 me kandidatin potencial të radhës së dytë “Ep. Ser. de Ing.” s.l.

Në Minutat e Takimit, “Pjesa Teknike” pika 2, datë 06 Mars 2020, është vendosur për ndryshimin e segmenteve rrugore, në të cilin është hequr segmenti Qafë Thorë-Theth dhe në vend të tij është vendosur segmenti Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë.

Në Udhëzimin e Prokurimeve të Bankës Botërore, Prill 2018, botimi i pare, Seksioni IV, pika 6 “Lidhja e Kontratës”, nuk është parashikuar ndryshim i termave të referencës në këtë hap të procesit të prokurimit, por vetëm njoftimi i qëllimit të lidhjes, i cili përfshin periudhën e pauzës së procesit për ankimet e mundshme, përfundimi i kësaj periudhe dhe njoftimi për lidhjen e kontratës. Për sa më sipër, ndryshimi i qasjes teknike, apo ndryshimi i segmenteve rrugore në momentin e lidhjes së kontratës, ka shkaktuar deformim në procesin e prokurimit, për arsye se ndryshimi i termave të referencës, apo kushteve të kontratës kryhen përpara skadimit të afatit përfundimtar (deadline) të dorëzimit të Kërkesës për Propozim. Gjithashtu, pavarësisht nga ngjashmëria e kompleksitetit, segmentet ndryshojnë nga njëri tjetri dhe për pasojë ndryshon edhe kompozimi i stafit të ekspertëve, ditët e punës efektive të tyre, apo metodologjia e hartuar.

Ndryshimi i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës ka shkaktuar si pasojë mungesën e njohjes me ndryshimet për të gjithë konsulentët potencial pjesëmarrës në tender.

Kriteri: Udhëzimi i Bankës IBRD “Rregullat e Prokurimit”, 1 Korrik 2016, Seksioni V “Sqarime të Dokumenteve të Prokurimit”, Paragrafi 5.32 ku përcaktohet që: *Çdo modifikim për Kërkesat për Sqarim, duhet të jenë prezantuar në formën e shtojcave, të cilat duhet të bëhen me shkrim. Nëse është e domosdoshme, afatet për dorëzimin e propozimeve do të jenë shtyrë.*

Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, ku përcaktohet që: *Negotiatat përfshijnë diskutimet për TOR, metodologjinë e propozuar, të dhënat e klientit, kushtet e veçanta të kontratës, dhe finalizimit të “Përshkrimeve të Shërbimeve” pjesë e kontratës. Këto diskutime nuk duhet të ndryshojnë në thelb fushëveprimin në origjinë të shërbimeve sipas TOR ose kushtet e kontratës, cilësinë e produktit final, çmimin e saj, ose të jetë prekur rëndësie e vlerësimit fillestar.*

Pika 13, paragraf 13.1.1 dhe 13.1.2 “Sqarime dhe ndryshime të Kërkesës për Propozim”, Seksioni 2 “Instruksionet për Konsulentët” (ITC), ku përcaktohet që: *Në çdo kohë përpara skadimit të dorëzimit të propozimit, klienti (huamarrësi) mund të ndryshojë Kërkesën për Propozim duke nxjerrë ndryshimin me shkrim ose mënyrën standard elektronike. Ndryshimi do të jetë dërguar për të gjithë konsulentët e shortlist dhe do të jetë detyrues për to. Në qoftë se ndryshimi është thelbësor, klienti mund të shtyjë afatin e dorëzimit të propozimit për tu dhënë kohën e arsyeshme konsulentëve për të marrë parasysh ndryshimin në propozimin e tyre.*

Seksioni IV “Procesi i Prokurimit”, pika 6 Lidhja e Kontratës në Udhëzimin e Prokurimit të Bankës IBRD Prill 2018 botim i pare, ku përcaktohet që: *Në vijim të vendimit për lidhjen e kontratës me propozuesin me më shumë avantazhe, huamarrësi duhet të dërgojë me shkrim njoftimin e qëllimit të tij për të gjithë propozuesit e tjerë për lidhjen e kontratës. Kjo është quajtur Njoftimi i Qëllimit të Lidhjes së Kontratës. Njoftimi duhet të dërgohet të gjithë propozuesve në të njëjtën kohë dhe me mënyrën më shpejtë të mundshme. Dërgimi i Njoftimi i Qëllimit të Lidhjes së Kontratës inicion Periudhën e Pauzës për Ankimimin (Standstill Period).*

Ndikimi/Efekti: Ndryshimi i termave të referencës në kundërshtim me procesin e prokurimit.

Shkaku: Nuk është zbatuar kuadri rregullator dhe ligjor. Mungesa e koordinimit lidhur me aktivitetet e projektit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve, pjesë e prokurimit të kontratave për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”. Gjithashtu, kompozimi i Komisioni të Vlerësimit për prokurimin e projekteve të huaja duhet ti shërbejë forcimit të objektivitetit të vlerësimit, duke përfshirë punonjës të dedikuar me qëllim rritjen e llogaridhënies edhe gjatë procesit të prokurimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z.E.O. me detyrë Drejtor i Departamentit të Projekteve në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit
- 2) Z.D. M. me detyrë specialist në Njesinë e Zbatimit, Departamenti i Infrastrukturës, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit.
- 3) Z.L. M. me detyrë P/Njësine e Zbatimit të Projektit Utilitare, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit.

2.3.8- Procedura e prokurimit për Kontratën RLRC/1/1.1/2018: “Për rikonstruksionin e rrugës “Qafë Thorë-Theth”, Bashkia Shkodër.

Nga auditimi rezultoi se procedura e “Rikonstruksioni i rrugës “Qafë Thorë-Theth” RLRC/1/1.1/2018 është kryer në përputhje me kuadrin rregullator dhe ligjor.

Për më tepër shih Aneks 3.4 të këtij Raportit Përfundimtar

2.3.9- Procedura e prokurimit për kontratën “Rehabilitimi i rrugës Vlorë-Orikum” 10.6km EBRD/RLRC/W/2020/1.

Nga auditimi rezultoi se procedura e “Rikonstruksioni i rrugës “Vlorë-Orikum” EBRD/RLRC/W/2020/1 është kryer në përputhje me kuadrin rregullator dhe ligjor.

Për më tepër shih Aneks 3.4 të këtij Raportit Përfundimtar.

2.3.10- Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dosja e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht”;
- Dokumentacioni i subjektit fitues;
- Korrespondenca zyrtare me Bankën Botërore.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e prokurimit për kontratën e rikonstruksionit të rrugës Pogradec-Tushemisht ka qenë “Tender i hapur” duke përdorur Kërkesën për Tenderim (RFB) (Punime të Vogla, Proces Tenderimi me dy Zarfa) për të cilin kanë shprehur interes 29 OE duke paguar tarifën e blerjes së dokumentacionin për procedurën e prokurimit e cila ka pasur një vlerë 200 Euro të parimbursueshme.

Të dhënat e procedurës së tenderimit janë si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i rrugës Pogradec- Tushemisht Nr.RLRC/1.1.2/2018		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 2 dt17.10.2018 për krijimin e komisionit të fondit limit dhe specifikimet teknike. Nr.8/1 datë 11.09.2019 për prokurimin	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit A. L., E. Xh., M. Xh. - Njësia e Prokurimit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Sipas Urdhrit, 2/1, datë 04.12.2018 (i ndryshuar) 1. E. O. (Kryetar) 2. D. M. (Anëtar)

2. Procedura e Prokurimit Procedura e hapur sipas rregullores se Prokurimit te Bankes Boterore per Huamarresit e FP1, 1.07 2016	Njësia Juridike dhe Prokurimit të FSHZH.	3. Leonard Miloti (Anëtar)
5.Fondi Limit (me tvsh) 620,730,680 Lekë	6.Oferta fituese (me tvsh) 377,388,382 Lekë	7.Diferenca me fondin limit (me tvsh) 243,342,298 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 22 Janar 2019 ora 11:00	9.Burimi Financimit Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim IBRD	10.Operatoret Ekonomike a)Shprehje Interesi dhe blere dokumentat 29 OE b)Pjesëmarrës në tende10 OE dhe BOE c)S'kualifikuar 1 d) Kualifikuar 9
b. Zbatimi i Kontratës		
11.Lidhja e kontratës JV "A....." shpk &'G L" SHPK Nr.RLRCP 1/1.2/2018, date 27.05.2019	12.Vlera e kontratës (me tvsh) 377,388,382Lekë	13.Likuiduar deri datë 31.12.2020 Vlera 336,407,923.30Lekë

Në mënyrë kronologjike hapat e procedurës janë sa vijon:

Me urdhrin nr. 2, datë 17.10.2018 është krijuar Komisioni për hartimin e fondit limit dhe të specifikimeve teknike, i cili me datë 27.11.2018 i ka paraqitur Njesisë së Prokurimit fondin limit, si dhe specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit. Dokumentet e tenderit kanë marrë miratimin e Bankës më datë 04.12.2018. Ftesa për tender është publikuar më datën 04.12.2018 në website-in e Bankës, në sitin e FSHZH, në STEP dhe në dy gazeta. Afati për dorëzimin e aplikimeve ishte data 22 Janar 2019, ora 11⁰⁰.

Në datën e hapjes së tenderit, më 22.01.2019 kanë marrë pjesë dhe dorëzuar ofertë 10 subjekte, si më poshtë:

Nr.	EMRI I SUBJEKTIT	Statusi
1.	B. "A....." shpk & "Ga. L." shpk	Kualifikuar
2.	"Alb." shpk	Kualifikuar
3.	BOE "EUR. HO." shpk & "N.N.T.SH. "DR. COM." shpk	S'kualifikuar
4.	BOE "Fa. Ka. JS. Sk." & "C. Eng. MA. JSC Skopje"	Kualifikuar
5.	BOE "G..... Com." shpk & "Gj." shpk	Kualifikuar
6.	"G..... Kon." sha	Kualifikuar
7.	P.-V.-K." shpk	Kualifikuar
8.	"R. AL – T. Con. Est."	Kualifikuar
9.	S. shpk	Kualifikuar
10.	BOE "V. H." shpk & "C." shpk	Kualifikuar

Ofertuesit e mëposhtëm i përgjigjen të gjitha kërkesave dhe janë kualifikuar:

Nr.	OE/BOE	Shteti	Vlera e Ofertes me TVSH	Vlera e Ofertes me TVSH me zbritje
1	BOE "A..." shpk & "G. L." shpk	Shqiperi	314,490,318	377,388,382
2	"Al." shpk	Shqiperi	536,299,383	618,021,194
3	BOE "Fa. K. JSC Skopje" & "Civil Eng. MAC. JS. Skopje"	Maqedoni	495,998,908	595,198,690
4	BOE "G..... Com." shpk & "G....." shpk	Shqiperi	373,606,981	448,328,378
5	"G. Kon." sha	Shqiperi	477,252,149	572,702,578
6	"P.....K" shpk	Shqiperi	512,758,056	615,309,668
7	"R. AL – T. Con. Esta."	Shqiperi	359,400,307	431,280,369
8	S. shpk	Shqiperi	326,372,893	376,105,906
9	BOE "V. H." shpk & "C." shpk	Shqiperi	374,007,474	448,808.969

Më datë 16.04.2019 është bërë vlerësimi I ofertave dhe më datë 18.04.2019 janë njoftuar OE për klasifikimin e tyre.

Oferta e dhënë nga BOE “A....” shpk & “G. L.” shpk është 377,388,382 lekë me TVSH, ose me një diferencë prej **243,342,298 lekë**, krahasuar me fondin limit me TVSH, ose është 48.4% më e ulët.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion dhe analizimi i propozimeve financiare rezulton se oferta e BOE “A.....” shpk & “G. L.” shpk të jetë anomalisht e ulët në krahasim me koston e planifikuar dhe me ofertat e ofertuesve të kualifikuar.

Referuar dokumentave standard të tenderit, seksioni III Metodologjia e Vlerësimit, paragrafi 9, Ofertë Anomalisht e Ulët ose jo e balancuar specifikohet:

Nëse si pas opinionit të Klientit, Oferta që rezulton më e favorshme ekonomikisht, është seriozisht e pa balancuar e fryrë ose anomalisht e ulët, Klienti mund ti kërkojë pjesëmarrësit të dorëzojë analizë të detajuar të çmimeve për ndonjë ose të gjitha zërat të tabelës së çmimeve, dhe evidencë plotësuese, për të dëshmuar qëndrueshmërinë e atyre çmimeve me informacionin e paraqitur në ofertën e tij.

Pas vlerësimit të analizës së çmimeve, dhe duke mbajtur në konsideratë cash-flow e parashikuar të kontratës, në rastin kur Klienti vazhdon të konsiderojë ofertën të pa balancuar, ai do të sqarojë dyshimet e tij me pjesëmarrësin me shkrim.

Në rastin kur Pjesëmarrësi nuk është në gjendje të justifikojë kapacitetin e tij për të përmbushur kontratën me çmimin e ofruar, oferta do të refuzohet.

Në gjykimin e grupit të auditimit oferta e BOE “A.....” shpk & “G. L.” shpk është anomalisht e ulët. Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues apo analize të detajuar për të mbështetur ofertën e OE, përpara se të merrte vendim për kualifikimin e tij. Më datë 09.05.2019 është bërë njoftimi i kontratës (letter of acceptance) dhe me datë 20.05.2009, pas paraqitjes së garancisë së kontratës nga BOE “A.....” shpk & “G. L.” shpk. Publikimi i kontratës është bërë më datë 20.05.2019. Kontrata “Rehabilitimi i rrugës “Pogradec-Tushemisht” Nr.RL.CP1/1.2/2018, datë 27.05.2019 është lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE “A.....” shpk & “G. L.” shpk me afat zbatimi 8 muaj.

2.3.6 Titulli i gjetjes: Ofertë anomalish e Ulët.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht” rezulton se oferta e dhënë nga BOE fitues “A.....” shpk & “G. L.” shpk me vlerë 377,388,382 lekë me TVSH është 243,342,298 lekë më e ulët se vlera e fondit limit ose 40% me e ulët. Në gjykimin e grupit të auditimit oferta vlerësohet si anomalish e ulët në krahasim me koston e planifikuar dhe me ofertat e ofertuesve të kualifikuar si dhe krahasimet e çmimeve të dhëna me manualët e miratuar. Gjithashtu, Rregullat e Prokurimit të BERZH-it nuk parashikojnë një formulë për përcaktimin e vlerës së ofertës anomalisht të ulët dhe nga KVO nuk kemi asnjë sqarim apo dokumentim për mënyrën e gjykitimit dhe të kualifikimit të ofertave në këto raste. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të kësaj procedure nuk ka bërë një analize dhe nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues apo analizë të detajuar për të mbështetur ofertën e OE, përpara se të merrte vendim për kualifikimin e tij duke ju referur metodologjisë së vlerësimit.

Kriteri: Dokumentet Standard të Tenderit, seksioni III Metodologjia e Vlerësimit, paragrafi 9 Ofertë Anomalisht e Ulët ose jo e balancuar. “Nëse sipas opinionit të Klientit, Oferta që rezulton më e favorshme ekonomikisht, është seriozisht e pa balancuar e fryrë ose anomalisht e ulët, Klienti mund ti kërkojë pjesëmarrësit të dorëzojë analize të detajuar të çmimeve për ndonjë ose të gjitha

zërat te tabelës se çmimeve, dhe evidence plotësuese, për te dëshmuar qëndrueshmërinë e atyre çmimeve me informacionin e paraqitur ne ofertën e tij. Pas vlerësimit të analizës së çmimeve, dhe duke mbajtur në konsideratë cash-flow e parashikuar të kontratës, në rastin kur Klienti vazhdon të konsiderojë ofertën të pa balancuar, ai do të sqarojë dyshimet e tij me pjesëmarrësin me shkrim. Në rastin kur Pjesëmarrësi nuk është në gjendje të justifikojë kapacitetin e tij për te përmbushur kontratën me çmimin e ofruar, oferta do të refuzohet”.

Ndikimi/Efekti: Risk për përfundimin në kohe dhe në cilësi e projektit.

Shkak: Mos analizimi i ofertës fituese.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa që të analizojë ofertat e OE, dhe në rastet kur ato janë anomalish të ulta të kërkojë dokumentacion justifikues shtesë dhe analizë të detajuar të çmimeve, përpara se të marrë vendim për kualifikimin.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO, z.E. O., z.D.M. dhe z.L. M..

2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Auditimi u bazua në dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ligji nr. 54/2018, datë 23.07.2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale”;
- Ligji nr. 44/2020, datë 23.04.2020 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”;
- Marrëveshja me Bankën Botërore Nr. 8850 AL, nënshkruar më datë 05.06.2018;
- Marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim nënshkruar më 10.02.2020;
- Programimi dhe realizimi i buxhetit të projektit, si dhe veprimet ekonomike të kryera nga FSHZH sipas komponentëve të marrëveshjes;
- Raportimet periodike të FSHZH në Bankën Botërore;
- Raportimet periodike të FSHZH në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë;
- Pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe raporti i audituesit ligjor, si dhe Pasqyrat Financiare të vitit 2020.

I. Buxheti dhe realizimi për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale

Projekti i Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale është planifikuar dhe miratuar në buxhet sipas konfirmimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përkatësisht, për vitin 2019 me shkresën nr. 22760/280, datë 11.02.2019 me subjekt “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2019-2021” në zbatim të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, ndërsa për vitin 2020 me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 2169/19, datë 26.02.2020 me subjekt “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2020 – 2022, për shpenzimet kapitale” në zbatim të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”. Gjatë periudhës nën auditim janë bërë ndryshime në buxhet, duke e rritur atë me 17.7% në vitin 2019 dhe me 2.3 herë në vitin 2020. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për këtë projekt, për vitet 2019 dhe 2020, pasqyrohet si më poshtë.

Viti	Buxheti Fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizuar në fakt	Në %
2019	557,172,000	655,574,614	342,342,216	52.2
2020	400,000,000	950,000,000	945,471,837	99.5

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se, pavarësisht nga rishikimi me rritje i buxhetit të projektit, realizimi për vitin 2019 është në masën 52.2 %, që ka ardhur dhe nga vonesat në tenderim, ndërsa

për vitin 2020 realizimi kundrejt buxhetit të rishikuar është në masën 99.5 %, ose është realizuar pothuajse plotësisht.

A. Marrëveshja me Nr. 8850 AL, nënshkruar më datë 05.06.2018 midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore për Projektin e “Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale”, ratifikuar në Parlament me ligjin nr. 54/2018, datë 23.07.2018 botuar në fletoren zyrtare nr. 116 të vitit 2018, është bërë efektive më datë 30.08.2018, konfirmuar me shkresën e Bankës Botërore të datës 30.08.2018. Vlera e Marrëveshjes është 50,000,000 USD, përfshirë dhe taksat, me afat zbatimi data 31.12.2022, me afat të shlyerjes së kredisë deri në vitin 2047, duke filluar në vitin 2024 me nga dy këste 6 mujore.

Marrëveshja e detajuar në kategoritë përkatëse paraqitet sipas tabelës së më poshtme:

Kategoria	Shuma e Huas së alokuar në USD	Shpenzimet që do të financohet (përfshirë taksat) në %
(1) Mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente	45,025,000	100
(2) Shërbimet e konsulencës	2,850,000	100
(3) Kostot operative dhe trajnimi	125,000	100
(4) Tarifa e parapagimit	125,000	Paguhet në bazë të Seksionit 2.03 të Marrëveshjes
TOTALI	50,000,000	

Konstatohet se deri me 31.12.2020 janë disbursuar nga donatori 16,422,679 USD, referuar aplikimeve si më poshtë:

Aplikime	Datë	Shuma USD
WA 1	25.06.2019	1,136,250.00
WA 2	13.08.2019	1,365,293.36
WA 3	05.11.2019	13,796,135.65
Tarifa e parapagimit		125,000.00
Totali		16,422,679.01

Sa më lart konstatohet se deri më 31.12.2020 është disbursuar 32.8% e kredisë së akorduar, ndërsa përdorimi i kredisë dhe shkalla e realizimit deri më 31.12.2020 paraqitet si më poshtë:

Kategoria	Shuma e huasë në USD	Realizimi deri më 31.12.2020	Realizimi në %
(1) Mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente	45,025,000.00	10,762,791.00	24
(2) shërbimet e konsulencës/D&S	2,850,000.00	610,489.00	21
(3) Kosto operative dhe trajnim	2,000,000.00	311,640.00	16
(4) Tarifa e parapagimit	125,000.00	125,000.00	100
Total	50,000,000.00	11,809,920.00	24

Në kategorinë “**Punime**” janë në zbatim 4 kontrata, nga të cilat dy janë lidhur në monedhën Lekë dhe dy në monedhën USD si më poshtë:

- Kontratat në Lekë

Objekti kontratës	Kontraktori	Vlera kontraktuar	Vlera e paguar 31.12.2020
Rikonstruktion i rrugës Qafë Thorë - Theth", Shkoder"	J.G.....CO. & G.J.	736,302,708.00	490,200,540.60
Rikonstruktion i rrugës Pogradec-Tushemisht""	J. A..... & G. L.	377,388,382.00	336,407,923.30
Totali		1,113,691,090.00	826,608,463.90

- Kontratat në USD

Objekti kontratës	Kontraktori	Vlera e kontraktuar	Vlera e paguar 31.12.2020
Rikonstruksion i Rrugës Lekdush-Bënçë-Tepelenë, Loti 2	C. O.	2,474,793.00	926,830.60
Rikonstruksion i Rrugës Gusmar-Kuc"	R.-A. CO. ES.	5,780,441.00	2,464,152.50
Totali		8,255,234.00	3,390,983.10

Në kategorinë **“Shërbimet e konsulencës/D&S”** janë në zbatim 3 kontrata nga të cilat një është lidhur në monedhën Lekë dhe dy në monedhën USD si më poshtë:

- Kontrata mbikëqyrje në USD

Objekti kontratës	Kontraktori	Vlera e kontraktuar	Vlera e paguar 31.12.2020
Shërbimet e mbikëqyrjes për rindërtimin e rrugëve (afërsisht 45 km)	Ep. Ser. de Ing. SL	816,024	186,304
Shërbime këshillimi për identifikimin dhe mbikëqyrjen e ndërhyrjeve të mundshme të sigurisë rrugore dhe inspektimeve të sigurisë rrugore	J. F. Eng. & Inf.	199.980	93.840
Totali		1,016,004	280,144

- Kontrata mbikëqyrje në Lekë:

Objekti kontratës	Kontraktori	Vlera e kontraktuar	Vlera e paguar 31.12.2020
Mbikëqyrje punime të rikonstruksionit të rrugës Qafë Thorë -Theth, Shkodër	T.....Con	39,588,000	37,158,000
Totali		39,588,000	37,158,000

Shpenzimet për kategorinë (3) **“Kosto operative dhe trajnim”** për vitin 2019 - 2020 janë në vlerën 311,640 USD ku përfshihen shpenzime për paga, kancelari, energji elektrike, telefon, mirëmbajtje godine, pajisje zyre, etj.

B. Projekti i Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në kuadër të programit të Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale krahas financuesit Banka Botërore, me ligjin nr. 44/2020, datë 23.04.2020 është nënshkruar edhe **Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**. Vlera e Marrëveshjes është 50,000,000 USD pa përfshirë taksat, e detajuar në kategoritë përkatëse sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Huaja e shpërndarë në valutë(USD)	% e shpenzimeve që do të financohen
Punime për Pjesën A dhe Pjesën B të Projektit	38,300,000	100% e vlerës së kontratës duke përfshirë të gjitha taksat
(2) Shërbimet e mbikëqyrjes së punimeve për Pjesën A dhe B	1,200,000	100% e vlerës së kontratës duke përfshirë të gjitha taksat
(3) Punimet për Pjesën D të projektit	9,700,000	100
(4) Shërbimet e mbikëqyrjes së punimeve për Pjesën D	300,000	100
(5)Komision paraprak	500,000	100
Shuma	50,000,000	

Aktualisht në kuadër të kësaj marrëveshje janë nënshkruar dy kontrata punimesh dhe një kontratë supervizimi, për të cilat deri në momentin e auditimit nuk ka ende pagesa, si më poshtë:

- Në kategorinë **“Punime”** janë lidhur dy kontrata në monedhën USD si më poshtë:

Objekti kontratës	Kontraktori	Vlera e kontraktuar	Vlera e paguar 31.12.2020
Rehabilitimi i rrugës ‘Shëngjin-Baks- Rrjoll’ (13km)	G.....	15,001,026	0
Rehabilitimi i rrugës “Vlorë- Orikum”(10.6km)	AV.	8,759,171	0
Totali		23,760,196	0

- Në kategorinë **“Shërbimet e mbikëqyrjes”** është lidhur një kontratë në monedhën USD si më poshtë:

Objekti kontratës	Kontraktori	Vlera e kontraktuar	Vlera e paguar 31.12.2020
Mbikëqyrje e rehabilitimit të tre seksioneve të rrugëve nacionale: rruga “Vlorë-Orikum”(10.6km) dhe rruga ‘Shëngjin-Baks- Rrjoll’ (13km)	J. P. & ER. G	986,160	0
Totali		986,160	0

II. Raportimet në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë

Në zbatim të VKM nr. 116, datë 24.02.1997 “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, livrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve ndërkombëtare”, FSHZH ka raportuar rregullisht çdo datë 5 të muajit pasardhës në MFE lidhur me disbursimet dhe përdorimin e fondeve për çdo program.

III. Raportimet në Bankën Botërore

Në zbatim të Marrëveshjes së kredisë, Seksioni II, FSHZH, çdo 3 muaj ka raportuar në Bankën Botërore Interim Financial Report (IFR) lidhur me disbursimet dhe përdorimin e fondeve, raportim i përgatitur sipas formatit të miratuar nga Banka Botërore dhe i dërguar në mënyrë elektronike.

IV. Auditimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare të projektit janë subjekt i auditimit të jashtëm. Ky proces për vitin ushtrimor 2019, është kryer nga kompania “Gr. Tho.” e përzgjedhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Raporti i Auditimit i është përcjellë donatorit me shkresën e FSHZH nr. 1574, datë 23.04.2021.

Gjithashtu, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka përcjellë pranë MFE shkresën me nr. 7985, datë 24.02.2021 me kërkesën dhe Termat e Referencës për kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2020.

Mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, FSHZH ka përgatitur dhe dorëzuar pranë MFE Pasqyrat Financiare të institucionit për vitin ushtrimor 2020.

2.5 Mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile.

Gjatë periudhës objekt auditimi, sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se në total janë lidhur 6 (gjashtë) kontrata për ndërtim punimesh civile dhe 4 (katër) kontrata për shërbim konsulence. Kontratat e financuara nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim që janë në proces, tregohen në tabelën më poshtë:

KONTRATAT E PUNIMEVE CIVILE						
Nr.	Objekti i Kontratës	OE/BOE	Vlera e Kontratës (me TVSH)	Data e lidhjes së Kontratës	Afati	Statusi
<u>1</u>	Rikonstruksion i Rrugës Lekdush-Bënç-Tepelene Loti 2	C. O.	2,474,793 US \$	30.12.2019	12 muaj	Në proces
<u>2</u>	Rikonstruksion i rrugës Gusmar-Kuc	Ra.AL-T. Con. Est	5,780,441 US \$	03.12.2019	12 muaj	Në proces
<u>3</u>	Rindërtim i rrugës Qafe Thore -Theth	"G..... C....." & "GJ....."	736,302,708 Lekë	08.07.2019	10 muaj	Pezulluar
<u>4</u>	Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht	A..... & G. L.	377,388,382 Lekë	06.02.2019	8 muaj + 8 javë shtesë	Përfunduar, në periudhën e garancisë
KONTRATAT E KONSULENCËS/SUPERVIZIMIT						
<u>1</u>	Shërbime konsulence për objektin Pogradec-Tushemisht dhe Qafe Thore-Theth	T.....CON.	39,588,000 Lekë	08.07.2019	Sipas punimeve	Në proces
<u>2</u>	Shërbime të supervizionit për rikonstruksionin e rrugëve, afërsisht 45 km	EP.SER.DE.ING.S.	816,024 US \$	17.04.2020	Sipas punimeve	Në proces

Për periudhën objekt auditimi, në drejtim të zbatimit të punimeve civile, u audituan kontratat e financuara nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, punimet e të cilave janë në proces. Konkretisht, kontrata me objekt “Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht” e cila ka përfunduar dhe është në fazën e garancisë së punimeve dhe kontrata me objekt “Rindërtim i rrugës Qafe Thore –Theth” e cila është në proces por punimet janë pezulluar për shkak të kushteve atmosferike e në këto kushte nuk ishte e mundur verifikimi i tyre në terren. Për kontratat me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Lekdush-Bënç-Tepelene” Loti 2 dhe “Rikonstruksion i rrugës Gusmar-Kuc” nga vizita në terren u konstatua se punimet të kryera nga fundi i periudhës së audituar deri në fund të periudhës së auditimit kanë bërë progres dhe nuk mund të bëhet një vlerësim i drejtë i tyre, për këtë auditimi i tyre do të kryhet në një fazë tjetër.

2.5.1 Mbi zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile, Projekti “Rikonstruksion i Rrugës Gusmar-Kuc”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis FSHZH dhe OE “Ra. AL – T. Con. Es.”
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built);
- Pagesat pjesore nga Situacioni (IPC)
- Librezat e masave (Measurement Sheets);
- Praktikant e Urdhër Ndryshimeve

- *Korrespondencat mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe Kompanisë konsulente që kryen supervizionimin OE ‘Ep.S. de Ing.sl’.*

Projekti “*Rikonstruksion i rrugës Gusmar-kuç*”, përfshin segmentin rrugor i cili fillon në dalje të fshatit Kuç dhe përfundon në fshatin Gusmar me një gjerësi të gjurmës kaluese 4m dhe me bankine 2x0.75m, dhe vend nderimet për automjetet çdo 250m me gjerësi 2m dhe gjatësi 4m.

Rruga është parashikuar me pjerrësi tërthore të njëanshme prej $i=2.5\%$ në rrugë të drejtë dhe $i=6\%$ në kthesa. Grumbullimi dhe i disiplinimi i ujërave është realizuar me anë të kunetave në krah të skarpatës dhe shkarkimi nëpër puseta me tombino. Përgjatë gjithë segmentit rrugor në studim janë përdorur profile të ndryshme rrugësh sipas rrethanave të saj. Për këtë arsye e gjithë rruga trajtohet e përberë nga disa segmente rrugore me karakteristika të ndryshme. Punimet e projektit në tërësi konsistojnë: gjermime për trasenë; trotuar bordura, kuneta kanalizime, ura, mure mbajtës dhe pritës, tombino drejtkëndore dhe sinjalistika.

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE “Ra. AL – T. Con. Es.” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 1752 datë 03.12.2019 mes këtij OE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me objekt ‘*Rindërtimi i rrugës Gusmar-Kuçit*’ me vlerë të kontratës 5,780,441 \$ lekë me TVSh, me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj nga data e fillimit të punimeve si dhe me afat të garancisë së punimeve 18 muaj.

Për të mbikëqyrur këto punime është shpallur fitues operatori “*Ep. Se. de Ing. sl*” me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit në datë 17.04.2020 mes këtij operatori dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë të kontratës **1,986,300 euro pa TVSh ose 2,383,560 euro me TVSH**, me afat të zbatimit të kontratës 48 muaj nga data e fillimit të shërbimit të konsulencës. Sipas kësaj kontrate konsulenti do të kryej supervizionimin dhe konsulencë teknike për të tre lotet e projektit.

Punimet për Rindërtimin e rrugës Gusmar-Kuç kanë filluar më 30.04.2020. Në fund të muajit Dhjetor 2020, kontraktori ka kryer 55.38 % të punimeve, me një rënie të progresit prej 15.38 %, krahasuar me progresin fizik të planifikuar për këtë periudhë që ka qenë 70.76 %. Progresi fizik në Dhjetor të 2020 ka qenë 4.17 %, shumë më i ulët se përqindja e planifikuar prej 9.03 % dhe kjo rënie referuar raportimeve të mbikëqyrësit ka ardhur kryesisht për pasojë e ndryshimit të derivuar nga Urdhrit të Ndryshimit Nr. 1 sipas të cilit bëhet modifikimi i segmentit të rrugës nga km 0+700 në km 2+100. Ndërmjet këtij Urdhër Ndryshimi shkurtohet gjatësia e rrugës me 126 m, anulohet ndërtimi i dy urave në segmentet km 0+823 dhe km 1+540, dhe segmenti rrugor lëvizet në drejtim të shpatit. Nga pikëpamja financiare ky Urdhër Ndryshim kursen nga kontrata fillestare 5,313.28\$. Deri në fund të muajit Dhjetor është disbursuar vlera 2,741,607.48 \$ ose 47.43 % e vlerës së kontratës.

N	Përshkrimi i punimeve	Preventivi (US\$ pa TVSH)			Realizuar në (US \$ pa TVSH)	Realizimi %
		Kontrate	Rishikuar VO.1	Diferenca		
1	Punime e prishjes dhe punime mbushje gjermimi	1,632,051.40	1,997,855.87	365,804	1,248,369.13	34.39
2	Punime për shtresat rrugore, bordura, kanalizime	198,172.00	198,172.00	0.00		0
3	Vepra Arti	1,736,762.50	1,614,609.38	-122,153	632,153.12	18.86
4	Vepra të tjera Arti	796,681.70	547,717.00	-248,964	373,189.60	27.76
5	Punime sinjalistikë	223,984.00	223,984.00	0.00		0
Totali		4,587,651.60	4,582,338.25	-5,313.35	2,253,711.85	47.43
Fondi rezervë 5%		229,382				
Totali		4,817,038.18				

Gjatë auditimit konstatohet se Leja e Ndërtimit për këtë objekt është miratuar me kusht. Vendimi Nr. 5 datë 28.02.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit vendos miratimin me kusht të lejes së ndërtimit të infrastrukturës ‘Rikonstruksioni i segmentit të Rrugës Gusmar-Kuç’ me vendndodhjen në Bashkinë Tepelenë dhe Himarë, me zhvillues Bashkinë Tepelenë dhe Bashkinë Himarë duke

specifikuar në piken 3:

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit vetëm pas plotësimit të dokumentacionit ligjor.

Referuar ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 ‘Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’ neni 27 dhe 28, dhe VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 ‘Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit’ të ndryshuar me VKM Nr. 231, datë 21.3.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar neni 25 pika 11 dhe 13 specifikohet:

11. Brenda 90 ditëve, nga marrja e njoftimit për miratimin e lejes së ndërtimit, nëpërmjet sistemit elektronik të lejes, kërkuesi duhet të ngarkojë aktet që provojnë pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara në vendim, në rastin e vendimit të miratimit me kusht."

13. Në rast se aplikuesi nuk plotëson kushtet e përcaktuara në vendimin e KKT-së, sipas pikës 11, të këtij vendimi, sekretariati lëshon dokumentin e refuzimit të lejes së ndërtimit.

Për sa më sipër rezulton se OE “Ra. AL – T.Con. Es.” Nuk është pajisur me Dokument të Lejes së Ndërtimit. Në dispozicion të grupit të auditimit është vendosur vetëm Vendimi i miratimit me kusht.

2.5.1 Titulli i gjetjes: Zbatim i punimeve civile pa miratimin e lejes së ndërtimit përfundimtare.

Situata: Në zbatimin e kontratës “Rikonstruksion i rrugës Gusmar-Kuç” konstatohet se referuar Vendimit Nr. 5 datë 28.02.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit i cili vendos miratimin me kusht të lejes së ndërtimit të infrastrukturës ‘Rikonstruksioni i segmentit të Rrugës Gusmar-Kuç’ me vendndodhjen në Bashkinë Tepelenë dhe Himarë, me zhvillues Bashkinë Tepelenë dhe Bashkinë Himarë, subjekti nuk rezulton të jetë pajisur me Dokumentin e Lejes së ndërtimit.

Kriteri: Ligji Nr. 107 datë 31.07.2014 ‘Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’ neni 27 dhe 28, dhe VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 ‘Për Miratimin E Rregullores së Zhvillimit të Territorit’ të ndryshuar, neni 25 pika 11 dhe 13, ku citohet: *11. Brenda 90 ditëve, nga marrja e njoftimit për miratimin e lejes së ndërtimit, nëpërmjet sistemit elektronik të lejes, kërkuesi duhet të ngarkojë aktet që provojnë pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara në vendim, në rastin e vendimit të miratimit me kusht."*

13. Në rast se aplikuesi nuk plotëson kushtet e përcaktuara në vendimin e KKT-së, sipas pikës 11, të këtij vendimi, sekretariati lëshon dokumentin e refuzimit të lejes së ndërtimit.

Ndikimi/Efekti: Kryerja e punimeve civile pa dokumentacionin e nevojshëm.

Shkaku: Mosplotësim i kushteve të vendosura nga Këshillit Kombëtar të Territorit.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: FSHZH dhe strukturat përkatëse, të marrin masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit, nga të gjitha palët e përfshira në projekt, për pajisjen me leje ndërtimore sipas legjislacionit në fuqi për shmangien e problematikave që mund të lindin gjatë zbatimit të punimeve.

2.5.2 Mbi zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile, për objektin **“Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht”**.

Projekti “Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht”, ka një gjatësi prej 3.6 km. Kjo është pjesë e rrugës kryesore që lidh Pogradecin me Tushemishtin dhe me pikën kufitare të Maqedonisë. Investimi në këtë rrugë që është në linjën e brendshme të liqenit krijon mundësinë e ri-konceptimit si hapësirë e madhe publike e vijës së bregut të liqenit nga Pogradeci në Drilon. Rruga do të ketë dy korsi me gjerësi 3.25 m secila për kalimin e mjeteve, bankina nga të dy anët nga 1 m, korsi biçikletash në një anë me gjerësi 1.95 m dhe trotuar në një anë me gjerësi 1.85 m. Punimet e

projektit në tërësi konsistojnë: zgjerimin e rrugës ekzistuese; mure mbajtës dhe tombino katrore e rrethore; trotuare dhe korsi biçikletash; rehabilitim i infrastrukturës nëntokësorë (kanalizime, telefoni dhe fibra optike, ujësjellës, drenazhime për ujërat e shiut, pusetat e nevojshme); sinjalistika; punime gjelbërimi.

Për zbatimin e punimeve civile midis FSHZH dhe BOE A.....” shpk & “G. L.” shpk është lidhur kontrata, referencë RLRC/1/1.2/2018 datë 27.05.2019 me vlerë **314,490,318 lekë pa TVSH** ose **377,388,382 Lekë me TVSH** me afat përfundimi të punimeve 248 ditë nga data e fillimit të tyre kjo sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës pika 1.1.3.3 dhe me periudhë garancie të tyre 18 muaj, Kushtet e Veçanta të Kontratës pika 1.1.3.7. Zbatimi i punimeve civile ka filluar më datë 20.06.2019 dhe ka përfunduar më datë 05.08.2020 kjo sipas certifikatës së marrjes në dorëzim të punimeve, pjesore, datë 23.10.2020.

Mbikëqyrja e punimeve për projektin “*Rikonstruktion i Rrugës Pogradec-Tushemisht*” kryhet nga OE “T..... C.....” shpk sipas kontratës të lidhur me FSHZH, referencë RLCP/1/1.5/2018 datë 27.05.2019, me vlerë **17,800,000 lekë pa TVSH** ose **21,360,000 Lekë me TVSH** me kohëzgjatje deri në përfundim të garancisë së punimeve. Deri në fund të periudhës së audituar, 31.12.2020, vlera e disbursuar për supervizionimin e kontratës së zbatimit të punimeve civile është 17,800,000 lekë me TVSH.

Nga auditimi rezultuan diferenca në volume punimesh të pa kryera dhe të dëmtuara gjatë fazës së garancisë në shumën **864,422 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

2.5.2 Titulli i gjetjes: Punime të situacionuara por të pakryera në fakt si dhe të dëmtuara gjatë periudhës së garancisë.

Situata: Për objektin “*Rikonstruktion i Rrugës Pogradec-Tushemisht*”, sipas kontratës të lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe BOE “A.....” shpk & “G. L.” shpk me referencë RLCP/1/1.2/2018 datë 27.05.2019, në lidhje me zbatimin e punimeve civile, me vlerë **314,490,318 lekë pa TVSH** ose **377,388,382 Lekë me TVSH**, me afat përfundimi të punimeve 8 muaj, konkretisht:

- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built);*
- *Pagesat pjesore nga Situacioni (IPC) nr. 1 deri situacionin (IPC) nr. 7;*
- *Librezat e masave (Measurement Sheets);*
- *Praktikat e Urdhër Ndryshimeve (Variation Order, VO nr.1 dhe VO nr.2;*
- *Korrespondencat mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe Kompanisë konsulate që kryen supervizionimin OE “Transport Highway Consulting (THC)” shpk.*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Supervisorit të punimeve rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt si dhe të dëmtuara gjatë garancisë së punimeve. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Tombinot dhe sistemi i drenimi	Shtresë zhavorr lumi t=10cm poshtë kanalit	316,643
2	Punime për trotuare	Struktura monolite betoni C 6/10, nën bordur	57,332
3	Punime për trotuar	Furnizim Vendorsje Pemë ‘Ligustër’	57,500
4	Korsi për biçikleta	Shtresë asfaltobetoni me ngjyra, 3cm, me makineri	104,000
5	Shtresat e rrugës	Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	24,000
6	Gërmime	Mbushje me material të gërmuar përhapur e ngjeshur me makineri t=20 cm(për gjelbërim)	157,392
		Mbjellje Bari në skarpata	147,555

SHUMA	864,422
-------	---------

Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Aneksin 2.5.1

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

“3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

Kontrata e shërbimit me objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht”, Nr. RLRC/1/1.5/2018 datë 27.05.2019.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën **373,975 lekë pa TVSH** si dhe punime që duhet të riparohen gjatë fazës së garancisë në shumën **472,447 lekë pa TVSH**.

Shkaku: Certifikimi nga ana e Supervizorit i volumeve të punimeve të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit si dhe punime të dëmtuara gjatë periudhës së garancisë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: FSHZH të kërkoj në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **373,975 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE “A.....” SHPK & “G. L.” SHPK, si dhe kryerjen e punime të dëmtuara brenda afatit të garancisë së tyre në shumën **472,447 lekë pa TVSH**, e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. RL.CP/1/1.2/2018 datë 27.05.2019 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Pogradec-Tushemisht”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Supervizorit/Konsulentit OE “Tr. Hi. C....” shpk z. G. B., sipas kontratës së shërbimit RL.CP/1/1.5/2018 datë 27.05.2019 me objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht”.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi Nr. 7 datë 30.04.2021 dhe për këtë çështje personi i atakuar, mbikëqyrësi i punimeve, z. G B me shkresën përcjellëse Nr.675/15Prot. datë 08.09.2021, administruar në KLSH me Nr. 254/5 datë 09.09.2021 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Zëri: Shtresë zhavorr lumi t=10cm poshtë kanalit.

Pretendimet e subjektit të audituar:

Për Zërin e Punimeve: Shtrese zhavorr lumi t=10 cm poshtë kanalit, Zëri 3.52 ne B.o.Q:

Sasia ne m2 e realizuar referuar faktit dhe e pasqyruar ne planimetrinë e As-Builtit është si me poshtë vijon: DJATHTAS: Nga Seksioni CS – 84 deri ne afërsi te seksionit 85/1 ka gjatësinë 43.1 ml ne plan dhe gjerësia mesatare është 118.53. Me te njëjtën logjikë Nga CS 90 – CS 92 ka gjatësinë 88.15 ml dhe gjerësi mesatare 253.87 ml.

CS 94 – CS 96 ka gjatësinë 60 ml dhe gjerësi mesatare 3.29 ml

CS 96 – CS 99 ka gjatësinë 67.16 dhe gjerësi mesatare 4.52 ml

CS 99 – CS 101 ka gjatësinë 35 ml dhe gjerësi mesatare 5.01 ml

CS 105 – CS 105/2 ka gjatësinë 28.83 dhe gjerësi mesatare 4.80 ml

CS 106 – CS 109 ka gjatësinë 92 ml dhe gjerësi mesatare 4.80 ml

CS 110 – ka gjatësinë 30 ml dhe gjerësi mesatare 4.23 ml

CS 112 ka gjatësinë 41.6 ml dhe gjerësinë mesatare 4.42 ml

CS 116 – CS 118 ka gjatësinë 83.9 ml dhe gjerësinë mesatare 4.08 ml

CS 120 – CS 134 ka gjatësinë 367.9 ml dhe gjerësinë mesatare 6.07 ml

CS 135 – CS 142 ka gjatësinë 206.11 ml dhe gjerësinë mesatare 6.28 ml

CS 143 – CS 145 ka gjatësinë 51.5 ml dhe gjerësinë mesatare 4.14 ml

Ne Total nëse shumëzojmë gjatësitë me gjerësinë mesatare respektive do te kemi:

118 + 253+197 + 303+175+138+441+126+183+342+2235+1295+213 = 6019 m2.

MAJTAS: Nga CS 119 – CS 145 kanali ka gjatësinë 644.5 ml dhe gjerësinë mesatare 5.93 ml e cila e konvertuar ne sipërfaqe shkon ne 3823 m2 majtas. Pra ne total për këtë zë do te kemi:

6019 m2 djathtas + 3823 m2 majtas = 9842 m2, nga 9771 m2 qe janë situacionuar dhe likuiduar ne situacionin 7. Për sa me sipër ju lutemi ri-konsideroni konstatimin tuaj.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Në observacion Ju sqaroni se si është llogaritur sasia e shtresës së zhavorrit poshtë betonit për veshjen e kanalit dhe nuk jepni prova se kjo sasi e zhavorrit është realizuar. Diferenca në këtë volum punimesh, nga grupi i auditimit është llogaritur vetëm për pjesën e pjerrët të kanalit ku shtresa e zhavorrit është e pa mundur të realizohet në trashësinë 10 cm. Mosrealizimi i shtresës së zhavorrit poshtë kanalit për pjesën e pjerrët të tij konstatohet edhe nga fotografitë e bashkëlidhura në raportet mujore të hartuara nga ana Juaj si dhe foto e paraqitura në këtë observacion nuk vërtetojnë që realizimin e kësaj shtrese.

Për sa më sipër observacioni Juaj nuk merret parasysh.

Zëri: Struktura monolite betoni C 6/10, nën bordur.

Pretendimet e subjektit të audituar:

“Konstatimi i Audituesve te KLSH qëndron, theksojmë se ka një lapsus nga ana e Kontraktorit dhe Mbikëqyrësit gjate hartimit te librezës se masave pasi nuk është evidentuar një pjese e sasisë se betonit te përdorur për te realizuar rip-rap ne hyrje dhe ne dalje te strukturave tombino tip Box Culvert me një vlere te mesatarizuar 4 (gjerësia e tombinos) x 2 (për inletin dhe outletin) x 2 m (gjerësia e mesatarizuar ne plan e inletit dhe outletit) x 3 struktura me një spesor shtrese te mesatarizuar 0.15 cm = 4x2x2x3x0.15 = 7.2 m3. Gjurmët e rip-rapit janë paraqitur ne as buit por nuk janë pasqyruar ne mënyre te qarte ne libeze.”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga ana juaj nuk janë sjell argumente dhe fakte shtesë që vërtetojnë se rip-rapet në hyrje dhe dalje të tombinove janë realizuar me beton.

Zërat: Furnizim Vendosje Pemë 'Ligustër'; Mbjellje Bari në skarpata; Shtresë asfalto betoni me ngjyra, 3cm, me makineri; Shtresë asfalto betoni me granil quri kave, 4cm, me makineri; Mbushje me material të gërmuar përhapur e ngjeshur me makineri t=20 cm(për gjelbërim)

Pretendimet e subjektit të audituar:

Për zërat e mësipërm ju sqaroni se janë kryer rregullimet nga ana e kontraktorit gjatë periudhës së garancisë duke bashkëlidhur edhe fotografi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Fotografite e paraqitura nga ana juaj nuk tregojnë qartë se këto punime janë kryer në të gjithë sipërfaqen e konstatuar nga ana jonë, kështu që observacioni juaj nuk merret në konsideratë dhe i takon strukturave të FSHZH-së të bëjë verifikimin e tyre para shlyerjes së detyrimeve finale ndaj kontraktorit.

Zërrët: F.V Ndricues rrugor Led SPINELLA 68Ë ref. Detaje teknike, 2 -Pajisje për mbrojtjen e Ndricuesve LED nga shkarkimet atmosferike dhe tensionet akumulative nga driver, 3 -F.V Shtylla me gjatësi 9.8 ml, me krah njëdegësh 2K (9m mbi toke,0.8 m nën tokë) e kompletuar me morseterin e lidhjeve dhe siguresë, e galvanizuar, me krah 0.5- 2.9 M spesor 4 mm dhe 4 -F.V Ndricues sinjalizues Led; Guardrail H 2.

Pretendimet e subjektit të audituar:

Për zërat e mësipërm ju sqaroni se janë kryer rregullimet nga ana e kontraktorit gjatë periudhës së garancisë duke bashkëlidhur edhe fotografi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Fotografite e paraqitura nga ana juaj tregojnë qartë se këto punime janë kryer dhe observacioni juaj merret në konsideratë duke u pasqyruar në Raportin Përfundimtar.

2.5.3 Mbi zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile, për Projektin “Rikonstruksion i Rrugës Qafë Thore-Theth”.

Segmenti rrugor Qafë Thore–Theth me gjatësi 16.18 km përfundon lidhjen e fshatit dhe parkut kombëtar të Thethit, një rrugë shumë e dëmtuar dhe e rrezikshme në një zonë gjithnjë e më të frekuentuar në veçanti nga turistët e huaj. Në përfundim të procedurës së prokurimit, për zbatimin e punimeve në këtë segment rrugor, është shpallur fitues BOE "G. C....." shpk & "G....." shpk me të cilin është lidhur kontrata Nr. Ref: RL.CP/1/1.1/2018 datë 08.07.2019 mes këtij bashkimi operatorësh dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me objekt “Rindërtimi i rrugës Qafë Thorë-Theth” me vlerë të kontratës 736,302,708 lekë me TVSH, me afat të zbatimit të punimeve 10 muaj nga data e fillimit të tyre si dhe me afat të garancisë së punimeve 18 muaj.

Supervizimi i rrugës Qafë Thorë-Theth ishte parashikuar të kryhej në kontratën e mbikëqyrjes me objekt “Shërbime supervizionimi për rikonstruksionin e rrugëve (afërsisht 45 km)”. Mosrealizimi i procedurës së prokurimit brenda afateve të përcaktuara ka sjell që kontratës Nr. RLRC/1/1.5/2018 datë 27.05.2019 lidhur mes operatorit “Tr. Hig. Cons.” dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë të kontratës 21,360,000 Lekë me TVSH me objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht” i janë bërë amendamentet nr.1 dhe nr.2 me të cilat i është shtuar dhe supervizionimi i kësaj kontrate. Amendamentit Nr.1 datë 08.07.2019 i është shtuar shërbimi i mbikëqyrjes për rrugën Qafë Thorë-Theth me vlerë **1,788,000 lekë me TVSH** me një afat dy muaj deri në lidhjen e kontratës së konsulentit i cili do të mbikëqyrë punimet civile për këtë kontratë. Nëpërmjet Amendamentit Nr. 2 date 02.04.2020 këtij operatori i është kaluar i gjithë shërbimi për supervizionimin e rrugës Qafë Thorë-Theth me vlerë **16,440,000 lekë me TVSH**. Deri në fund të periudhës së audituar, 31.12.2020, vlera e disbursuar për supervizionimin e kontratës së zbatimit të punimeve civile është 11,675,000 lekë me TVSH.

Punimet për rindërtimin e rrugës Qafe Thorë-Theth kanë filluar më 04.09.2019. Në muajin Dhjetor, 2019 punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike dhe kanë rifilluar në Maj të vitit 2020 dhe janë ndërprerë përsëri në Nëntor, 2020 dhe deri në fund të periudhës audituese, 30.04.2021, nuk kanë filluar. Deri në fund të periudhës objekt auditimi datë 31.12.2020, progresi fizik i punimeve është në masën 52% dhe progresi financiar është në masën 68.9%. Kontratës së zbatimit të punimeve i është bërë një ndryshim pas rishikimit fillestar të projektit në volumet e saj duke e zvogëluar vlerën e kontratës me **20,846,097 lekë pa TVSH** duke e kaluar këtë vlerë në fonde rezervë të kontratës.

Nga auditimi, për punimet e realizuara deri në fund të periudhës së audituar, rezultuan diferenca në volume punimesh të likuiduara por të pa pasqyruara në librezat e masave në shumën **15,137,872 Lekë pa TVSH**.

2.5.3 Titulli i gjetjes: Mangësi në dokumentacion gjatë realizimit të punimeve civile.

Situata: Për objektin **“Rindërtimi i Rrugës Qafë Thorë-Theth”**, sipas kontratës të lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe BOE "G. C....." shpk & "Gj." shpk me referencë RL.CP/1/I.I/ 2018 datë 08.07.2019, në lidhje me zbatimin e punimeve civile, me vlerë **613,585,590 lekë pa TVSH** ose **736,302,708 Lekë me TVSH**, me afat përfundimi të punimeve 10 muaj, konkretisht:

- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built);*
- *Pagesat pjesore nga Situacioni (IPC) nr. 1 deri situacionin (IPC) nr. 4;*
- *Librezat e masave (Measurement Sheets);*
- *Praktika e Urdhër Ndryshimit (Variation Order, VO nr.1);*
- *Korrespondencat mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe Kompanisë konsulente që kryen supervizionimin OE “Transport Highway Consulting (THC)” shpk.*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Supervizorit të punimeve rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (IPC nr.4) volume pune jo të pasqyruara në librezat e masave (Measurement Sheets). Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Strukturat (Structures)	Mbushje me material te selektuar nga gërmimi	780,032
2	Strukturat	Prita Malore	288,200
3	Strukturat	Beton për Strukturat C 20/25 ose equivalent	1,215,000
4	Strukturat	Struktura e tunelit Fv Hekur betoni B450C	1,505,840
5	Strukturat	Mure Geocell 445-200 (të detajuara si në vizatimet)	11,348,800
SHUMA			15,137,872

Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Aneksin 2.5.2.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: *“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”*

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: *“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe*

ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

“3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.4 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

Kontrata e shërbimit sipas amendamenteve Nr.1 datë 08.07.2019 dhe Nr. 2 date 02.04.2020 me objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht”, për supervizionimin e kontratës së zbatimit të rrugës Qafë Thorë-Theth.

Ndikimi/Efekti: Shpenzim i pa mbështetur me dokumentacion justifikues.

Shkaku: Certifikim i pagesave të ndërmjetme nga ana e Supervizorit për volume punimesh të pa pasqyruara në librezat e masave (Measurement Sheets).

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: FSHZH të marrë masa që në të ardhmen të mos kryej pagesa situacionesh pa dokumentacion justifikues duke mos tejkaluar buxhetin e programuar kohor e duke shmangur kështu vendosjen në vështirësi të likuiditeteve të saj.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Supervizorit/Kon. OE “T. Con. ” shpk Ing. I. H. , sipas kontratës së shërbimit RL.CP/1/1.5/2018 datë 27.05.2019, e ndryshuar, për shërbimin e mbikëqyrjes për rrugën Qafë Thorë-Theth”.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi Nr. 8 datë 30.04.2021 dhe për këtë çështje personi i atakuar, mbikëqyrësi i punimeve, z. I. H. me shkresën përcjellëse Nr.675/15Prot. datë 08.09.2021, administruar në KLSH me Nr. 254/5 datë 09.09.2021 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

Mbikëqyrësi i Punimeve ka bere korrigjimet ne situacionin pasardhës Nr.5 (IPC No.5 periudha 21 Tetor 2020 – 2 Korrik 2021) për te gjitha zërat e konstatuara ne Projekt Raport si me poshtë:

1. 3.11. Borrow excavation to fill / Mbushje me material te selektuar nga gërmimi - Sasia e mbushjes është marre 9040 m3 ne IPC Nr.4 ne libeze është 8065 m3 por është zbritur tek IPC No.5 është bere 7450 m3, pas hartimit te librezës faktike te masave ne përputhje me matjet e bëra ne terren pas rifillimit te punimeve ne Qershor 2021.

2. 3.12 Cascades for the control of the erosion and water flow (mortar stone masonry) As shown on the drawings / Prita Malore - Pritat malore ne IPC 4 janë situacionuar 200m3. Ky zë është saktësuar me matjet ne teren dhe hartimin e librezës se masave faktike mbi pas fillimit te punimeve ne Qershor 2021.

3. 3.18. Concrete for Structures C 20/25 or equivalent / Beton për Strukturat C 20/25 or equivalent
- Beton për muret mbajtës janë situacionuar në IPC 4 560 m³. Ky zë është saktësuar me matjet në teren dhe hartimin e librezës së masave faktike mbi pas fillimit të punimeve në Qershor 2021.

4. 3.19. Tunnel Structure Steel B450C / Struktura e tunelit Fv Hekur betoni B450C - Është situacionuar në IPC 4 175 ton hekur për tunelet Ky zë është saktësuar me matjet në teren dhe hartimin e librezës së masave faktike mbi pas fillimit të punimeve në Qershor 2021.

5. 3.29 .Wall with geocel 445-200 (as detailed on the drawings) / Mure Geocell 445-200 (të detajuara si në vizatimet) - Muret e geocellit në IPC 4 janë situacionuar 18,530 m³ kurse pas saktësimit të matjeve me rifillimin e punimeve në qershor 2021, është hartuar librezë faktike e masave në IPC 5 dhe volumni i mureve të geocelit është zbritur 17,500 m³.

Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve do të gjenden:

- Situacioni Nr.5 (IPC No.5) periudhë 21 Tetor 2020 – 2 Korrik 2021 miratuar nga Mbikëqyrësi dhe Investitori ku janë reflektuar volumnet e saktësuara në terren pas rifillimit të punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Referuar sqarimeve dhe dokumentacionit bashkëlidhur për gjetjet e konstatuara merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi vlerat e punimeve e kryer pa dokumentacion justifikues është reflektuar në situacionin pasardhës, e do të pasqyrohen në Raportin Përfundimtar.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Në Marrëveshjen e Huas nr.8850-AI datë 05.06.2018, me vlerë 50 mil US\$, ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Qeverisë Shqiptare, në Skedulin 2 të saj, është përcaktuar se Personeli i Dedikuar për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” (RLRCP) përbën një organizim institucional në FSHZH. Në Manualin Operacional, datë 30.08.2018, pika 1, shkronja (d) FSHZH, është përcaktuar se në përbërje të Personelit të Dedikuar duhet të jenë përfshirë një Projekt Menaxher Inxhinier, një Specialist Menaxhimi Financiar, një Specialist Prokurimesh, një Specialist Mjedisi, një Specialist Social dhe inxhinierë të fushës. Përveç kësaj, FSHZH mund të punësojë konsulentë ose mbështesë me staf, të cilët do të punojnë sipas mënyrës on-call basis, në varësi nga nevojat specifike të aktiviteteve. Në Vendimin nr.186, datë 25.07.2019 të Këshillit Drejtues është vendosur për disa ndryshime në strukturën organizative dhe manualin e procedurave administrative të FSHZH, kapitulli “Njësitë e Menaxhimit të Projekt Programeve” shkronja (d) pika 78 është vendosur se: “Në varësi të llojit, fazës dhe volumit të projekt/programeve, që përfshihen në një njësi menaxhimi, Drejtori Ekzekutiv mund të vendosë edhe përcaktimin e një menaxheri që do të ndjekë në mënyrë specifike një prej projekt/programeve që përfshihen brenda një njësie. Nga auditimi rezulton se është shpërndarë personeli, i cili rezulton të jetë përgjegjës për disa projekte të ndryshme, gjithashtu është shpërndarë edhe përgjegjësia që duhet të ketë Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, i cili në zbatim të Manualit Operacional (aneks 2) të projektit duhet të ketë në varësi direkt Njësitë e Menaxhimit të Projekt/Programeve si dhe nuk rezultojnë akte emërimi ose urdhra specifikisht për menaxhimin e projektit “Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RLCP) P163239. Për sa më sipër është në kundërshtim me Marrëveshjen e Huas, Skeduli 2, Seksionin I A, pika 1, nr.8850 datë 05.06.2018, si edhe Manuali Operacional, pika 1, shkronja (e) dhe Aneksi 2 i saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për identifikimin dhe emërimin e personelit të dedikuar projektit “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”, me qëllim koordinimin e aktiviteteve në përbërje të tij.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Referuar niveleve të parashikuar sipas viteve në Marrëveshjet e Financimit dhe Manualin Operacional të nivelit të realizimit të objektivave të projektit dhe nivelet konkrete aktuale të arritura për çdo vit deri në përfundimin e periudhës objekt auditimi Dhjetor 2020 rezulton se objektivat që lidhen me komponentin e parë të projektit që është përmirësimi i aksesueshmërisë dhe me indikatorët e progresit fizik të tij si, kilometra rrugë të rehabilituara, numrin e qendrave të banuara të lidhura nëpërmjet rrugëve të rehabilituara apo koha e reduktuar e udhëtimit në rrugët e projektit, pavarësisht se kanë një përqindje realizimi ato nuk janë arritur sipas përcaktimeve fillestare. Objektivat që lidhen me komponentin e dytë dhe të tretë të projektit pra indikatorët e ndërmjetëm që kanë të bëjnë me kapacitete bashkiake të përmirësuara për menaxhimin e aseteve rrugore, apo mbështetje për menaxhimin e zbatimit me trajnime, përmirësime dhe politika, rezultojnë ende të pa realizuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të projektit, të marrë masa që kontraktori të rrisë kapacitetet në mënyrë që të arrihet realizimi i objektivave dhe përfundimi në kohë i projektit. Gjithashtu të koordinojë punën për realizimin e indikatorëve të ndërmjetëm.

3. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën e prokurimit për kontratën “*Shërbime Mbikëqyrje për rrugën Pogradec-Tushemisht*” rezulton se mënyra e prokurimit ka qenë procedurë kombëtare me metodën e përcaktuar “Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentit (CQS)”. Zhvillimi i kësaj procedure referuar rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FP1, 1.07 2016, Seksioni VII, Metoda të Aprovuara të Përzgjedhjes së Shërbimeve të Konsulencës, pika 7.12 është e përshtatshme për detyra të vogla ose situata emergjente për të cilat nuk justifikohet vlerësimi i propozimeve konkurruese, gjithashtu referuar Manualit Operacional të Projekt, Pika 3, tabela 3.1 është përcaktuar kushti *Përzgjedhje në bazë të Kualifikimeve të Konsulentin nën 300,000\$, në varësi të natyrës së detyrave*. Për më tepër në Strategjinë për Zhvillimin e Prokurimeve të Projektit PPSD, pika IV- Objektivat e Prokurimeve, pika 2.2 specifikohet për (CQS) *afati i përllogaritur është afërsisht 4-6 muaj përfshirë periudhën e nevojshme për përgatitjen dhe dakortësimin e termave të referencës*. Mbështetur në Udhëzimet për Prokurime të Bankës Botërore, dokumenti “Strategjia për Zhvillim të Prokurimeve të Projektit, Udhëzues i Detajuar Format i Shkurtër, Korrik 2016”, rekomandohet argumentimi dhe logjik për Mënyrën e Prokurimit të zgjedhur. Konkretisht kjo procedure prokurimi ka zgjatur 9 muaj pra më shumë sesa periudha e përcaktuar si kriter për përzgjedhjen e saj, gjithashtu nuk është argumentuar përzgjedhja e kësaj metode për këto shërbime mbikëqyrje nga ana e Klientit duke mos marrë në konsideratë natyrën e detyrës për shërbimin e mbikëqyrjes. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia Prokurimit, të marrë masa që të analizojë metodologjitë e përzgjedhjes së mënyrave të prokurimit e ti argumentojë ato sipas kriterëve për zgjedhjen e tyre.

Në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Në 10 (dhjetë) procedurat e prokurimit, në tre raste rezultuan se ofertat e operatorit fitues janë anomalisht të ulëta, konkretisht:

Për procedurën e prokurimit “*Rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll*” rezulton se oferta e dhënë nga OE fitues “*G.....r ltd*” me vlerë 15,001,025.77 US\$ me tvsh është 14,123,79 US\$ me tvsh, më e ulët se vlera e fondit limit ose 48.4% më e ulët.

Për procedurën e prokurimit “*Rikonstruksion i rrugës Lekdush-Bençë-Tepelenë, Loti 2*” rezulton se oferta e dhënë nga OE fitues “*C. O. I. S. V. T. AS*” me vlerë 2,474,793 US\$ me TVSH është 2,240,907 US\$ më e ulët se vlera e fondit limit ose 47.5% me e ulët.

Për procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht*” rezulton se oferta e dhënë nga BOE fitues “*A.....*” shpk dhe “*G. L.*” shpk me vlerë 377,388,382 lekë me TVSH është 243,342,298 lekë më e ulët se vlera e fondit limit ose 40% me e ulët.

Në gjykimin e grupit të auditimit ofertat vlerësohen si anomalish të ulta në krahasim me koston e planifikuar dhe me ofertat e ofertuesve të kualifikuar në secilën procedurë si dhe krahasimet e çmimeve të dhëna me manualët e miratuar. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të këtyre procedurave nuk ka kërkuar asnjë dokumentacion justifikues apo analizë të detajuar për të mbështetur ofertën e OE, përpara se të merrte vendim për kualifikimin e tyre duke ju referuar metodologjisë së vlerësimit. Për sa më sipër në kundërshtim me Manualin e Prokurimeve të BB për huamarrësit e EFP1 datë 01.07.2016, pika 5.66 dhe 5.77. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa që të analizojë ofertat e OE, dhe në rastet kur ato janë anomalish të ulta të kërkojë dokumentacion

justifikues shitesë dhe analizë të detajuar të çmimeve, përpara se të marrë vendim për kualifikimin, me qëllim eliminimin e risqeve në realizimin e kontratave në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Në vijimësi

5. Gjetja nga auditimi: Ndryshim i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës për “Shërbimet të Supervizionit për Rikonstruksionin e Rrugëve, afërsisht 45 km” RL.CP/1/1.6/2018 Në datën 06.06.2019.

Në Seksionin 7 Termat e Referencës, pika III “Kontrata e Shërbimit” janë përcaktuar 3 segmente rrugore në rikonstruksion, prej të cilave 2 segmente janë Fier-Seman dhe Qafë Thorë-Theth, ndërkohë segmenti i tretë i papërcaktuar. Në datën 12 Qershor 2019 është dakordësuar ndryshimi i termave të referencës mbi përbërjen e stafit të ekspertëve dhe kërkesat për ekspertët kryesor. Afati për dorëzimin e Kërkesës për Propozim për kontratën RL.CP/1/1.6/2018 është vendosur data 26.07.2019. Me Urdhrin Nr.07 datë 20.07.2019 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH, është ngritur komisioni i hartimit të fondit limit dhe termave të referencës për segmentin rrugor Gusmar-Kuç.

Në zbatim të Marrëveshjes së Huasë me Bankën Botërore IBRD Nr.8850-AL datë 05.06.2018 janë nënshkruar marrëveshjet e investimit të FSHZH me bashkitë Tepelenë dhe Himarë në datat 11 Korrik 2019 dhe 18 Korrik 2019 lidhur me segmentet rrugore Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë. Në datën 03 Mars 2020, nga ana e FSHZH, është kërkuar negociimi për lidhjen e kontratës “Shërbimi i Supervizionit për rikonstruksionin e rrugëve (afërsisht 45 km)”, Ref.Nr. RL.CP/1/1.6/2018 me kandidatin potencial të radhës së dytë “E. S. de Ing.” s.l. Në Minutat e Takimit, “Pjesa Teknike” pika 2, datë 06 Mars 2020, është vendosur për ndryshimin e segmenteve rrugore, në të cilin është hequr segmenti Qafë Thorë-Theth dhe në vend të tij është vendosur segmenti Gusmar-Kuç dhe Lekdush-Tepelenë.

Referuar “Udhëzimit të Prokurimeve” të Bankës Botërore, Prill 2018, botimi i pare, seksioni IV, pika 6 “Lidhja e Kontratës”, nuk është parashikuar ndryshim i termave të referencës në këtë hap të procesit të prokurimit, por vetëm njoftimi i qëllimit të lidhjes, i cili përfshin periudhën e pauzës së procesit për ankimet e mundshme, përfundimi i kësaj periudhe dhe njoftimi për lidhjen e kontratës.

Ndryshimi i qasjes teknike, apo ndryshimi i segmenteve rrugore në momentin e lidhjes së kontratës, ka shkatuar deformim në procesin e prokurimit, për arsye se ndryshimi i termave të referencës, apo kushteve të kontratës kryhen përpara skadimit të afatit përfundimtar (deadline) të dorëzimit të Kërkesës për Propozim. Gjithashtu, pavarësisht nga ngjashmëria e kompleksitetit, segmentet ndryshojnë nga njëri tjetri dhe për pasojë ndryshon edhe kompozimi i stafit të ekspertëve, ditët e punës efektive të tyre, apo metodologjia e hartuar.

Ndryshimi i termave të referencës në procesin e lidhjes së kontratës ka shkaktuar si pasojë mungesën e njohjes me ndryshimet për të gjithë konsulentët potencial pjesëmarrës në tender. Sa sipër, në kundërshtim me pikën 13 “Sqarime dhe ndryshime të Kërkesës për Propozim, Seksioni 2 “Instruksionet për Konsulentët”, në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, si edhe në kundërshtim me Udhëzimin e Bankës IBRD “Rregullat e Prokurimit” 1 Korrik 2016, Seksioni V Sqarime të Dokumenteve të Prokurimit, Paragrafi 5.31 dhe 5.32. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve, pjesë e prokurimit të kontratave për projektin “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”. Gjithashtu, kompozimi i Komisioni të Vlerësimit për prokurimin e projekteve të huaja duhet ti shërbejë forcimit të objektivitetit të vlerësimit, duke përfshirë punonjës të dedikuar me qëllim rritjen e llogaridhënies edhe gjatë procesit të prokurimeve.

6. Gjetja nga auditimi: Ndryshimi i kushteve të pagesës së konsulentit jashtë kërkesave të termave të referencës për “Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore”, Kontrata RL.CP/1/1.9/2018.

Në raportin e vlerësimit datë 11 Shtator 2019, është rekomanduar lidhja e kontratës me konsulentin J. “F. Eng.” sr. & “Inf.” sh.p.k. me vlerën prej 187,680 USD përfshirë TVSH.

Negociatat për lidhjen e kontratës me aplikantin potencial fitues të sipërcituar janë kryer në datat 12 dhe 18 Shtator 2019.

Gjatë këtyre negociatave në datën 18.09.2019 është vendosur për ndryshimet si më poshtë:

-Në pikën 6 të Minutave të Takimit, është hequr pagesa në avancë (paradhënie) e konsulentit dhe pagesat për konsulentin janë ndryshuar si më poshtë:

-Fatura e dorëzuar pas përgatitjes të Raportit Fillestar dhe Raportet e Auditimit për tre segmentet e para të jetë 30 % e shumës totale të kontratës;

-Fatura pas dorëzimit të projektit dhe planit të ndërhyrjes për zonën pilot të jetë 40 % e shumës totale të kontratës;

-Fatura pas Raportit të Auditimit për segmentin e katërt rrugor të jetë 20 % e shumës totale të kontratës;

-Pagesa e mbetur 10 % pas mbikëqyrjes së zonës pilot dhe pranimi të Raportit përfundimtar.

Por, në Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 “Termat e Referencës”, pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH) është përcaktuar se lidhur me pagesat për Konsulentin, ai duhet të dorëzojë faturat sipas programit si më poshtë:

(i) Financimi paradhënie: Konsulenti ka të drejtë që me nënshkrimin e kontratës të paguhet me një paradhënie prej 20 % të çmimit total të vlerësuar përkundrejt një garancie bankare për shumën e marrë dhe e vlefshme deri në përfundimin e punës së kryer.

(ii) Pagesa e faturës: Konsulenti do të lëshojë 3 fatura për shërbimet e kryera pas miratimit nga FSHZH deri në madhësinë prej 70 % të kontratës. Shuma prej 10 % e mbetur do të jetë paguar pas përfundimit dhe pranimi të Raportit Përfundimtar.

(iii) Pagesa prej 10 %: Pas mbikëqyrjes të masave të implementuara dhe dorëzimit të Raportit Përfundimtar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, gjithashtu, është në kundërshtim me Kërkesat për Propozim, Seksioni 7 “Termat e Referencës”, pika 6 Pagesat (faqe 178 e inventarit të FSHZH).

Veprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë mospërputhje midis dispozitave të parashikuara gjatë procesit të prokurimit dhe situatës së krijuar. Sa sipër, ndryshimi i mënyrës së pagesës së Konsulentit ka sjellë si pasojë rritjen e riskut për përfundimin e detyrave të tij. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 31-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ardhmen në drejtim të menaxhimit me risk sa më të ulët të kontratave të konsulencës.

7. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës “Rikonstruktion i rrugës Gusmar-Kuç” konstatohet se referuar Vendimit Nr. 5 datë 28.02.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit i cili vendos miratimin me kusht të lejes së ndërtimit të infrastrukturës “Rikonstrukcioni i segmentit të Rrugës Gusmar-Kuç” me vendndodhjen në Bashkinë Tepelenë dhe Himarë, me zhvillues Bashkinë Tepelenë dhe Bashkinë Himarë, subjekti nuk rezulton të jetë pajisur me Dokumentin e Lejes së

ndërtimit. Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” neni 27 dhe 28, dhe VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 ‘Për Miratimin E Rregullores së Zhvillimit së Territorit’ të ndryshuar, neni 25 pika 11 dhe 13. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: FSHZH dhe strukturat përkatëse, të marrin masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit, nga të gjitha palët e përfshira në projekt, për pajisjen me leje ndërtimore sipas legjislacionit në fuqi për shmangien e problematikave që mund të lindin gjatë zbatimit të punimeve.

Në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Rindërtimi i Rrugës Qafë Thorë-Theth”, sipas kontratës të lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe BOE "G. C....." shpk & "Gj." shpk me referencë RLRC/1/1.1/ 2018 datë 08.07.2019, në lidhje me zbatimin e punimeve civile, me vlerë 613,585,590 lekë pa TVSH ose 736,302,708 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 10 muaj, rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (IPC nr. 4) volume pune jo të pasqyruara në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe të pa shoqëruara me dokumentacionin plotësues. Këto diferenca rezultuan në 5 (pesë) zëra punimesh në shumën 15,137,872 Lekë pa TVSH të cilat janë reflektuar në situacionin pasardhës. Pavarësisht rregullimit, certifikimi i tyre pa dokumentacionin justifikues është në kundërshtim me Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit sipas amendamenteve Nr.1 datë 08.07.2019 dhe Nr. 2 date 02.04.2020 me objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht”, për supervizionimin e kontratës së zbatimit të rrugës Qafë Thorë-Theth. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: FSHZH të marrë masa që në të ardhmen të mos kryej pagesa situacionesh pa dokumentacion justifikues duke mos tejkaluar buxhetin e programuar kohor e shmagur kështu vendosjen në vështirësi të likuiditeteve të saj.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Rikonstruktion i Rrugës Pogradec-Tushemisht”, sipas kontratës të lidhur midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe BOE "A....." shpk & “G. L.” shpk me referencë RL.CP/1/1.2/2018 datë 27.05.2019, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë 314,490,318 lekë pa TVSH ose 377,388,382 Lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 8 muaj, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionin përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera për dy zëra në shumën **373,975 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si dhe 10 zëra punimesh të dëmtuara që duhet të riparohen gjatë fazës së garancisë në shumën **858,447 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit me

objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht”, Nr. RL.CP/1/1.5/2018 datë 27.05.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: FSHZH të kërkoj në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **373,975 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE “A.....” SHPK & “G. L.” SHPK, si dhe kryerjen e punime të dëmtuara brenda afatit të garancisë së tyre në shumën **472,447 lekë pa TVSH**, e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. RL.CP/1/1.2/2018 datë 27.05.2019 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Pogradec-Tushemisht”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

E.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

E.1.1 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, Manualin e Procedurave të FSHZH, pika 7.11, germa g, kontratat individuale të punës, neni 12, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për personat si më poshtë:

1. Z. E. O. me detyrë Drejtor Departamentit të Menaxhimit të Projekteve, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
2. Z. D. M. me detyrë specialist në Njësinë e Zbatimit, Departamenti i Infrastrukturës, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
3. Z. L. M. me detyrë P/Njësinë e Zbatimit të Projektit Utilitare, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për moszbatim të DST në procesin e prokurimit “Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore”, Kontrata RL.CP/1/1.9/2018, Kërkesën për Propozim, Seksionin 2 Instruksionet për Konsulentët, pika D, shkronjat (b), paragrafi 28.5, si edhe me Seksionin 7, pika 3 dhe 6, si edhe veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Bankës IBRD “Rregullat e Prokurimit” 1 Korrik 2016, Seksioni V Sqarime të Dokumenteve të Prokurimit, Paragrafi 5.31 dhe 5.32

Për moszbatim të DST për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime të supervizionit për rikonstruksionin e rrugëve, afërsisht 45 km”. Kërkesat për Propozim, Seksionin 2 ITC, shkronja D, paragrafi 28.5, si edhe veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Bankës IBRD “Rregullat e Prokurimit” 1 Korrik 2016, Seksioni V Sqarime të Dokumenteve të Prokurimit, Paragrafi 5.31 dhe 5.32.

Shënim:

1. Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune: z. D. A.; z. E. K.; znj. M. Dh. dhe z. D. M. A. të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjë prej tyre gjatë përmblotjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në zbatimin e detyrave, konsiderojmë që për to, të mos propozohet masë.
2. Nga auditimi i kontratës “Rikonstruksion i Rrugës Pogradec-Tushemisht”, janë konstatuar punime të pa kryera dhe të dëmtuara gjatë fazës së garancisë në masën 0.2% të vlerës së

kontratës. Nisur nga vlera e pa konsiderueshme e shkeljes krahasuar me vlerën e kontratës dhe faktin se pjesa më e madhe e punimeve janë të riparueshme, mendojmë se nuk ka vend për masë disiplinore, për mbikëqyrësin e punimeve *“Tr. Hig. Con. THC” shpk, sipas kontratës së shërbimit RL.CP/1/1.5/2018 datë 27.05.2019 me objekt “Shërbime supervizionimi për rrugën Pogradec-Tushemisht”*.

V. ANEKSE

Aneksi nr. 1 *“Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimin e fondeve publike”*.

Aneksi 3.1 *“Shërbime konsulence për identifikimin, inspektimin dhe supervizionin e ndërhyrjeve të mundshme për sigurinë rrugore”*.

-Planifikimi i prokurimit

Prokurimi i shërbimit të konsulencës është planifikuar si pjesë përbërëse e planit të “Projektit Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale” (RL.CP), Nr.P163239, i cili është dakordësuar nga Banka në datën 27 Shtator 2018. Gjithashtu, nga ana e FSHZH është kërkuar, në datën 11 Mars 2019, rishqyrtimi i planit dhe është dakordësuar nga Banka në datën 12 Mars 2019.

Kosto e vlerësimit fillestar është parashikuar 200,000 US\$

Procesi i prokurimit me të dhëna dhe hapat kryesore është dhënë në tabelën si më poshtë:

Plani i Prokurimit: Kontrata RLRCP/1/1.9/2018 “Projekti i Konektivitetit të Rrugëve Lokale dhe Rajonale” P163239. Huaja Nr. 8850-AL Banka Botërore.			
Përmbajtja	Planifikuar	Rishikuar	Statusi aktual
Njoftimi për shprehje të interesit	03 Dhjetor 2018		19 Mars 2019
Afati për shprehje të interesit.	10 Prill 2019		10 Prill 2019
Vlerësimi paraprak dhe short-list			31 Maj 2019
Kategoria:	Shërbime Konsulenti		
Komponenti:	1		
Metoda e zgjedhjes së prokurimit:	QCBS (Quality and Cost based Selection)		
Qasja e tregut:	I hapur kombëtar		
Rishikim i Bankës (No-Objection) Përpara/Pas:	Pas		
Kosto e vlerësimit fillestar (përfshi tvsh dhe kontigjencën):	200,000 USA		187,680 USD
Afati i kërkesës për propozim dhe hapja propozimeve teknike.	25 Mars 2019	25 Korrik 2019, ora 11:00	25 Korrik 2019 ora 11:00
Hapja e propozimit financiar.		27 Gusht 2019, ora 11:00	27 Gusht 2019, ora 11:00
Periodha e fillimit të shërbimit të konsulencës	Mars 2019		
Njoftimi për dhënien e kontratës (Letër Pranimit)			02 Tetor 2019
Nënshkrimi i kontratës	27 Qershor 2019		29 Tetor 2019

-Njoftimi për kërkesën e shprehjes së interesit:

Në datën 10 Prill 2019 është caktuar afati përfundimtar (deadline) për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara për vlerësimin paraprak të konsulentëve të interesuar, të cilët duhej të demonstronin kualifikimet dhe eksperiencën përkatëse.

Për aplikantët e interesuar është kërkuar informacion për të demonstruar kualifikimet e kërkuara dhe ekperiencën përkatëse për të kryer shërbimin e konsulencës. Në njoftimin për shprehjen e interesit është dhënë sistemi i llogaritjes me pike si më poshtë:

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikë
1	Vitet e shoqërisë në treg	20
2	Numri i stafit teknik të përhershëm të shoqërisë	30
3	Eksperienca specifike në kontrata të ngjashme në rajon	50
Total		100

-Marrja, hapja e shprehjes së interesit dhe vlerësimi:

Në process-verbalin e datës 10 Prill 2019 kanë shprehur interesin për pjesëmarrje 12 aplikantë. Për zgjedhjen e kandidatëve potencial është krijuar një short – list nga renditja e pikëve të fituara, duke zbatuar kushtin që numri i aplikantëve të variojë nga 5 min. deri në 8 max. Në Raportin e Vlerësimit të datës 31 Maj 2019 të Komisionit të Vlerësimit të FSHZH, është kryer vlerësimi për 12 pjesëmarrës. Nga renditja e pikëve të fituara, vetëm 7 aplikantët e parë kanë kaluar kualifikimin paraprak. Komisioni i vlerësimit ka refuzuar 5 aplikantë, të cilët nuk kanë prezantuar eksperiencën specifike të ngjashme.

Sa më sipër kanë fituar të drejtën e ftesës për propozim si më poshtë:

Nr.	Emëri i Konsulentit	Shteti	Pikët
1	J. "Il. Con. Eng." Lt. & "IM. Wor."It.	Shqipëri, Britani Madhe	100
2	"N. Int. A/S"	Itali	92.66
3	J. "S. & ass." sa & "Eg. O." sa	Greqi	89.33
4	JV "F. eng." srl & "Inf." shpk	Itali, Shqipëri	87
5	IR. Eng." Sr.	Itali	85.33
6	Ra. Int. Lim. Lt.	Britani Madhe	79
7	J. "Ro. Eng. Cons." S. & AD. –O. S.	Greqi	75.33

-Njoftimi i Kërkesës për Propozim

Në datën 31 Maj 2019 janë njoftuar, me anë të kërkesës për propozim 7 shoqëritë të kualifikuara paraprakisht. Gjithashtu, afati për dorëzimin e propozimit teknik dhe financiar është caktuar data 25 Korrik 2019 ora 11:00.

-Vlerësimi i ofertave të propozuara:

Metoda e aprovuar e zgjedhjes në prokurimin për shërbimin e konsulencës është caktuar ajo e Cilësisë dhe e Kostos Bazë (QCBS).

Ndërmjet propozimeve që janë përgjigjur dhe janë kualifikuar teknikisht, propozimi më i lartë i kombinuar (kosto dhe cilësia teknike), që rezulton nga vlerësimi, është konsideruar propozimi me më shumë avantazhe. Nga dokumentet e tenderit është përcaktuar kufiri minimal për kualifikimin teknik me 75 pikë, ndërsa propozimi më i ulë financiar me 100 pikë kufiri maksimal. Llogaritja e ofertës financiare është kryer sipas formulës $S_f = 100 \times F_{\min} / F_{\text{aplikantit}}$. Metodologjia e kombinimit të propozimeve teknike dhe financiare është përcaktuar ajo e peshës që zënë propozimi financiar dhe teknik, të cilat janë përcaktuar respektivisht $P=0.2$ dhe $T=0.8$. Propozimet, që janë renditur nga vlerësimi i kombinuar, sipas kësaj metode janë treguar në tabelën si më poshtë:

Nr.	Emëri i Konsulentit	Llogaritja teknike (pikë)	Propozimi Financiar Pa TVSH USD	Pikët Vlerësim Kombinuar i
1	J. "F. eng." srl & "Inf." shpk.	98.33	156,400	96.88
2	"NT. Int. A/S" & "D&C Par." shpk	95.97	181,300	92.49
3	"Il.Con.Eng." lt. (Nen kontrator konsulence) & "IM. Wo."lt.	99.37	219,801	92.46
4	IR. Eng." Sr.	90.11	142,428	92.09
5	Ra. In. L. Lt.	93.2	173,800	90.95
6	J. "S. & ass." S. & "Eg. O." S.	89.03	209,867	84.80
7	J. "Ro. Eng. Con." S. & AD. -Om. S.	86.28	210,357	82.57

Në datën 13 Korrik 2020 është firmosur një shtesë kontrate ndërmjet FSHZH dhe J. "F. ENG. SRL & In. SH.P.K, në vlerën prej 12,300 US\$ e kontratës shtesë me TVSH. Vlera totale e kontratës 199,980 US\$ nuk a ka kaluar vlerën e parashikuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, kjo shtesë nuk ka ndryshuar renditjen e konsulentit në vlerësimin e përgjithshëm gjatë procesit të tenderimit. Gjithashtu, në përshkrimin e detyrave është bërë ndryshimi si më poshtë:

-Në detyrën 1 të konsulentit është specifikuar segmenti i katërt rrugor Gusmar-Kuç-Lekdush-Bënçë-Tepelenë dhe shtuar 2 segmente rrugore Roskovec-Poshnjë dhe Plepa-Golem.

-Në detyrën 2 të konsulentit, paragrafi dytë, është specifikuar se: Konsulenti do të përgatisë një Raport Fillestar që mbulon gjetjet dhe dokumentimin e procedurës të rënë dakord. Konsulenti do të përfshijë një kapitull që përfshin dokumentet e vlerësuara si të domosdoshme për fazën e plotë 2 raportet e auditimit për të gjitha rrugët që janë përfshirë në detyrën 1.

Aneksi 3.2

Procedurat e prokurimit për kontratën RL.CP/1/1.6/2018: "Shërbime të supervizionit për rikonstruksionin e rrugëve, (afërsisht 45 km)".

-Planifikimi i prokurimit

Prokurimi i shërbimit të konsulencës për rikonstruksionin e segmenteve rrugore (45 km) është planifikuar si pjesë përbërëse e planit të "Projektit Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale" (RLRCP), Nr.P163239.

Procesi i prokurimit me të dhëna dhe hapat kryesore është dhënë në tabelën si më poshtë:

Plani i Prokurimit: Kontrata RLRC/1/1.6/2018 "Projekti i Konektivitetit të Rrugëve Lokale dhe Rajonale" P163239. Huaja Nr. 8850-AL Banka Botërore.			
Përmbajtja	Planifikuar	Rishikuar	Statusi aktual
Afati për shprehje të interesit.			07 Janar 2019
Vlerësimi paraprak dhe short-list			18 Mars 2019
Kategoria:	Shërbime Konsulenti		
Komponenti:	1		
Metoda e zgjedhjes së prokurimit:	QCBS (Quality and Cost based Selection)		
Qasja e tregut:	I hapur ndërkombëtar		
Rishikim i Bankës (No-Objection) Përpara/Pas:	Përpara		
Kosto e vlerësimit fillestar (përfshi tvsh dhe kontigjencën):	1,200,000 US\$		816,024 US\$
Miratimi i Bankës për Termat e Referencës (No-Objection)	08 Tetor 2018	13 Dhjetor 2018 12 Qershor 2019	12 Qershor 2019
Njoftimi për shprehje të interesit		13 Dhjetor 2018	14 Dhjetor 2018

Periudha e fillimit të shërbimit të konsulencës	Mars 2019		Prill 2020
Afati përfundimtar për propozimet teknike dhe financiare	15 Mars 2019	26 Korrik 2019	26 Korrik 2019
Njoftimi për dhënien e kontratës (Letër Pranimit)			07 April 2020
Nënshkrimi i kontratës	20 Janar 2019		17 April 2020

-Njoftimi për kërkesën e shprehjes së interesit:

Njoftimi për shprehjen e interesit është botuar në datën 15.12.2018 në Gazetat Koha Jonë dhe Telegraf, si edhe në faqen on-line të FSHZH.

Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara është caktuar data 07 Janar 2019. Për aplikantët e interesuar është kërkuar informacion për të demonstruar kualifikimet e kërkuara dhe ekperiencën përkatëse për të kryer shërbimin e konsulencës. Në njoftimin për shprehjen e interesit është dhënë sistemi i llogaritjes me pike si më poshtë:

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikë
1	Vitet e shoqërisë në treg	20
2	Numri i stafit teknik të përhershëm të shoqërisë	30
3	Eksperiencia specifike në kontrata të ngjashme në rajon	50
Total		100

-Marrja, hapja e shprehjes së interesit dhe vlerësimi:

Në process-verbalin e datës 07 Janar 2019 kanë shprehur interesin për pjesëmarrje 21 aplikantë. Për zgjedhjen e kandidatëve potencial është krijuar një short – list nga renditja e pikëve të fituara, duke zbatuar kushtin që numri i aplikantëve të variojë nga 5 min. deri në 8 max.

Në Raportin e Vlerësimit të datës 18 Mars 2019 të Komisionit të Vlerësimit të FSHZH, është kryer vlerësimi për 21 pjesëmarrës. Nga renditja e pikëve të fituara, vetëm 8 aplikantët e parë kanë kaluar fazën e pare dhe kanë fituar të drejtën e ftesës për propozim si më poshtë:

Nr.	Emëri i Konsulentit	Shteti	Pikët
1	“SP. Eng.” Sp.	Itali	96.33
2	J. “Ins. I. & “Tau.” shpk	Kroaci, Shqipëri	81
3	“Ept. Ser. de Ing.” sl	Spanjë	78
4	J. “Sa.-Con.Eng. Cen.” & “Ip. Ins.” do.	Jordani, Bosnje-Hercegovina	70.67
5	J. “P. Ar. Con. Eng.” Lt. (Pace Kuwait) & “Er.-G” shpk	Kuwait, Shqipëri	70.33
6	“D. Eng. Inc.Co”	Turqi	67.67
7	J. “T. Con. Eng.” spa & “In.-P.” shpk	Itali, Shqipëri	66.67
8	“R. Int. Lim.” Lt.	Mbretëria e Bashkuar	65

-Njoftimi i kërkesës për propozim

Në datën 12 Qershor 2019 janë njoftuar, me anë të kërkesës për propozim, 8 shoqëritë të kualifikuara nga faza e përzgjedhjes. Gjithashtu, afati për dorëzimin e propozimit teknik dhe financiar është caktuar data 26 Korrik 2019 ora 11:00.

-Vlerësimi i ofertave të propozuara:

Metoda e aprovuar e zgjedhjes në prokurimin për shërbimin e konsulencës është caktuar ajo e Cilësisë dhe e Kostos Bazë (QCBS Nga dokumentet e tenderit është përcaktuar kufiri minimal për kualifikimin teknik me 75 pikë, ndërsa propozimi më i ulë financiar me 100 pikë kufiri maksimal. Metodologjia e kombinimit të propozimeve teknike dhe financiare është përcaktuar ajo e peshës që zënë propozimi financiar dhe teknik, të cilat janë përcaktuar respektivisht $P=0.2$ dhe $T=0.8$. Propozimet, që janë renditur nga vlerësimi sipas kësaj metode janë treguar në tabelën si më poshtë: Në Raportin e Konsoliduar të Vlerësimit datë 28 Tetor 2019, konsulentët pjesëmarrës janë renditur sipas vlerësimit të kombinuar si më poshtë:

Nr.	Emëri i Konsulentit	Rezultat i Teknik (pikët)	Propozimi Financiar US\$ (pa TVSH)	Renditja nga rezultati i kombinuar (Pikët)
1	“SP. Eng.” spa	92.72	1,165,379	85.85
2	“Ep. Ser. D. Ing.” S.	82.16	680,020	85.73
3	“Ra. Int. Li.” Lt.	90.28	1,133,496	84.22
4	D. Eng. Inc.Co”	82.87	813,70	83.01
5	J. “T.Con. Eng.” S. & S.S. & “In.-Pl.” shpk	86.52	1,104,789	81.53
6	“J. “Ins. IG. & “Tau.” shpk	90.40	1,684,274	80.39
7	J. “P. Ar. Con. Eng.” Lt. (Pace Kuwait) & “Er.-G” shpk	78.60	791,240	80.07
8	J.“S.-Co. Eng. Cen.” & “Ip. Ins.” D.	87.01	1,485,600	78.77

Aneksi 3.3

Për rikonstrukcionin e rrugës “Qafë Thorë-Theth”, Bashkia Shkodër RL.CP1/1.1/2018

-Planifikimi i prokurimit:

“Rikonstrukcioni i rrugës Qafë Thorë-Theth” RL.CP/1/1.1/2018, është miratuar nga Banka në datën 12.03.2019 (No-Objection i Bankës).

Të dhënat e përgjithshme, që janë pjesë e planit të prokurimit tregohen në tabelën si më poshtë:

Plani i Prokurimit: RLRC/1/1.1/2018 “Projekti i Konektivitetit të Rrugëve Lokale dhe Rajonale” P163239. Huaja Nr. 8850-AL Banka Botërore.			
Përmbajtja	Planifikuar	Rishikuar	Statusi aktual
Kontrata: RLRC/1/1.1/2018 “Rikonstrukcioni i rrugës Qafë Thorë-Theth”, Shkodër, 16 km e gjatë.			
Kategoria:	Punime civile		Punime civile
Komponenti:	1		1
Metoda e prokurimit:	Para-kualifikim	Kërkesë për ofertë për punime të vogla (procesi me dy zarfa), 12 Mars 2019	Kërkesë për ofertë për punime të vogla (procesi me dy zarfa), 12 Mars 2019
Qasja e tregut:	I hapur ndërkombëtar		I hapur ndërkombëtar
Rishikim i Bankës (Përpara/Pas):	Pas		Pas
Kosto e vlerësimit fillestar (përfshi tvsh dhe kontigjencën):	7,236,000 US\$ 944,183,204 lekë		7,236,000 US\$ 944,183,204 lekë

Miratimi i Bankës për specifikimet teknike (No-Objection)	26 Tetor 2018	11 Mars 2019	11 Mars 2019
Dokumentet Standarde të tenderit të publikuara nga Banka			Tetor 2017
Afati përfundimtar për propozimet teknike dhe financiare	18 Mars 2019		03 Maj 2019 Ora 11:00
Nënshkrimi i kontratës	06 Maj 2019	12 Gusht 2019	08 Korrik 2019

-Njoftimi për kërkesën e ofertës:

Në njoftimin e dates 13.03.2019, është bërë e njohur kërkesa për ofertë “Rikonstruksioni i rrugës “Qafë Thorë-Theth”, 16 km i gjatë, e financuar nga Huaja e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim IBRD, nr.8850-AL datë 05.06.2018.

Kërkesa për ofertë është botuar në datën 14.03.2019 në Gazetën Shqiptare.

-Marrja dhe hapja e ofertave

Hapja e ofertave është kryer me datë 03.Maj 2019 ora 11:00 në zyrën qendrore të FSHZH, në prani të përfaqësuesve të aplikantëve dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

-Vlerësimi i ofertave:

Në zbatim të metodës së prokurimit “Kërkesë për Ofertë për Punime të Vogla” procesi i prokurimit është kryer me një fazë, por duke ndjekur rregullin e vlerësimit teknik në fillim dhe hapjen e zarfeve me ofertën financiare vetëm për ata aplikantë, të cilët kanë plotësuar kriteret teknike të kualifikimit. Pragrafi 2.1 seksioni III i DSP (Dokumentet Standarte të Prokurimit). Në kriteret e kualifikimit janë përfshirë si më poshtë:

1. Kriteret e përshtatshmërisë ligjore,
2. Kontratat e parealizuara;
3. Situata dhe performance financiare;
4. Eksperienca;
- 4.1 Eksperienca me kontratat në ndërtim në rolin e kontraktorit primar ose anëtarit të Joint Venture, për 5 vitet e fundit (2014-2018);
- 4.2 (a) Eksperienca Specifike në Ndërtim:

Një numër minimal i kontratave të ngjashme dhe të përfunduara si kontraktor primar ose si anëtar i Joint Venture, në 5 vitet e fundit (2014-2018).

- i. Minimumi 2 kontrata, secila me vlerë minimale prej 755,000,000 lekë;
- ii. Më pak, ose e barabartë me 2 kontrata, ku njëra me vlerën minimale 755,000,000lekë, por me vlerë totale për të gjitha kontratat e barabartë ose më shumë se 1,510.000,000 lekë.

(b).Sa sipër, për kontrata të përfunduara dhe në process, si kontraktor primar apo anëtar i JV në 5 vitet e fundit (2014-2018) eksperienca minimale në aktivitetet kryesore të realizuara me sukses janë si më poshtë:

- i. Punime dheu: 200 000m³ në një vit, brenda 5 viteve të fundit (2014-2018);
- ii. Punime asfalti: 20 ton në një vit brenda 5 viteve të fundit (2014-2018);
- iii. Punime Geotextile/geocell: 100,000 m² në një vit brenda 5 viteve të fundit (2014-2018);
- iv. Punime mure guri: 10,000 m³ në një vit brenda 5 viteve të fundit (2014-2018);

Në Raportin e Vlerësimit të Ofertave, datë 27 Maj 2019, është dhënë edhe rekomandimi i lidhjes së kontratës me ofertuesin më të ulët J. “G..... Com.” SH.P.K & “Gj.” SH.P.K.

Gjatë auditimit është konstatuar se kanë tërhequr dokumentet e tenderit 32 subjekte dhe vetëm 7 prej tyre kanë dërguar ofertat e vulosura.

Në raportin e vlerësimit teknik të ofertave date 21 Maj 2019 janë prezntuar aplikantët, që kanë plotësuar kërkesat teknike, si më poshtë:

1. "Ra. A.-T. Con. Est.";
2. "G....." SH.P.K;
3. "Al." SH.P.K;
4. "Sal." SH.P.K;
5. "Avt.-Tech. Mo." JC. Shu.;
6. J. "G..... Co." SH.P.K & "Gj." SH.P.K.

Hapja e ofertës financiare është kryer në datën 24 Maj 2019 ora 11:00.

-Lidhja e kontratës:

Kontratë-Marrëveshje date 08.07.2019 ndërmjet J. "G..... Com." SH.P.K & "Gj." SH.P.K. dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit është lidhur në kuadrin e "Projekti Konektiviteti i Rrugëve Lokale dhe Rajonale" RL.CP/1/1.1/2018 me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Qafë Thorë-Theth".

Aneksi 3.4

"Rehabilitimi i rruës Vlorë-Orikum" 10.6km EBRD/RLRCP/W/2020/1.)

-Planifikimi i prokurimit

Procesi i prokurimit me të dhëta dhe hapat kryesore është dhënë në tabelën si më poshtë:

Plani i Prokurimit: Kontrata RLRC/1/1.9/2018 "Projekti i Konektivitetit të Rrugëve Lokale dhe Rajonale" P163239. Huaja Nr. 8850-AL Banka Botërore.			
Përmbajtja	Planifikuar	Rishikuar nga Banka	Statusi aktual
Ftesa para-kualifikim	Shkurt 2020	25 Shkurt 2020	25 Shkurt 2020
Afati parakualifikimit	20 Mars 2020	27 Mars 2020	27 Mars 2020 Amenduar 03 Prill 2020
Vlerësimi pa-kusht i para-kualifikimit	20 Prill 2020		24 Korrik 2020
Kategoria:	Punime civile		
Metoda e zgjedhjes së prokurimit:	1 fazë e vetme me para-kualifikim të cilësisë		
Qasja e tregut:	I hapur		
Rishikim i Bankës (No-Objection) Përpara/Pas:	Përpara		
Kosto e vlerësimit fillestar (pa tvsh)	14,036,939 US\$		7,228,538.85 US\$
Specifikimet Teknike	24 Skurt 2020	25 Shurt 2020	25 Shurt 2020
Hapja e Tenderit	20 Prill 2020	04 Shtator 2020	22 Tetor 2020 ora 10:00
Vlerësimi i tenderit	20 Korrik 2020		28 Nëntor 2020
Njoftimi për dhënien e kontratës (Letër Pranimit)	20 Korrik 2020		
Nënshkrimi i kontratës	20 Korrik 2020		07 Djetor 2020
Shtesë Kontrate(VO 1)			

-Njoftimi për kërkesën e ofertës:

Për kryerjen e prokurimit është përdorur procedurë e hapur konkurimi me një fazë të vetme me para-kualifikim dhe kontroll të cilësisë, konform rregullave të prokurimit të Bankës 1 Shtator 2019.

Njoftimi për para-kualifikimin ishte publikuar në web-site e Bankës në datën 25 Shkurt 2020, si edhe afati për dorëzimin e dokumenteve ër ishte vendosur më 27 Mars 2020. Ndërkohë, afati përfundimtar (dead-line) ishte amenduar në 03 Prill 2020. Sipas publikimit për para-kualifikim, ishin regjistruar në system on-line 23 aplikantë nëpërmjet sistemit ECEPP të Bankës. Në seksionin e IV të Përshtatshmëria dhe Kriteret e Vlerësimit, pikat 4.1, 4.2, 4.3, ishin parashikuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, të cilat janë përdorur për vlerësimin paraprak dhe të cilësisë. Në kriteret e kualifikimit janë përfshirë si më poshtë:

- Kriteret e përshtatshmërisë ligjore,
- Kontratat e përealizuara;
- Situata dhe performance financiare;
- Eksperienca e menaxhimit;
- Eksperienca specifike;
- Eksperienca ESHS etj.
- Vlerësimi i ofertave:*

Ftesa për tender ishte publikuar në web-site e Bankës në datën 04 Shtator 2020. Në Raportin e Vlerësimit date 28 Nëntor 2020, janë vlerësuar 10 aplikantë dhe janë refuzuar 2 aplikantë të tjerë, të cilët nuk kishin prezantuar garancinë bankare për sigurimin e ofertës.

Komisioni i Vlerësimit ka rekomanduar lidhjen e kontratës me ofertuesin “Avtt. –Tch. Mo. JS.-Sch.”, Bullgari, për çmimin e tenderit 7,228,538.85 US\$, pa tvsh.

Aneksi nr. 2 “Mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile.”

Aneksi 2.1

Për kontratën me objekt “Rikonstruktion i Rrugës Pogradec-Tushemisht”, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht dosjen teknike të projektit të zbatimit si dhe nga vizita në terren në prezencë të audituesve shtetërorë të KLSH dhe supervisorit të punimeve u konstatuan diferenca në volume të situacionuara por të pakryera në fakt si dhe punime të pa realizuara sipas specifikimeve teknike dhe të dëmtuara, të argumentuara këto si më poshtë:

- Në kategorinë e punimeve, Bill 3 Tombinot dhe sistemi i drenimit, Veshje e kanaleve me beton për zërin *Shtresë zhavorr lumi t=10cm poshtë kanalit* në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 9771.70 m² dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit nr. 7. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht raportet mujore si dhe vizitës në terren, konstatohet se shtresa e zhavorrit, në pjesën e pjerrët të kanaleve poshtë strukturës së hollë monolite prej betoni C20/25, nuk është realizuar. Në krahun e djathtë të rrugës gjatësia e kanalit, të veshur me strukturë të hollë monolite, është 350 m (kp 2+625-2+975) me një gjerësi mesatare prej 2.57 m dhe 625 m (kp2+975 ÷ 3+600) me gjerësi mesatare 2.06 m. Gjithashtu, në krahun e majtë të rrugës gjatësia e kanalit, të veshur me strukturë të hollë monolite është 625 m (kp2+975 ÷ 3+600) me gjerësi mesatare 2.13 m. Volumi i shtresës së zhavorrit poshtë strukturës së hollë monolite për gjatësinë totale të pa realizuar sipas seksioneve, tregohet në tabelën si më poshtë:

Nr.	Seksioni	Gjatësia (m)	Gjerësia mesatare e pa realizuar (m)	Ndryshimi (m ²)
1	Sc. (2+625 ÷ 2+975) Djathtas	350	2.57	899.5
2	Sc. (2+975 ÷ 3+600) Djathtas	625	2.06	1,287.5
3	Sc. (2+975 ÷ 3+600) Majtas	625	2.13	1,331.25
Shuma				3518.25

Pas korigjimeve të bëra në librezën e masave konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumnin e punimeve 3518.25 m^2 për zërin Shtresë zhavorr lumi $t=10\text{cm}$ poshtë kanalit. Pra, për sa më sipër, sipërmarrësi ka përfituar më tepër vlerën **316,643 lekë pa TVSH** ($3518.25\text{m}^2 \cdot 90 \text{ lekë/m}^2$).

- Në kategorinë e punimeve, Bill 8 Punime për trotuare, për zërin Struktura monolite betoni C 6/10, nën bordur në librezën e masave pasqyrohet volumn punimesh 84.88 m^3 dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit nr. 7. Nga verifikimi i situacionit nr. 7 konstatohet se gjatësia totale e bordurave të vendosura është 1957 ml nga këto $1,039 \text{ ml}$ bordurë $20 \times 35 \text{ cm}$ dhe 918 ml bordurë $15 \times 35 \text{ cm}$. Duke ju referuar librezës së masave se beton C 6/10 poshtë bordurës është i nevojshëm $0.039 \text{ m}^3/\text{ml}$ e për rrjedhojë sasia e përdorur në total është 76.323 m^3 ($1957 \text{ ml} \cdot 0.039 \text{ m}^3/\text{ml}$), kështu që kemi një diferencë prej 8.557 m^3 ($84.88 \text{ m}^3 - 76.323 \text{ m}^3$) midis sasisë së përdorur dhe asaj të likuiduar.

Për sa më sipër sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë 8.557 m^3 për zërin Struktura monolite betoni C 6/10, nën bordur në vlerën **57,332 lekë pa TVSH** ($8.557 \text{ m}^3 \cdot 6,700 \text{ lekë/m}^3$).

- Në kategorinë e punimeve, Bill 7 Punime për trotuar, për zërin 6. An. Furnizim Vendosje Pemë 'Ligustër' në librezën e masave pasqyrohet sasi pemësh të vendosura 208 copë dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit nr. 7. Nga verifikimi në terren, nga km 2+575 në km 3+312 në të dy krahët e rrugës, konstatohet se 4 pemë nuk janë mbjellë dhe 19 prej tyre janë të thara, pra në total 23 copë. Tharja e pemëve tregon se nuk janë mbjellë sipas specifikimeve teknike dhe cilësia e tyre është e dobët.

Për sa më sipër sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë 23 copë për zërin F.V Pemë Liguster në vlerën **57,500 lekë pa TVSH** ($23 \text{ copë} \cdot 2,500 \text{ lekë/copa}$).

- Në kategorinë e punimeve, Bill 8 Korsi për biçikleta, për zërin Shtresë asfaltbetoni me ngjyra, 3cm, me makineri, në librezën e masave pasqyrohet sipërfaqe punimesh të kryera për rrugët sekondare 1072.4 m^2 dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit nr. 7. Nga auditimi i zbatimit të punimeve gjatë vizitës në terren, në rrugën e dytë sekondare, konstatohen defekte të tipit çarje, zhvendosje, ngritje dhe cedime në shtresën e asfaltbetonit me ngjyrë në korsinë e biçikletave për një gjatësi prej 100 metrash nga CS-2 km 0+025 në CS-5 km 0+125. Referuar vizatimeve të projektit dhe matjeve në terren gjerësia e shtresës e asfaltbetonit me ngjyrë në korsinë e biçikletave është 1.6 m . Pra sipërfaqja totale e kësaj shtrese e cila nuk përmbush kërkesat e cilësisë konform specifikimeve teknike rezulton të jetë 160 m^2 .

Për sa më sipër konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër për punime të kryera pa përmbushur kërkesat e specifikimeve teknike për zërin Shtresë asfaltbetoni me ngjyra, 3cm, me makineri në vlerën **104,000 lekë pa TVSH** ($160 \text{ m}^2 \cdot 650 \text{ lekë/m}^2$).

- Në kategorinë e punimeve, Bill 8 Shtresat e rrugës, për zërin Shtresë asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri në librezën e masave pasqyrohet sipërfaqe punimesh të kryera për rrugën e dytë sekondare 1662 m^2 dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit nr. 7. Nga auditimi i zbatimit të punimeve gjatë vizitës në terren, në rrugën e dytë sekondare, konstatohen defekte në shtresën e asfaltbetonit midis korsinë se biçikletave dhe kunetës, në pjesën e dedikuar për parkim në një gjatësi prej 15 m në CS-4 km 0+075. Referuar vizatimeve të projektit dhe matjeve në terren gjerësia e shtresës e asfaltbetonit në këtë seksion është 2 m .

Për sa më sipër rezulton se sipërmarrësi ka përfituar më tepër për punime të kryera pa përmbushur kërkesat e specifikimeve teknike për zërin Shtresë asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri në vlerën **24,000 lekë pa TVSH** ($30 \text{ m}^2 \cdot 800 \text{ lekë/m}^2$).

- Në kategorinë e punimeve, A/1 Gërmime për zërin Mbushje me material të gërmuar përhapur e ngjeshur me makineri $t=20$ cm (për gjelbërim) në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh 1039 m^3 dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit nr. 7. Nga auditimi i zbatimit të punimeve gjatë vizitës në terren, konstatohen se afërsisht 30% e sipërfaqes totale të shtresës së dheut për gjelbërim është e dëmtuar si rezultat i mosrealizimit të punimeve sipas specifikimeve teknike e për rrjedhojë edhe sipërfaqja e barit në zërin Mbjellje Bari në skarpata është e pa realizuar po në masën 30%.

Për sa më sipër rezulton se sipërmarrësi ka përfutur më tepër për punime të kryera pa përmbushur kërkesat e specifikimeve teknike për zërin Mbushje me material të gërmuar përhapur e ngjeshur me makineri $t=20$ cm (për gjelbërim) në vlerën **157,392 lekë pa TVSH** ($1093\text{m}^3 \cdot 30\% \cdot 480\text{lekë/m}^3$) si dhe për zërin Mbjellje Bari në skarpata në vlerën **147,555 lekë pa TVSH** ($5465\text{m}^2 \cdot 30\% \cdot 90\text{lekë/m}^2$).

GRUPI I AUDITIMIT

S. H.
S. B.
M. R.
E. S.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

R. XH.